



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**



V E N D I M

Nr. 83, date 26.12.2017

**PËR
MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË
MBETJEVE TË NGURTA URBANE BASHKIA SHKODËR 2017-2022**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2017, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 23, 33, 54 shkronja "k", 55 pika 2, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar, ligjit nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme" të ndryshuar, ligjit nr. 10431 datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, VKM nr. 428, datë 08.06.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddepozitimeve të mbetjeve urbane", VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", VKM nr.575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", VKM nr.387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura", VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura", VKM nr.641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte", VKM nr.608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", VKM nr.117, datë 13/02/21013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje", i ndryshuar, VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre", VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura", VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës", VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve", VKM nr.177, datë 06/03/2012

"Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve", VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve", VKM nr.798, datë 29/09/2010 Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore", VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve" të ndryshuar, Udhëzimi nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane" si dhe relacionin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike ndjekjes së Investimeve të Infstrukturës, pas diskutimeve,

V E N D O S I

1. Miratimin e "Planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane Bashkia Shkodër 2017-2022" sipas lidhjes bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 26.12.2017

Shpallur në datën 29.12.2017

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI



Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane

Bashkia Shkodër

2017-2022

KRYETAR

Voltana Ademi

Albania

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

Përgatitur nga: EcoDES Studio

Dhjetor 2017

Një falenderim i veçantë shkon për stafin e dldp HELVETAS Swiss Intercooperation Znj. Valbona KARAKAÇI dhe Z. Arben KOPLIKU, dhe për stafin e asistencës teknike të EcoDES Studio Z. Konalsi GJOKA dhe Znj. Teida SHEHI që kontribuan në hartimin e planit lokal për menaxhimin e integruar të mbetjeve për Bashkinë Shkodër.

Një kontribut të veçantë ka dhënë stafi i Bashkisë Shkodër i kryesura nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Voltana ADEMI, e cila ka luajtur një rol kyç në ecurinë e procesit të hartimit planit si dhe stafi teknik, i kryesuar nga zv. Kryetari Z. Dritan META, Drejtori i Shërbimeve Publike dhe ndjekjes të Shërbimeve të Infrastrukturës Z. Alfred LULETA, Përgjegjësi i Sektorit të Mbetjeve Z. Fatbardh KUÇI, Specialistja e sektorit të mbetjeve Znj.Linda BALA dhe Specialisti i statistikave (GIS) Z. Adi GARUCI.

SHKURTIMET

AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
ARM	Agjensia Rajonale e Mjedisit
BE	Bashkimi European
ISHMPU	Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujrave
ISHSH	Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë
MB	Mbetjet nga Bizneset
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Mbetjet nga Familjet
MIE	Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJA	Njësi Administrative
NJQV	Njësi Qëndrore Vendore
OJF	Organizata Jo Fitim prurëse
PLMIMNU	Planin Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane
PKMM	Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve
PGM	Pikë Grumbullimi Mbetjesh
PPP	Partneritet Publik Privat
SKM	Strategjia Kombëtare e Mbetjeve
VKM	Vendim i Këshilit të Ministrave
ZAM	Zona e Administrimit të Mbetjeve

TABELA PËRMBAJTJES

I. HYRJE 9

- 1.1 NEVOJA PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE..... 9
- 1.2 HARTIMI I PLMIMNU NË BASHKINË SHKODËR..... 9

II. POLITIKA KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIN E MBETJEVE 10

- 2.1 POLITIKAT KOMBËTARE DHE PRINCIPET BAZË TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE 10
- 2.2 ASPEKTETE INSTITUCIONALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE..... 12
 - 2.2.1 *Organizimi në nivel qendror*..... 12
 - 2.2.2 *Organizimi në nivel lokal*..... 13
- 2.3 INFORMACION PËRMBLEDHES MBI LEGJISLACIONIN 14
- 2.4 INSTRUMENTAT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË NIVEL VENDOR..... 15

III. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME 17

- 3.1 PROFILI I BASHKISË..... 17
 - 3.1.1 *Të dhëna demografike* 19
 - 3.1.2 *Karakteristikat social ekonomike* 19
- 3.2 ASPEKTE INSTITUCIONALE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE NË BASHKINË SHKODËR 20
- 3.3 ASPEKTE TEKNIKE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE NË BASHKINË SHKODËR..... 21
 - 3.3.1 *Të dhëna për sasinë e prodhuar e mbetjeve*..... 21
 - 3.3.2 *Përbërja mercologjike e mbetjeve*..... 24
 - 3.3.3 *Skema e ofritit të shërbimit në Bashkinë Shkodër deri në muajin Qershor 2017*..... 25
 - 3.3.4 *Skema e ofritit të shërbimit në Bashkinë Shkodër pas Qershorit 2017*..... 37
 - 3.3.5 *Riciklimi dhe kompostimi*..... 40
 - 3.3.6 *Landfilli i Bushatit*..... 41

IV. ASPEKTET FINANCIARE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE41

- 4.1 KOSTO E PLOTË E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE..... 41
- 4.2 SISTEMI I TARIFAVE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE..... 43
 - 4.2.1 *Indikatorët e performancës*..... 45
 - c. *E3 Transparenca në systemin e faturimit: ky është një indikator cilësor, i cili ka tre shkallë vlerësimi:* 47

V. PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE 49

- 5.1 VIZIONI 49
- 5.2 OBJEKTIVAT 49
 - 5.3.1 *Rryma e mbetjeve, objekti i planit*..... 50
 - 5.3.2 *Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit*..... 51
- 5.3 SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË MBETJEVE 51
 - 5.3.1 *Shërbimet e pastrimit të rrugëve*..... 52
 - 5.3.2 *Grumbullimi, transporti i mbetjeve*..... 54
 - 5.3.3 *Trajtimi dhe depozitimi përfundimtar i mbetjeve*..... 55
 - 5.3.4 *Minimizimi i mbetjeve* 56
- 5.4 MANAXHIMI I MBETJEVE VOLUMINOZE DHE NDËRTIMORE..... 58
- 5.5 SKENARËT E PROPOZUAR PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE..... 59
- 5.6 POLITIKA MBULIMIT TË KOSTOS NGA TË ARDHURAT NGA TARIFAT E PASTRIMIT..... 91
 - 5.6.1 *Metodologji për mbulimin e kostos*..... 91
 - 5.6.2 *Planifikimi i të ardhurava nga tarifa e pastrimit për skenarin I të menaxhimit të mbetjeve*96

5.6.3	Planifikimi i të ardhurava nga tarifa e pastrimit për skenarin II të menaxhimit të mbetjeve	106
VI.	KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	115
6.1.	RREGULLORJA VENDORE	115
6.2	ZBATIMI DHE SANKSIONET.....	116
6.4	PJESËMARRJA E SEKTORIT PRIVAT.....	116
VII.	NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK	117
7.1	FUSHATA E INFORMIMIT NË BASHKINË SHKODËR GJATË HARTIMIT TË PLANIT.....	118
7.2	MODEL PËR HARTIMIN E NJË FUSHATË INFORMIMI PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE DHE SKEMAVE PËR MINIMIZIMIN E TYRE.....	119
VIII.	PLANI VEPRIMI	125
8.1	KOMPONENTI: KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	125
8.2	KOMPONENTI: GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETJEVE DHE PASTRIMI I RRUGËVE	127
8.3	KOMPONENTI: DEPOZITIMI DHE TRAJTIMI I MBETJEVE.....	128
8.4	KOMPONENTI: NDARJA DHE RICIKLIMI I MBETJEVE	129
8.5	KOMPONENTI: ASPEKTET FINANCIARE	130
8.6	KOMPONENTI: NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK DHE EDUKIMI	131
IX.	RISHIKIMI I PLANIT	132
9.1	MONITORIMI	132
9.2	MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT	136
ANEKSI I – KOSTOT SIPAS SISTEMIT TË LLOGARITJES SË KOSTOS PËR SKENARIN I		138
ANEKSI II – PERFORMANCA E NIVELIT TË MBLEDHJES SË TARIFËS SIPAS SKENARIT I		144
ANEKSI III – PERFORMANCA E NIVELIT TË MBLEDHJES SË TARIFËS SIPAS SKENARIT II		144

Lista e Figurave

Figura 1	Diskutime me grupin e punës në Bashkinë Shkodër gjatë hartimit të planit.....	10
Figura 2	Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve	11
Figura 3	NJA Në Bashkinë Shkodër.....	17
Figura 4	NJA Struktura e Bashkisë për menaxhimin e mbetjeve	21
Figura 5	Sasia e mbetjeve të grumbulluara në Bashkinë Shkodër për vitin 2016	22
Figura 6	Shërbimi i Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Shkodër deri në Maj 2017.....	26
Figura 7	Shpërndarja e PGM në NJA Ana Malit.....	27
Figura 8	PGM në NJA Ana Malit.....	27
Figura 9	Shpërndarja e PGM në NJA Bërdicë.....	28
Figura 10	Llojet e kontenierëve në NJA Bërdicë.....	29
Figura 11	PGM në NJA Bërdicë.....	29
Figura 12	Shpërndarja e PGM në NJA Guri i Zi.....	30
Figura 13	Gjendja fizike e kontenierëve në NJA Guri i Zi.....	30
Figura 14	PGM në NJA Guri i Zi	31
Figura 15	Shpërndarja e PGM në NJA Rrethinat.....	31
Figura 16	Gjendja fizike e kontenierëve në NJA Rrethinat.....	32
Figura 17	PGM në NJA Rrethinat.....	32
Figura 18	Shpërndarja e PGM në NJA Postribë	33
Figura 19	PGM në NJA Postribë.....	33
Figura 20	Shpërndarja e PGM në NJA Dajç.....	34
Figura 21	Gjendja fizike e kontenierëve në NJA Dajç.....	35

Figura 22 PGM në NJA Dajç	35
Figura 23 Shpërndarja e PGM në NJA Velipojë.....	36
Figura 24 Lloji i kontenierëve në NJA Velipojë.....	36
Figura 25 Gjendja fizike e kontenierëve në NJA Velipojë.....	37
Figura 26 PGM në NJA Velipojë.....	37
Figura 27 Mjete të ofrimit të ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.	40
Figura 28 Landfilli i Bushatit	41
Figura 29 Niveli i tarifave të pastrimit në NJA të Bashkisë Shkodër	43
Figura 30 Performanca financiare e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër 2016..	44
Figura 31 Diskutime me grupin e punës në Bashkinë Shkodër për vizionin dhe objektivat e planit.....	49
Figura 32 Harta e rrugëve të fshirjes manuale dhe mekanike në qytetin e Shkodrës.....	53
Figura 33 Skema e përgjithshme e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër.....	55
Figura 34 Modeli i kompostimit individual.....	58
Figura 35 Skemat e kompostimit në mjedis të hapur	58
Figura 36 Zonat e reja të shërbimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër.....	60
Figura 37 Zonat me rrugica të ngushta në qytetin e Shkodrës për mjetin 5ton	61
Figura 38 Rrugëtimet e mjeteve për skenarin I	64
Figura 39 Zona Lindore - rrugëtimi I (Fshati Mes – NJA Postribë – NJA Guri i Zi – landfill Bushati).....	66
Figura 40 Zona Lindore - rrugëtimi II (Fshati Mes – NJA Rrethinat – Landfill Bushati).....	67
Figura 41 Zona Lindore - rrugëtimi III (Fshati Mes – NJA Pult – NJA Shosh – NJA Shalë – Landfill Bushati)	68
Figura 42 Përmbledhje e rrugëtimin në Zonën Lindore.....	69
Figura 43 Zona Perëndimore - rrugëtimi I (Fshati Gomsiqe – NJA Ana Malit – NJA Bërdicë – landfill Bushati)	71
Figura 44 Zona Perëndimore - rrugëtimi II (Fshati Gomsiqe – NJA Velipojë – NJA Dajç – landfill Bushati)	72
Figura 45 Zona Perëndimore - rrugëtimi III (Fshati Gomsiqe – NJA Velipojë zona plazhit – landfill Bushati)	73
Figura 46 Përmbledhje e rrugëtimin në Zonën Perëndimore	73
Figura 47 Zona Qendrore - rrugëtimi I (Parku në Shkodër zona veriore dhe jugore– landfill Bushati).....	76
Figura 48 Zona Qendrore - rrugëtimi II (Parku në Shkodër – zona e unazës – landfill Bushati)	77
Figura 49 Zona Qendrore - rrugëtimi III (Parku në Shkodër – rrugicat e ngushta – landfill Bushati).....	78
Figura 50 Përmbledhje e rrugëtimin në Zonën Qendrore	79
Figura 51 Zona Qendrore – rrugëtimi për mbetjet e riciklueshme (Parku në Shkodër – NJA Shkodër – MRF Bërdicë).....	87
Figura 52 Opsionet e mbulimit të kostos së shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve	92
Figura 53 Përshkrimi i opsioneve të mbulimit të kostos	93
Figura 54 Hapat që duhen ndjekur për të zbatuar politikën e rikuperimit të kostos.....	94
Figura 55 Strategjia për vjeljen e tarifave	95
Figura 56 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Rrethinat	98
Figura 57 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Postribë.....	99
Figura 58 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Shalë	99
Figura 59 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Shosh	99

Figura 60 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Pult.....	100
Figura 61 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Guri i Zi	100
Figura 62 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Velipojë	102
Figura 63 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Dajç	102
Figura 64 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Ana Malit....	103
Figura 65 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Ana Malit....	103
Figura 66 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Shkodër.....	104
Figura 67 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Rrethinat	108
Figura 68 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Postrisë.....	108
Figura 69 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Shalë	108
Figura 70 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Shosh	109
Figura 71 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Pult.....	109
Figura 72 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Guri i Zi	110
Figura 73 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Velipojë	111
Figura 74 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Dajç	111
Figura 75 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Ana Malit....	112
Figura 76 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Bërdicë.....	112
Figura 77 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Shkodër.....	113
Figura 78 Dëgjesat publike në Bashkinë Shkodër	119
Figura 79 Elementet e fushatës të ndërgjegjësimit dhe informimit.....	120
Figura 80 Hartë verifikimi për evadimin e PGM në NJA Shkodër.....	133
Figura 81 Sesione trajnimi për sistemin e monitorimit.....	134
Figura 82 Aktorët e përfshirë në operacionet e monitorimit – Shembull NJA Shkodër.....	135
Figura 83 Skema e aktorëve të përfshirë në operacionet e monitorimit.....	135
Figura 84 Indikatorët e performancës	137

Lista e Tabelave

Tabela 1 Kuadri ligjor shqiptar për menaxhimin e mbetjeve	15
Tabela 2 Popullsia Bashkisë Shkodër	19
Tabela 3 Krahasimi i normave të gjenerimit dhe prodhimit të mbetjeve për vitin 2016 në Bashkinë Shkodër	23
Tabela 4 Sasia e mbetjeve të grumbulluara gjatë muajve Qershor, Korrik dhe Gusht 2017 në Bashkinë Shkodër	24
Tabela 5 Norma e grumbullimit të mbetjeve për NJA të Bashkisë Shkodër gjatë muajve Qershor dhe Korrik 2017.....	24
Tabela 6 Përbërja mercologjike e mbetjeve në nivel kombëtar	25
Tabela 7 Situata e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Shkodër deri në Maj 2017.....	25
Tabela 8 Kontrata Rrethinat – Postrisë – Shalë për ofrimin e shërbimit të mbetjeve.....	37
Tabela 9 Frekuenca e ofrimit të shërbimit për kontratën Rrethinat – Postrisë – Shalë	38
Tabela 10 Kontrata Ana Malit – Bërdicë – Guri i Zi për ofrimin e shërbimit të mbetjeve	38
Tabela 11 Frekuenca e ofrimit të shërbimit për kontratën Rrethinat – Postrisë – Shalë	38
Tabela 12 Kontrata Velipojë – Dajç për ofrimin e shërbimit të mbetjeve.....	39
Tabela 13 Frekuenca e ofrimit të shërbimit për kontratën Velipojë - Dajç	39
Tabela 14 Mjetet për shërbimin e mbetjeve në Bashkinë SHkodër	40
Tabela 15 Përmbledhje e buxhetit të Bashkisë Shkodër për menaxhimin e mbetjeve	42
Tabela 16 Buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt buxhetit total të bashkisë.....	43
Tabela 17 Të ardhurat nga tarifa e mbetjeve.....	44

Tabela 18 Indikatorët e performancës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër.....	48
Tabela 19 Të dhënat teknike për Skenarin I të menaxhimit të mbetjeve	62
Tabela 20 Kalendari i lëvizje të mjeteve teknologjike në Zonën Lindore – Skenari 1	62
Tabela 21 Kalendari i lëvizje të mjeteve teknologjike në Zonën Perëndimore – Skenari 1	63
Tabela 22 Përmbledhja e rrugëtive në Zonën Lindore - Skenari 1	69
Tabela 23 Përmbledhja e rrugëtive në Zonën Perëndimore - Skenari 1	74
Tabela 24 Përmbledhja e rrugëtive në Zonën Qëndrore - Skenari 1	79
Tabela 25 Kosto e shërbimit për Zonën Lindore për Skenarin I	80
Tabela 26 Kosto e shërbimit për Zonën Perëndimore për Skenarin I.....	81
Tabela 27 Kosto e shërbimit për Zonën Qëndrore për Skenarin I.....	82
Tabela 28 Kosto për fshirjen manual dhe fshirjen dhe larjen mekanike në qytetin e Shkodrës	83
Tabela 29 Përmbledhje e kostove të Skenarit I.....	83
Tabela 30 Të dhënat teknike për Skenarin II të menaxhimit të mbetjeve	85
Tabela 31 Kosto Shërbimit për Zonën Lindore Skenari II.....	88
Tabela 32 Kosto Shërbimit për Zonën Perëndimore Skenari II	89
Tabela 33 Kosto Shërbimit për Zonën Qëndrore Skenari II	90
Tabela 34 Përmbledhje e kostove të Skenarit II.....	91
Tabela 35 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin I – Zona Lindore	98
Tabela 36 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin I – Zona Perëndimore.....	101
Tabela 37 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin I – Zona Qëndrore	104
Tabela 38 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga BM & BV për Skenarin I	106
Tabela 39 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin II – Zona Lindore	107
Tabela 40 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin II – Zona Perëndimore.....	111
Tabela 41 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin II – Zona Qëndrore.....	113
Tabela 42 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga BM & BV për Skenarin II	115
Tabela 43 Pjesëmarrja e sektorit privat në administrimin e mbetjeve urbane.....	116
Tabela 44 Model të raportimi ditor për gjendjen e PGM	136

I. HYRJE

1.1 Nevoja për hartimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane

Plani Lokal i Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për manaxhimit e mbetjeve urbane në Bashkinë Shkodër.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për manaxhimit e mbetjeve në nivel lokal. PLMIMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i PLMIMNU konsiston në sfidën e re që ka bashkia për të ofruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu plani fokusohet edhe në përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e sistemit të monitorimit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të brenda bashkisë për zbatimin e planit

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- Opsionet e manaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbetjeve;
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e manaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e manaxhimit të mbetjeve;
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Viti 1994 shënoi momentin kur autoritetet lokale ju deleguan shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbime të tjera pastrimi, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për manaxhimit e tyre dhe njëkohësisht, duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të "granteve të pakushtëzuara". Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Qeverisjes vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga **Ligji i ri nr.10 463, datë 22.09.2011 "Për manaxhimit e integruar të mbetjeve"**, ku në nenin 12, pika 2 citohet: *Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.*

1.2 Hartimi i PLMIMNU në Bashkinë Shkodër

Në kuadër të projektit "Mbështetje Bashkisë Shkodër në sektorin e menaxhimit të mbetjeve", pjesë e Programit të Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (dldp), Bashkia Shkodër me mbështetjen e Helvetas Swiss Intercooperation dhe asistencën teknike të EcoDES Studio, mundësoi hartimin e Planit Lokal të Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane.

Në fazën e parë të projektit u themelua grupi i punës me përfaqësues nga stafi i bashkisë, ekspertët dhe përfaqësues të dldp-së. Ata ishin pjesë e zhvillimit të Planit që në fillimet e tij duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që janë ekonomikisht të mundshme me buxhetin që ka në dispozicion bashkia, dhe të pranueshme nga ana mjedisore me ndikimet minimale në mjedis dhe në përputhje me politikat dhe legjislacionin mjedisor në fuqi. Çdo etapë e këtij plani, duke përfshirë prioritetet e bashkisë, vizionin, objektivat, opsionet, investimet dhe afatet kohore u diskutuan dhe u ranë dakort gjatë takimeve të grupit të punës.



Figura 1 Diskutime me grupin e punës në Bashkinë Shkodër gjatë hartimit të planit
[Burimi: dldp]

Bashkia Shkodër ka një eksperiencë të gjatë në fushën e planifikimit të shërbimit të mbetjeve në sajë të mbështetjes të vazhdueshme teknike dhe asistencës që ka marrë nga program i dldp-së me anë të financimeve të ndryshme, si në hartimin e planeve lokale të NJA që janë sot pjesë e Bashkisë (Velipojë, Dajç, Ana Malit, Guri i Zi - përpara referomës territoriale dhe administrative kur ishin NJQV si komuna), ashtu edhe së fundmi në ngritjen e sistemit të monitorimit të shërbimit në qytetin e Shkodrës. Ky i fundit, një proces të cilin bashkia me këmbënguljen dhe rolin e saj, dhe veçanërisht të Kryetares për ta ngritur dhe zbatuar rigorozisht dhe me sukses në qytetin e Shkodrës si fillim, dhe më pas në NJA, ka shërbyer për grumbullimin dhe gjenerimin e të dhënave të nevojshme për bazat e një planifikimi të integruar të shërbimit.

Në hapa të ndryshëm të hartimit të planit, grupi i punës organizoi seanca diskutimi dhe konsultimi me përfaqësuesit kryesorë të bashkisë. Procesi i konsultimit, i cili çoi në punën e ngushtë midis aktorëve, duke rakorduar në ato që i nevojiten bashkisë, duke ofruar mundësi për komente apo diskutime të ndryshme. Përfaqësuesit e Bashkisë Shkodër kanë asistuar gjatë lëvizjeve në terren dhe kanë dhënë asistencën e tyre në lidhje me identifikimin e gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë së madhe.

II. POLITIKA KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIN E MBETJEVE

2.1 Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar për Manaxhimin e Mbetjeve¹ ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Shqipërisë për manaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në 2025, duke synuar minimizimin e impaktit të mbetjeve në mjedis në nivelin kombëtar dhe lokal si dhe përmirësimin e përdorimit eficient të burimeve në Shqipëri. Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë Shqiptare për të transformuar statusin e vendit në lidhje me reduktimin e mbetjeve, riciklimin, kompostimin apo përpunimin me përfitim energjie. Ajo ka vendosur objektiva sfidues dhe realiste njëkohësisht, të cilët synojnë mundësimin e ndryshimit rrënjësor të mënyrës së manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

¹ Miratuar në Janar 2011, aktualisht është në rishikim

Strategjia kombëtare e mbetjeve paracakton katër shtylla kryesore me qëllim zbatimin e politikës dhe strategjisë së mbetjeve nëpërmjet Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve (PKMM). Këto shtylla politike janë thelbësore dhe shumë të rëndësishme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe suksesin e të gjithë manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Shtyllat politike janë si në vazhdim:

Planifikimi: Hapi i parë në zbatimin e procesit duhet të jetë zhvillimi i planeve për të çuar përpara axhendën e strategjisë dhe politikës së mbetjeve në lidhje me zbatimin;

Edukimi: Partnerët/bashkëpunëtorët kryesorë të sistemit duhet të edukohen në mënyrë që të përmbushin potencialin e tyre brenda sistemit dhe të lehtësojnë zbatimin e reformave;

Mbështetja financiare: Burimet njerëzore dhe vetë sistemi duhet të mbështeten financiarisht në mënyrën e duhur;

Kuadri ligjor: Sistemi kërkon një paketë rregulloresh. Për më tepër, për të siguruar hyrjen në Bashkimin Evropian, vendi do të duhet të bëjë përafrimin me legjislacionin përkatës të Komitetit Evropian në fushën e mjedisit në vitet në vijim.

Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

- **Hierarkia e mbetjeve:** Hierarkia e mbetjeve përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në manaxhimin e mbetjeve në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në manaxhimin e mbetjeve duke vendosur “parandalimin dhe ripërdorimin” në majë dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.



Figura 2 Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve

- **Parimi reduktues:** Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur gjenerimin e mbetjeve. Qëllimi kryesor në reduktimin e mbetjeve qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre;
- **Parimi parandalues:** Të sigurojë reduktimin e impakteve nga mbetjet në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e rrezikshme tek mbetjet;
- **Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë:** Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë kërkon që mbetjet të manaxhohen sa më afër vendit ku prodhohet. Politika e BE-së rekomandon që shtetet anëtare të merren vetë me mbetjet e tyre, duke shmangur eksportin në vende të tjera.
- **Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit apo ndotësit:** Parimi “Ndotësi paguan” kërkon që prodhuesit e mbetjeve të mbulojnë koston e manaxhimit të mbetjeve që gjenerojnë. Kështu koston mjedisore dhe kostoja e manaxhimit të mbetjeve në të gjitha proceset duhet të

reflektohen në çmimin e produktit si dhe në tarifat për ofrimin e shërbimit. Objektivi është ofrimi i një sistemi të drejtë dhe dekurajues për prodhimin pa kriter të mbetjeve.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislative të BE-së. Progresi më i madh në fushën e mbetjeve është bërë në fushën e legjislacionit. Gjatë periudhës 2011 - 2016, legjislacioni Shqiptar për manaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime dhe rregullore që reflektojnë direktivat e BE-së dhe detyrimet nga Konventa e Baselit.

2.2 Aspektete institucionale të menaxhimit të mbetjeve

2.2.1 Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e e Turizimit dhe Mjedisit, Ministria infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi, **MTM** është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së manaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të dy autoriteteve të specializuara në varësi të saj: Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMPU) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit (ARM).

ISHMPU (në zbatim të Ligjit nr. 10431) është përgjegjës dhe ushtron aktivitetin për garantimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor (ku përfshihen edhe mbetjet) në të gjithë vendin për të gjithë konsumatorët që gjenerojnë mbetje. Ai vendos penalitete për shkeljet administrative apo mund të pezullojë aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislacionin mjedisor; informon rregullisht autoritetet lokale për gjendjen e mjedisit, aktet ligjore të miratuara dhe projektet e miratuara; kontrollon regjistrin e ndotësve (ku përfshihen dhe mbetjet), rregulloret teknike dhe teknologjitë. ISHMPU bashkëpunon me autoritete të tjera në nivel qendror, rajonal dhe lokal (si p.sh. ARM, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ISHSH, IKMT-ja, Policinë Bashkiake etj.) për përmbushjen e detyrave të këtyre të fundit.

Agjensitë Rajonale të Mjedisit (në zbatim të Ligjit nr. 10431) janë autoritete të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel rajonal dhe, bashkë me AKM-më si njësi qendrore, përbëjnë rrjetin e agjencive mjedisore. Ato kanë për detyrë: (i) të realizojnë zbatimin e ligjeve mjedisore dhe atyre të manaxhimit të mbetjeve në nivel lokal dhe rajonal; (ii) të bashkëpunojnë me autoritetet lokale në zhvillimin e aksioneve, planeve, projekteve apo fushatave të sensibilizimit në nivel lokal; (iii) kanë përgjegjësi në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve dhe japin, në bashkëpunim me autoritetet vendore, lejet mjedisore për impiantet lokale të mbetjeve apo aktivitete të tjera lokale.

MIE dhe më konkretisht Drejtoria e Politikave të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta ka për detyrë formulimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, normave dhe standardeve për shërbimet publike në fushën e mbetjeve urbane apo mbetjeve të tjera. MIE është autoriteti përgjegjës në nivel kombëtar për planifikimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e investimeve publike në fushën e manaxhimit të mbetjeve, rehabilitimit të fushave të venddepozitimeve, ngritjes së landfill-eve etj. Në zbatim të kuadrit ligjor, ajo duhet të përgatisë rregullore, teknika dhe metoda për të gjitha proceset e manaxhimit të mbetjeve si ndarja dhe grumbullimi i tyre, transporti dhe riciklimi, trajtimi dhe propozja etj. Gjithashtu, MTI është autoriteti kontraktues për koncesionin e aktiviteteve ekonomike nën përgjegjësinë e saj, duke përfshirë fushën e shërbimeve publike ku bën pjesë edhe manaxhimin i mbetjeve.

Këshilli Kombëtar i Territorit, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërimit për objektet (si rrjedhojë edhe për landfill-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, në bashkëpunim me MTM dhe në zbatim të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve harton rregullore për manaxhimin e mbetjeve në nivele të ndryshme të hierarkisë së manaxhimit të tyre dhe gjithashtu harton dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore (miratuar Udhëzimi Nr. 6, dt. 30.11.2007);

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është një autoritet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, i cili ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai bashkëpunon me Inspektoratet Mjedisore dhe në raste të veçanta, edhe me inspektorate të tjera, sikurse edhe me autoritetet lokale për kryerjen e inspektimeve të aktiviteteve që lidhen me mbetjet. Aktiviteti i inspektoratit mbështetet në ligjin 7904 datë 8.3.1995 dhe ka për detyrë të vendosë gjoba për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshtatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë. Përgjegjësia e inspektoratit shtrihet edhe në përcaktimin e vendgrumbullimit të mbetjeve.

Spitalet dhe gjithë prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për administrimin e mbetjeve spitalore si dhe për projektimin e skemave të manaxhimit të mbetjeve të tyre, në përputhje me Planet Kombëtare të Manaxhimit të Mbetjeve dhe Planet e Manaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në bashkëpunim me MTM) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për:

- Mbetjet industriale
- Mbetjet minerale
- Rehabilitimin e venddepozitimeve në përputhje me specifikat.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural (në bashkëpunim me MTM) është përgjegjëse për hartimin e rregullores për mbetjet bujqësore dhe shtazore.

Ministria e Financës (në bashkëpunim me MM) është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për paraqitjen e taksave të ndryshme mjedisore.

2.2.2 Organizimi në nivel lokal

Detyrat dhe përgjegjësitë: Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” dhe ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 bashkitë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar. Bashkia përcakton:

- i. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të manaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
- ii. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për manaxhimin e mbetjeve urbane në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato;
- iii. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë manaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret “tip” të miratuara nga MM, MTI dhe MSH;
- iv. Harton planet e manaxhimit të mbetjeve urbane në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
- v. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
- vi. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet, bashkitë kanë detyrimet si më poshtë:

- (i) Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;
- (ii) Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
- (iii) Të monitorojnë dhe inspektojnë të gjitha proceset e manaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitim përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualët lokale;
- (iv) Të inspektojnë “zotëruesin e mbetjeve” për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
- (v) Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e manaxhimit të mbetjeve;
- (vi) Të bashkëpunojë me ISHMPU, ARM si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal;
- (vii) Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligjit 9537).

Policia e bashkiake është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me manaxhimin e mbetjeve.

2.3 Informacion përmbledhes mbi legjislacionin

Në tabelën më poshtë është bërë një përmbledhje e kuadrit ligjor Shqiptar në fushën e Manaxhimit të mbetjeve:

Kuadri Ligjor për Manaxhimin e Mbetjeve

Ligjet	Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013
	Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për manaxhimin e mbetjeve të rrezikshme”
	Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
VKM-të	VKM nr. 428, datë 08.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddeozitimeve të mbetjeve urbane”
	VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"
	VKM nr.575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
	VKM nr.387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e

	mbetjeve të PCB-ve të përdorura "
	VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura"
	VKM nr.641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte "
	VKM nr.608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"
	VKM nr.579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve"
	VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
	VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"
	VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
	VKM nr.52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit srap pushojnë së qeni mbetje"
	VKM nr.117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje"
	VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"
	VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"
	VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"
	VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"
	VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve"
	VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
	VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"
	VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
	VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"
	VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve"
Udhëzime	Udhëzim nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane"

Tabela 1 Kuadri ligjor shqiptar për menaxhimin e mbetjeve
[Burimi: Punuar nga autori]

2.4 Instrumentat për menaxhimin e integruar të mbetjeve në nivel vendor

Bazuar në ligjin kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve, i miratuar në vitin 2011 dhe i amenduar përsëri në vitin 2013, NJQV-të (bashkitë) duhet të hartojnë instrumentat vendorë për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e shërbimit të mbetjeve, si:

- **Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane**, si instrumenti kryesorë i planifikimit për përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifike, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisore, në lidhje me drejtimet që do të ndërmarrë bashkia në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Këto objektiva specifike duhet të reflektojnë orietimet e politikës kombëtare drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të bashkisë. Mbi bazën e objektivave specifike të dakordësuar në të gjitha nivelet vendimarrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon skenarët e mundshëm të organizimit të shërbimit të shoqëruar me koston përkatëse dhe politikën fiskale që duhet të ndjekë bashkia në mbulimin e plotë të koston. Ai përfundon me një plan veprimi konkret të ndarë në afate kohore, brenda një 5 vjeçari, sipas përgjegjësive përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit. Plani është një dokument planifikimi, i cili merr fuqi të plotë me miratimin nga Këshilli Bashkiak.
- **Rregulloret bashkiake për manaxhimin e mbetjeve** për çdo rrymë specifike: është përgjegjësi e Bashkisë Shkodër të hartojë këto rregullore (duke zbatuar specifikat e ndarjes së re territoriale-administrative), e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe manaxhimit të mbetjeve për të gjitha rrymat specifike të mbetjeve, brenda territorit administrativ të bashkisë, duke hartuar procedura për ankesat e banorëve, gjithashtu edhe kapitulli për aplikimin e sanksioneve në rast të mos zbatimit të rregullores nga aktorë të ndryshëm. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak për të marrë fuqi të plotë ligjore.
- **Rregulloret për llogaritjen e koston dhe tarifave mbetjet:** në sajë të asistencës teknike nga programi dldp, Bashkia Shkodër ka qënë pjesë e shumë trajnimeve për aplikimin e modelit të llogaritjes së koston dhe tarifave të prezantuar nga programi dldp. Në këtë kuadër, nisur edhe nga fakti që shumë shpejt këto metodologji do të miratohen edhe në nivel kombëtar, për t'u përdorur zyrtarisht nga të 61 bashkitë vendit, bashkia duhet të hartojë rregulloret përkatëse në lidhje me rregullat dhe procedurat për llogaritjen e koston vjetore të shërbimit dhe nivelit të tarifave për konsumatorë të ndryshëm që janë pjesë e skemës, sipas modeleve të dldp-së. Këto rregullore do të qartësojnë punën e stafit të financës dhe tarifave, të cilët në bashkëpunim me stafin teknik të menaxhimit të shërbimit, duhet të llogarisin koston vjetore dhe të përcaktojnë politikën fiskale, e cila i përshtatet më mirë nevojave të bashkisë bazuar në konceptin e përbalueshmërisë nga konsumatori, por edhe në drejtim të mbulimit të plotë të koston nga tarifat e pastrimit. Këto rregullore duhet të miratohen në Këshill Bashkiak.
- **Modeli i Sistemit të Monitorimit:** Ky është një instrument të cilin bashkia ka filluar të ngrejë dhe ta zbatojë për qytetin e Shkodrës, ku çdo ditë kryetarët e rajoneve, inspektorët e terrenit, përgjegjësit e shërbimit dhe përfaqësuesit e firmës private, raportojnë në lidhje me gjendjen e PGM (a janë evaduar rregullisht apo jo) sipas formateve tashmë të hartuara dhe konsoliduar për NJA Shkodër. Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër duhet ta shtrirë modelin e monitorimit edhe në njësitë e tjera administrative, duke anagazhuar edhe vetë administratorët e këtyre njësisve apo stafin e tyre, që të jenë pjesë e procesit dhe të kryejnë raportimet ditore, javore dhe mujore tek qendra e Bashkisë. Në këtë mënyrë, bashkia në sajë të ngritjes të sistemit të monitorimit në të gjithë territorin e saj do të kuptojë më mirë nivelin e ofrimit të shërbimit, elementet ku ajo duhet të ndërhyjë për të përmirësuar situatën, apo edhe të rishikojë objektivat specifike për zona, apo kategori të ndryshme të konsumatorëve. Me anë të këtij sistemi edhe sistemi i sanksioneve kryesisht për firmat private që ofrojnë shërbimin, për bizneset apo edhe për konsumatorët familjarë mund të ekzekutohen lehtësisht.
- **Strategjia e informimit:** një instrument tjetër mjaft i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane. Bashkia duhet të sigurojë angazhimin e plotë të komunitetit duke i informuar ata në lidhje me skemën e menaxhimit të mbetjeve që po zbaton në territorin e bashkisë dhe me politikën fiskale që ajo po aplikon. Bashkia duhet të hartojë një strategji informimi, që në hapat e parë të hartimit të planit, duke informuar komunitetin në lidhje me iniciativën që ajo ka ndërmarrë, objektivat e përcaktuar, skenarët që kërkon të aplikojë dhe politikën fiskale që bashkia kërkon të ndjekë. Kjo strategji duhet të përcaktojë edhe etapa të tjera që duhet të përsëritën vit pas viti, ku synimi kryesor duhet të jetë informimi i komunitetit në lidhje me proceset që zhvillon bashkia dhe marrja e

opinionit të tyre në lidhje me performancën e shërbimit dhe sugjerimeve që ata mund të kenë. Zhvillimi i pyetësorëve të ndryshëm, apo i dëgjesave publike në periudha të ndryshme gjatë zbatimit të planit, janë disa nga elementet që strategjia e informimit duhet të parashikojë, për të matur opinionin qytetar, i cili duhet të reflektohet si në përmirësimin e shërbimit ashtu edhe të strategjisë së informimit.

III. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME

3.1 Profili i Bashkisë

Bashkia Shkodër shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë në një territor prej 873 km², i cili kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë. Bazuar në reformën e re administrative dhe territoriale, të miratuar në Korrik 2015, Bashkia e madhe Shkodër përbëhet nga 11 NJA (Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë), ku kryeqendra e bashkisë është qyteti i Shkodrës.



Figura 3 NJA Në Bashkinë Shkodër
[Burimi: Bashkia Shkodër, punoi autori]

NJA Shkodër e pozicionuar në qendër të Bashkisë laget në pjesën veriperëndimore nga Liqeni i Shkodrës (me një sipërfaqe prej 368 km², më i madhi në Ballkan). Nga ky liqen buron Lumi Buna (44 km). Lumi Buna bashkohet me lumin Drin rreth 2 km në jugperëndim të qytetit. Në pjesën lindore njësia kufizohet me Lumin Kir, i cili buron nga Malësitë e Veriut dhe është i gjatë 43km. Lumi Kir derdhet në pjesën jugore të qytetit në lumin Drin, ku sëbashku me lumin Buna formojnë Lumin Drin që derdhet në detin Adriatik. Zona fushore e njësisë ka një sipërfaqe rreth 1,150 ha, ndërsa pjesa kodrinore ka një sipërfaqe prej 350ha. Zona qytetit përbëhet nga tre lagje periferike në pjesën jugore (lagjia Bahçalleku) dhe në zonën perëndimore lagjet: Zogaj dhe Shiroka. Rreth 30 km në juglindje ndodhet bregdeti Adriatik me Plazhin e Velipojës. Nga veriu dhe veriperëndimi shtrihet Fusha e

Mbishkodrës përtej të cilës fillojnë Alpet e Shqipërisë, përkatësisht, Jezerca (2.694 m) dhe Radohima (2.570 m).

NJA Dajç shtrihet në pjesën jugperëndimore të qytetit të Shkodrës, në një distancë rrugore prej 22 km larg. Kjo njësi kufizohet në veri dhe veriperëndim me Lumin Buna dhe përtej saj me njësinë administrative Ana e Malit, ndërsa një pjesë e saj është në kufi me Malin e Zi. Në pjesën lindore dhe juglindore kufizohet me njësinë administrative Bërdicë dhe Bushat ndërsa në jug me njësinë administrative Velipojë. Kjo njësi ka një shtrirje relativisht të madhe, prej 36.52 km² dhe thuajse e gjithë kjo sipërfaqe është tokë bujqësore me vlera të mira prodhuese.

NJA Bërdicë shtrihet në pjesën jugore të të qytetit të Shkodrës me një sipërfaqe prej 31.02 km². Kjo njësi kufizohet në veri me qytetin e Shkodër, në jug me NJA Bushat (Bashkia Vau Dejës), në lindje me lumin Drin dhe në perëndim me njësinë administrative Dajç.

NJA Ana Malit shtrihet në pjesën jug-perëndimore të qytetit të Shkodrës, në një distancë prej 6 km, me një sipërfaqe rreth 44 km². Ajo kufizohet në veri dhe verilindje me qytetin e Shkodrës, në perëndim me Malin e Zi, në jug dhe juglindje me lumin Buna në një gjatësi prej 17 km si dhe në lindje me njësinë administrative Bërdicë. Ana e Malit është kufitare me Malin e Zi dhe portë hyrëse nëpërmjet pikës doganore të përbashkët Mali i Zi - Shqipëri, pranë fshatit Muriqan.

NJA Rrethinat shtrihet në pjesën veriore të qytetit të Shkodrës me sipërfaqe 47,05 km². Territori i njësisë përshkohet nga rrugët nacionale Tiranë - Hani i Hotit dhe Shkodër - Muriqan. Kjo zonë në pjesën më të madhe të saj është pjesë e zonës të Mbishkodrës, ku përjashtim bën fshati Zues, i cili shtrihet në pjesën më skajore të kodrës së Taraboshit, pranë lumit Buna.

NJA Guri i Zi shtrihet në pjesën juglindore të qytetit të Shkodrës përgjatë rrugës rajonale Shkodër - Vau i Dejës me një sipërfaqe prej rreth 81.7 km². Ajo kufizohet me njësitë administrative Postribë, Shllak, Bushat, Bërdicë dhe Shkodër. Kjo zonë mbart vlera të veçanta arkeologjike dhe historike, ku përmendim pikat e veçanta me vlera turistike si Kalaja e Gajtanit, Kalaja e Ganjollës, Ishulli i Shurllahut (Sarda) etj.

NJA Velipojë shtrihet në pjesën jugore të qytetit të Shkodrës në një distance prej 25 km me një sipërfaqe rreth 72,4 km². Kjo njësi kufizohet në veriperëndim nga Mali i Zi përgjatë lumit Buna, në lindje nga Bashkia Lezhë, në veri nga NJA Dajç dhe në jug nga deti Adriatik. Pozita e favorshme gjeografike ku ndërthuren deti dhe lumi, laguna dhe rezervati natyror, fushat pjellore, kënetat dhe pyjet, kodrat dhe malet i japin kësaj njësie administrative një mundësi të madhe për zhvillimin e turizmit detar, lumor dhe malor, të peshkimit dhe të gjuetisë, të zhvillimit të kulturave të ndryshme bujqësore dhe të blegtorisë. Vija bregdetare në këtë njësi ka një gjatësi prej 14km dhe gjerësi rreth 300m. Në këtë zonë ndodhen Ligatinat e Velipojës (grykderdhjen e lumit Buna ku përfshihen 4 mocale të cekëta dhe kënetat e Domjes), Rezervati i Velipojës (700 ha, shtrihet në deltën e lumit Buna, rreth 8 km larg nga Velipoja, Ishulli i Franc Jozefit, Laguna e Vilunit, plazhi i Baks-Rrjollit).

NJA Postribë shtrihet në verilindje të qytetit të Shkodrës, në Zonën e Mbishkodrës me një sipërfaqe rreth 180 km². Postriba kufizohet në veri me njësinë administrative Pult, në veriperëndim me njësinë administrative Gruemirë të rrethit Malësi e Madhe, në jugperëndim me njësinë administrative Rrethina, në jug me Gurin e Zi, në lindje me njësinë administrative Shllak.

NJA Pult shtrihet në veri të NJA Postribë me një sipërfaqe rreth 122.90 km². Njësia administrative Pult kufizohet në veri me njësinë administrative Shalë dhe Malësi e Madhe, në jug me njësinë administrative Postribë dhe Shllak, në lindje me njësinë administrative Shosh, në perëndim me njësinë administrative Gruemirë të rrethit Malësi e Madhe.

NJA Shosh është në kufi më NJA Pult me një sipërfaqe rreth 95.24 km². Kjo njësi kufizohet në veri me njësinë administrative Shalë, në jug me njësinë administrative Shllak dhe Temal në lindje me njësinë administrative Pult dhe në perëndim me Bashkinë Vau i Dejës dhe Tropojë.

NJA Shalë shtrihet në kufi me njësinë administrative Shosh me një sipërfaqe prej 215.05 km². Njësia administrative Shalë kufizohet në veri me Kosoven, në jug me njësinë administrative Shosh dhe Lekbibaj të Tropojës, në lindje me Tropojën dhe në perëndim me njësinë administrative Pult dhe Malësinë e Madhe. Kjo njësi administrative përfshin Parkun Kombëtar të Thethit, si aseti natyror më tërheqës në Qarkun Shkodër dhe më gjerë.

3.1.1 Të dhëna demografike

Popullsia e qytetit të Shkodrës përbën rreth rreth 45% të të gjithë rajonit. Si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur në vend gjatë dy dekadave të fundit, popullsia e qytetit është rritur me 1/3 pavarësisht lëvizjeve demografike brenda dhe jashtë vendit. Nëse do ta krahasojmë më rritjen e popullsisë të qyteteve të tjera ajo ka qënë e moderuar me 2.02% për periudhën nga 1991 në 2013. Ndryshimet demografike gjatë viteve 1997 – 2005 kanë ndodhur edhe si rezultat i riorganizimit administrativ të territorit, ku disa njësi administrative fqinje janë bërë pjesë e bashkisë. Në tre vitete e fundit rritja e popullsisë ka qene pothuajse e palëvizshme me një përqindje prej vetëm 0.36%.

Sot në territorin Bashkisë Shkodër janë 11 NJA-ve. Në hartimin e këtij planit i jemi referuar numrit të popullsisë të marrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ashtu siç tregohet në tabelën më poshtë:

Nr. Popullsisë	Nr. Gjendja civile	Census 2011	MFE
Shkodër	113,000	77,075	87,853
Ana e Malit	5,850	3,858	4,456
Bërdicë	9,465	5,773	6,881
Guri i Zi	11,800	8,085	9,200
Postribë	11,657	7,069	8,445
Rrethinat	23,337	21,199	21,840
Dajç	9,083	3,885	5,444
Velipojë	9,502	5,031	6,372
Velipojë vere			25,000
Pult		1,529	1,070
Shalë + Shosh	4,800	1,084	2,199
Shosh		304	213
Bashkia total	198,494	134,892	153,973

Tabela 2 Popullsia Bashkisë Shkodër
[Burimi: Punuar nga autori]

3.1.2 Karakteristikat social ekonomike

Bashkia Shkodër është qendra kryesore politike, ekonomike dhe kultore e Shqipërisë së veriut. Në një udhëkryq mjaft të favorshëm kulturor me universitetin, bibliotekat, arkivat, kishat, xhamitë dhe muzetë, dhe me një ekosistem mjaft të larmishëm (Liqeni i Shkodrës, lumi Buna, Drin, Kir), shumë pranë detit Adriatik dhe pika më e afërt e transitit drejt veriut të gadishullit të Ballkanit dhe tregun e Bashkimit Evropian (me rrugë tokësore e hekurudhore), Bashkia Shkodër manifeston të gjitha parakushtet e një zone të rëndësishme tregtare dhe transiti, si dhe një qendër e rëndësishme ekonomike dhe industriale e Shqipërisë. Afërsia me Portin e Shëngjinit (45 km), Portin e Durrësit (98

km), Aeroportin e Rinasit (82 km), Portin e Barit (Mali i Zi, 49 km), si dhe me Kosovën nëpërmjet rrugës së Kombit, 170 km, pikën doganore të Hanit të Hotit me Malin e Zi (40 km) dhe pikën doganore të Muriqanit (15 km), si dhe lidhja me rrjetin e brendshëm hekurudhor si dhe me atë ndërkombëtar nëpërmjet Stacionit të Hanit të Hotit - 35 km larg, i cili mundëson lidhjen e vendit tonë me Europën Qendrore.

Ndër aktivitetet kryesore ekonomike në Bashkinë Shkodër përmendim zhvillimin e bujqësisë, kryesisht në Njësitë Administrative në zonën e nën Shkodrës si dhe blegtorinë e cila është e zhvilluar në të gjithë territorin e bashkisë. Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomik të Bashkisë Shkodër. Numri i fermave bujqësore është rreth 11,200 dhe me drejtim kryesisht blegtoral, perime dhe fruti kulturë (për tregun lokal), me një madhësi mesatare prej 1.1 ha/fermë e ndarë kjo në 2-3 parcela. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 16,054 ha ose 22.4% e territorit të Bashkisë, tokë subargjillore e mesme (SAM) dhe me bonitet mesatar III-IV.

Vlen të përmendet, edhe pse në ristme jo të larta, në zonat periferike të qytetit të Shkodrës ka një sërë stabilimetesh me industrinë fashon. Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

3.2 Aspekte institucionale në menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Shkodër

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër, në të gjitha NJA ofrohet nga kompani private të kontraktuara nga bashkia dhe monitorohet dhe kontrollohet rregullisht nga stafi i bashkisë. Në diagramën më poshtë tregohet se si funksionon struktura në bashki për menaxhimin e mbetjeve:




Figura 4 NJA Struktura e Bashkisë për menaxhimin e mbetjeve
[Burimi: Bashkia Shkodër, punoi autori]

Kompanitë private ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë, bazuar në kushtet e përcaktuara në kontratën e nëshkruar me bashkinë. Në NJA Shkodër për të 5 lagjet e qytetit bashkia ka inspektorin përkatës, i cili monitoron ofrimin e shërbimit dhe raporton tek supervitori i zonës (veriore ose jugore), i cili më pas raporton tek përgjegjësi i sektorit. Përgjegjësi i sektorit së bashku me specialistin e sektorit, nën varësi të Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe ndjekjes të Shërbimeve të Infrastrukturës, koordinonë sistemin e menaxhimit të mbetjeve që nga hartimi i preventivave për kontratat, evidentimin e gjendjes ekzsituase të infrastrukturës dhe hartimin e raporteve përfundimtare të gjendjes së shërbimit. Bashkia në landfillin e Bushatit ka një supërvizorin e saj, i cili bën raportime të rregullta mujore në lidhje me ngarkesat e mbetjeve që vijnë në landfill nga e gjithë bashkia. Përgjegjësi i sektorit është personi kryesor në menaxhimin e sistemit, jo vetëm për NJA Shkodër, por edhe për njësitë e tjera, ku të gjithë administratorët raportojnë tek përgjegjësi në lidhje me situatën e ofrimit të shërbimit në territorin e tyre. Përgjegjësi i sektorit raporton tek Drejtori i Shërbimeve Publike për situatën e shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë, i cili më pas raporton në instancat vendim-marrëse të bashkisë (zv. Kryetari dhe Kryetarja).

3.3 Aspekte teknike në menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Shkodër

3.3.1 Të dhëna për sasinë e prodhuar e mbetjeve

Bashkia Shkodër është një ndër bashkitë e pakta në vend, e cila dërgon mbetjet urbane në një landfill sanitar (Landfilli i Bushatit), në të cilin mbetjet peshohen në çdo dërgesë të tyre. Pas reformës

administrative territoriale, Bashkia e madhe Shkodër, e përbërë nga 11 NJA i dërgon mbetjet urbane në landfillin e Bushatit. Në landfillin e Bushatit bashkia ka një punonjës in e saj, i cili mban të dhënat në lidhje me të gjitha dërgesat që vijnë në landfill nga të gjitha NJA të Bashkisë Shkodër.

Sipas të dhënave të raportuara nga bashkia në grafikun më poshtë tregohet sasia e mbetjeve të gjeneruara kundrejt atyre të grumbulluara të cilat shkojnë në landfillin e Bushatit për vitin 2016, për ato NJA në të cilat ofrohej shërbimi²:




Figura 5 Sasia e mbetjeve të grumbulluara në Bashkinë Shkodër për vitin 2016

[Burimi: Bashkia Shkodër]

Bazuar në të dhënat e mbetjeve të cilat raportohen të dërgohen në landfillin e Bushatit, qyteti i Shkodrës mban vlerën më të lartë të normës të grumbullimit të mbetjeve me 0.88 kg/banorë/ditë dhe NJA Velipojë me 0.5 kg/banorë ditë. Të gjitha njësitë e tjera kanë një normë grumbullimi të mbetjeve nga 0.1 deri në 0.26 kg/banorë/ditë. Gjatë procesit të planifikimit bashkia propozon vlera më të larta të normës së gjenerimit, në krahasim me normën e grumbullimit të mbetjeve. Fakt është që jo të gjitha mbetjet të cilat gjenerohen (pra hidhen në PGM) dërgohen të gjitha në landfillin e Bushatit. Në zonat ku mungojnë PGM, mbetjet hidhen në vijat ujore apo në vende të hapura, duke bërë që vlerat e normës që grumbullohet (pra të mbetjeve që mbledhen dhe dërgohen në landfill), janë më të ulta se vlerat e mbetjeve që realisht banorët gjenerojnë çdo ditë.

² Në Njësinë Administrative Shalë, Shosh dhe Pult në vitin 2016 Bashkia nuk ofronte shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve

Në tabelën më poshtë bëhet një krahasim i normave të mbetjeve për vitin 2016 për të gjitha njësitë në Bashkinë Shkodër:

NJA	Popullsia	Numri i familjeve	Numri i familjeve që marrin shërbim	Sasia e mbetjeve që grumbullohen	Norma e gjenerimit të mbetjeve	Norma e mbetjeve që mblidhen
	nr.	nr.	nr.	ton/vit	kg/banorë/ditë	kg/banorë/ditë
Shkodër	87,853	25,434	19,800	28,224	1.131	0.880
Ana e Malit	4,456	1,195	870	196	0.166	0.121
Bërdica	6,881	1,759	1,210	190	0.110	0.076
Guri i Zi	9,200	2,385	1,270	445	0.249	0.133
Postribë	8,445	2,006	1,100	220	0.130	0.071
Rrethinat	21,840	5,433	3,680	650	0.120	0.082
Dajç	5,444	1,477	1,080	287	0.197	0.144
Velipojë	6,372	1,652	1,150	1148	0.709	0.494
Velipoja vere	25,000			658		0.263
Pult	1,070	234				0
Shale + Shosh	2,199	628	90		0	0
Shosh	213	56				0

Tabela 3 Krahasimi i normave të gjenerimit dhe prodhimit të mbetjeve për vitin 2016 në Bashkinë Shkodër

[Burimi: Bashkia Shkodër]

Për vitin 2017, Bashkia Shkodër ka qënë në proces të hartimit të kontratave të reja për njësitë administrative, dhe për 6 mujorin e parë të vitit të dhënat e grumbulluara në landfillin e Bushatit nuk paraqesin vlera të sakta të sasisë së mbetjeve. Bashkia në muajin Qershor mbylli kontratat për të gjitha njësitë administrative dhe nga ky muaj të dhënat e regjistruara në landfillin e Bushatit paraqesin një situatë më reale në lidhje me mbetjet që grumbullohen në NJA të Bashkisë Shkodër. Në tabelën më poshtë jepen të dhënat për muajt Qershor, Korrik dhe Gusht në lidhje me sasinë e mbetjeve të grumbulluara në NJA. Sistemi i monitorimit në Bushat është një metodë që do të vijë në ndihmë bashkisë për të llogaritur sasinë e mbetjeve që grumbullohen nga të gjitha njësitë administrative dhe duhet fuqizuar më shumë, për të patur të dhëna sa më të sakta. Bazuar në numrin e dërgesave të mbetjeve në landfillin e Bushatit është përllogaritur mesatarisht frekuenca e shërbimit në secilën NJA gjatë këtyre dy muajve:

NJA	Rrethinat	Postribe	Guri i Zi	Berdice	Veliope	Dajç	Ana Malit	Shale	Totali	
Qershor	Total (kg)	598,206	25,240	43,840	25,940	245,700	30,400	-	2,960	972,286
	Totali (ton)	598.2	25.2	43.8	25.9	245.7	30.4	-	3.0	972
	Frekuenca (dite/jave)	4.3	2.3	1.8	1.0	6.5	1.50		0.5	
Korrik	Total (kg)	635,720	41,040	25,740	26,280	723,960	37,280	16,400		1,506,420
	Totali (ton)	635.7	41.0	25.7	26.3	724.0	37.3	16.4		1,506
	Frekuenca (dite/jave)	5.8	1.5	1.0	1.0	7.0	1.5	0.8		
Gusht	Total (kg)	1,001,210	245,620	35,300	36,520	818,840	58,260	24,780	165,060	2,385,590
	Totali (ton)	1,001.2	245.6	35.3	36.5	818.8	58.3	24.8	165.1	2,386
	Frekuenca (dite/jave)	5.8	1.5	1.0	1.0	7.0	1.5	0.8	0.8	

Tabela 4 Sasia e mbetjeve të grumbulluara gjatë muajve Qershor, Korrik dhe Gusht 2017 në Bashkinë Shkodër

[Burimi: Bashkia Shkodër]

Gjatë muajit Korrik dhe Gusht frekuencat e grumbullimit të mbetjeve janë shtuar në krahasim me muajin Qershor për NJA Rrethinat dhe Velipojë, ndërsa për nëjsitë e tjera frekuenca është ulur ose ka mbetur në vlera të njëjta. Ndërkohë bazuar në këto të dhëna, kemi llogaritur edhe normën e grumbullimit të mbetjeve për secilën NJA për muajt përkatës (për NJA Shkodër nuk janë bërë llogaritje në mungesë të të dhënave nga landfilli i Bushatit). Relativisht norma e grumbullimit të mbetjeve është më e ulët se ajo e gjenerimit, duke u nisur edhe nga fakti që shërbimi nuk ofrohet në 100% të territorit të Bashkisë. Në tabelën më poshtë tregohen më qartë këto vlera:

2017	Popullsia sipas MF_merr sherbim	Sasia e mbetjeve te depozituara Qershor	Norma e grumbullimit Qershor	Sasia e mbetjeve te depozituara Korrik	Norma e grumbullimit Korrik	Sasia e mbetjeve te depozituara Gusht	Norma e grumbullimit Gusht
	nr.	kg/muaj	kg/banore/dite	kg/muaj	kg/banore/dite	kg/muaj	kg/banore/dite
Rrethinat	14,633	598,206	1.36	635,720	1.40	1,001,210	2.21
Postribe	3,676	25,240	0.23	41,040	0.36	245,620	2.16
Guri i Zi	4,784	43,840	0.31	25,740	0.17	35,300	0.24
Berdice	4,748	25,940	0.18	26,280	0.18	36,520	0.25
Velipoje	31,070	245,700	0.26	723,960	0.75	818,840	0.85
Dajc	3,974	30,400	0.25	37,280	0.30	58,260	0.47
Ana Malit	3,208	-	-	16,400	0.16	24,780	0.25
Shale	440	2,960	0.22	-	-	165,060	12.10

Tabela 5 Norma e grumbullimit të mbetjeve për NJA të Bashkisë Shkodër gjatë muajve Qershor dhe Korrik 2017

[Burimi: Bashkia Shkodër]

3.3.2 Përbërja mercologjike e mbetjeve

Gjatë hartimit të Startegjisë dhe Planit Kombëtar të Mbetjeve në vitin 2010, Bashkia Shkodër (vetëm NJA Shkodër), ishte një ndër qytetet, të cilat u morën si qytete kampion për përcaktimin e përbërjes mercologjike të mbetjeve. Në tabelën më poshtë tregohet përbërja mercologjike e qytetit të Shkodrës për 16 rrymat e mbetjeve të përzgjedhura gjatë fazës së kampionimit:

Nr.	Kategoria e mbetjeve	NJA Shkodër
1	Organike	45.4%
2	Druri	1.5%
3	Letër	5.1%
4	Karton	8.3%
5	LD- plastike	10.7%
6	HD-plastike	3.5%
7	Qelqi	5.4%
8	Tekstile	5.1%
9	Metale-ferrore	0.5%
10	Metale me ngjyra	0.5%
11	Mbetje spitalore	4.5%
12	Produkte Kauçuku	0.3%
13	Inerte	7.7%
14	MPEE	0.5%
15	Bateritë	0.03%
16	Prodhome të mbetjeve nga kafshët	1.14%

Tabela 6 Përbërja mercologjike e mbetjeve në nivel kombëtar
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Siç mund të shihet nga grafiku, mbetjet organike përbëjnë përqindjen më të madhe të mbetjeve në qytetin e Shkodrës, të ndjekura nga plastika, letra&kartoni dhe mbetjet inerte. 60.3% e sasisë të mbetjeve në qytetin e Shkodrës është e biodegradueshme (organike, lëndë drusorë, letër dhe karton) dhe potencial për t'u djegur, ndërsa 25.7% të sasisë të mbetjeve të qytetit e përbëjnë mbetjet e riciklueshme (plastikë, qelq, metale, tekstile), ku vetëm mbetjet plastikë përbëjnë 14.5% të sasisë së mbetjeve. Rreth 25% e sasisë janë mbetje të tjera.

3.3.3 Skema e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Shkodër deri në muajin Qershor 2017

Bashkia Shkodër, pas reformës së re administrative dhe territoriale, përbëhet nga 11 NJA: Shkodër, Ana Malit, Dajç, Velipojë, Bërdicë, Guri i Zi, Rrethinat, Postrinë, Shalë, Pult, Shosh. Ajo shtrihet në veri-perëndim të vendit me një pozitë gjeografike mjaft të favorshme me burime të shumta natyrore. Në pjesën perëndimore ajo laget nga liqeni i Shkodrës, dhe në jug ka dalje në detin Adriatik. Në të gjithë territorin e Bashkisë rrjedhin lumenjtë e Drinit, Bunës dhe Kirit. Pjesa veriore e saj lidhet me Alpet e Shqipërisë.

Në Bashkinë Shkodër situata e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në njësitë administrative deri në fund të muajit Maj 2017 jepet si në tabelën më poshtë:

Nr.	NJA	Lloji i shërbimit
1	Shkodër	Ofrohet nga kompani private
2	Ana e Malit	Nga NJA Shkodër mundësohet një makinë 7 ton
3	Bërdica	Nga NJA Shkodër mundësohet një makinë 7ton së bashku me NJA Guri i Zi
4	Dajç	Nga NJA Shkodër mundësohet një makinë 7ton së bashku me NJA Velipojë
5	Guri i Zi	Nga NJA Shkodër mundësohet një makinë 7ton së bashku me NJA Bërdicë
6	Postrinë	Nga NJA Shkodër mundësohet një makinë 7ton së bashku me NJA Rrethinat
7	Pult	<i>Nuk Ofrohet shërbimi</i>
8	Rrethinat	Nga NJA Shkodër mundësohet një makinë 7ton së bashku me NJA Postrinë
9	Shalë	<i>Nuk ofrohet shërbimi</i>
10	Shosh	<i>Nuk ofrohet shërbimi</i>
11	Velipojë	Nga NJA Shkodër mundësohet një makinë 7ton së bashku me NJA Dajç

Tabela 7 Situata e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Shkodër deri në Maj 2017
[Burimi: Bashkia Shkodër]

Siç mund ta shohim edhe nga tabela, vetëm në qytetin e Shkodrës shërbimi ofrohej nga një kompani private, ndërsa në NJA Velipojë, Dajç, Bërdicë, Guri i Zi, Ana Malit, Postrinë dhe Rrethinat, shërbimi ofrohej me anë të një mjeti 7ton të mundësuar nga Bashkia. Shërbimi ishte i kombinuar në disa njësi, ku në Bërdicë dhe Guri i Zi ofrohej së bashku, në Dajç dhe Velipojë ofrohej së bashku dhe Rrethinat dhe Postrinë ofrohej së bashku. Në tre njësitë më veriore të Bashkisë, përkatësisht në Shosh, Shalë dhe Pult shërbimi nuk ofrohej.



Figura 7 Shpërndarja e PGM në NJA Ana Malit

[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Gjatë vizitës në terren, nga 86 kontenerë në terren, 14 prej tyre u evidentuan të dëmtuar, kryesisht të djegur ose pa rrota:



Figura 8 PGM në NJA Ana Malit

[Burimi: Punim i autorit]

Në figurat më sipër paraqitet rruga në hartë dhe distancat në km që përshkruan mjeti 7ton 1 herë në javë për grumbullimin e mbetjeve në NJA Ana Malit deri në depozitimin e tyre në landfillin e Bushatit:

NJA BËRDICË - NJA Bërdicë shtrihet në pjesën jug-lindore të Bashkisë. Nën administrimin e NJA Bërdicë janë 6 fshatra: Bërdicë e Madhe, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Sipërme, Trush, Beltojë, Mali Hebaj. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ofrohet në të gjithë fshatrat e njësisë, 1 herë në javë nga një makinë 7ton në pronësi të Bashkisë Shkodër. Me këtë mjet shërbimi kryhet edhe në NJA Guri i Zi në të njëjtën ditë që kryhet në Bërdicë. Ashtu siç tregohet edhe në hartën më poshtë, shërbimi i mbetjeve kryhet në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave të njësisë, duke mbuluar 69% të territorit të njësisë. Gjatë vizitës në terren u evidentuan 68 PGM, me kontenierë metalikë dhe plastikë me kapacitet 1.1m³ (91 kontenier gjithsej – 32 kontenierë në Bërdicë e Madhe, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Sipërme; 7 kontenier në Mali Hebaj; 27 kontenierë në Beltojë, 25 kontenierë në Trush).




Figura 9 Shpërndarja e PGM në NJA Bërdicë

[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Gjatë vizitës në terren, në të gjithë territorin e njësisë u evidentuan kontenierë plastikë dhe metalikë, të cilët kryesisht ishin në gjendje të mirë, dhe vetëm 6 prej tyre ishin të dëmtuar. Ky informacion jepet më qartë në grafikun dhe figurat më poshtë:




Figura 10 Llojet e kontenierëve në NJA Bërdicë

[Burimi: Punim i autorit]



Figura 11 PGM në NJA Bërdicë

[Burimi: Punim i autorit]

NJA GURI I ZI - NJA Guri i Zi shtrihet në pjesën lindore të Bashkisë. Nën administrimin e NJA Guri i Zi janë 11 fshatra: Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrenc, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldinje, Mazrek, Shpor. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ofrohet pothuajse në të gjitha fshatrat, me përjashtim të Sheldinje, Mazrek dhe Shpor, 2 herë në javë nga një makinë 7ton në pronësi të Bashkisë Shkodër. Me këtë mjet shërbimi kryhet në edhe në NJA Bërdicë në të njëjtën ditë që kryhet në Gurin e Zi. Ashtu siç tregohet edhe në hartën më poshtë, shërbimi i mbetjeve kryhet në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave të njësisë, duke mbuluar 53% të njësisë me shërbim. Gjatë vizitës në terren u evidentuan 55 PGM, me kontenierë metalikë, me kapacitet 1.1m³ (101 kontenier gjithsej – 5 kontenierë në Ganjollë, 31 kontenierë në Juban; 18 kontenierë në Gurin e Zi; 8 kontenierë në Gajtan; 9 kontenierë në Rragam; 17 kontenierë në Rrenc; 10 kontenierë në Kuç; 3 kontenierë në Vukatan).



Figura 12 Shpërndarja e PGM në NJA Guri i Zi

[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Gjatë vizitës në terren, në të gjithë territorin e njësisë u evidentuan kontenierë metalik, ku pjesa më e madhe e tyre ishin të dëmtuar (kryesisht të ndryshkur dhe pa rrota). Në grafikun dhe figurat më poshtë tregohet më qartë kjo situatë:



Figura 13 Gjendja fizike e kontenierëve në NJA Guri i Zi

[Burimi: Punim i autorit]



Figura 14 PGM në NJA Guri i Zi
[Burimi: Punim i autorit]

NJA Rrethinat - NJA Rrethinat shtrihet në pjesët periferike të qytetit të Shkodrës. Nën administrimin e NJA Rrethinat janë 10 fshatra: Dobraq, Grudë e Re, Shtoj i Ri, Guci e Re, Shtoj i Vjetër, Zus, Golem, Hot i Ri, Bleran, Bardhaj. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ofrohej pothuajse në të gjitha fshatat, por në këtë NJA, pjesa më e madhe e PGM janë pika të hapura ilegale. Shërbimi kryhej 4 herë në javë me një makinë 7 ton, e cila vjen nga Bashkia Shkodër (ky shërbim ofrohej edhe në NJA Postribë në frekuenca të tjera). Për fshatin Zus, NJA nuk kryente shërbim, por shërbimi kryhej nga qyteti i Shkodrës. Ashtu siç tregohet edhe në hartën më poshtë, shërbimi i mbetjeve kryhej në të gjitha rrugët kryesore të fshatave të njësisë. Gjatë vizitës në terren janë evidentuar 33 PGM, kryesisht pika të hapura ilegale, dhe vetëm disa prej tyre janë të pajisur me kontenierë metalikë dhe plastikë, me kapacitet 1.1m³.




Figura 15 Shpërndarja e PGM në NJA Rrethinat
[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Gjatë vizitës në terren, në të gjithë territorin e njësisë u evidentuan pika të hapura ilegale dhe shumë pak kontenerë metalik, të ndarë nëpër fshatrat përkatës: 6 kontenerë metalik në Zus, 2 kontenerë metalik në Hot, 1 kontener plastik në Golem, 5 kontenerë plastik në Dobraq dhe 2 kontenerë metalik (16 kontenerë gjithësej). Ndërkohë në të gjithë territorin e NJA u evidentuan 24 pika të hapura ilegale sipas fshatrave përkatës: 2 pika të hapur në Hot; 4 pika të hapura Grudë e Re; 4 pika të Hapura Shtoj i Vjetër; 5 pika të hapura Shtoj i Ri; 6 pika të hapura në Golem; 1 pikë e hapur Dobraq; 2 pika të hapura në Bardhaj. Në grafikun dhe fotot më poshtë tregohet më qartë kjo situatë:




Figura 16 Gjendja fizike e kontenerëve në NJA Rrethinat

[Burimi: Punimi i autorit]



Figura 17 PGM në NJA Rrethinat

[Burimi: Punimi i autorit]

NJA POSTRIBË - NJA Postribë shtrihet në pjesën veri-lindore të Bashkisë. Nën administrimin e NJA Postribë janë 11 fshatra: Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e shtrenjtë, Domen, Shakotë, Prekal, Vilëz. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeteve ofrohej vetëm në 5 fshatra: Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, 2 herë në javë me një makinë 7ton, e cila vinte nga Bashkia Shkodër, e cila shkon edhe në NJA Rrethinat. Ashtu siç tregohet edhe në hartën më poshtë, shërbimi i mbetjeve kryhej në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave të njësisë të cilat mbulohen me

shërbim, duke mbuluar 55% të territorit të saj. Gjatë vizitës në terren u evidentun 29 PGM me kontenierë metalikë dhe plastikë, me kapacitet 1.1m³.




Figura 18 Shpërndarja e PGM në NJA Postribë

[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Gjatë vizitës në terren, në të gjithë territorin e njësisë u evidentuan 48 kontenierë metalik në 29 PGM, konkretisht sipas fshatrave: 18 kontenierë në Mes; 11 kontenierë në Boks; 6 kontenierë në Dragoç; 10 kontenierë në Kullaj; 3 kontenierë në Myselim. Të gjithë kontenierët e shpërndarë në 5 fshatrat e NJA Postribë ishin në gjëndje të mirë fizike. Në fotot më poshtë tregohet më qartë kjo situatë:



Figura 19 PGM në NJA Postribë

[Burimi: Punimi i autorit]

NJA DAJÇ - NJA Dajç shtrihet në pjesën jug-perëndimore të Bashkisë. Nën administrimin e NJA Dajç janë 11 fshatra: Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Sipërm, Belaj, Mali i Gjymit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ofrohet në të gjitha fshatrat e NJA, 2-3 herë në javë nga një makinë 7ton në pronësi të Bashkisë Shkodër, duke mbuluar 73% të njësisë me shërbim. Ky mjet ofronte shërbimin edhe në NJA Velipojë. Ashtu siç tregohet edhe në hartën më poshtë, shërbimi i mbetjeve kryhet pothuajse në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave të njësisë, ndonëse jo gjithmonë cilësia e tyre është e përshtatshme për këtë shërbim. Në këtë njësi, gjatë vizitës në terren janë evidentuar 129 PGM, me kontenerë metalikë, me kapacitet 1.1m³ (165 kontenerë gjithsej).




Figura 20 Shpërndarja e PGM në NJA Dajç

[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Gjatë vizitës në terren, nga 165 kontenerë, 75 prej tyre u evidentuan të dëmtuar, kryesisht të ndryshkur, pasi ishin shumë të vjetër. Një pjesë e tyre ishin në proces zëvendësimi nga njësia. Në grafikun dhe figurat më poshtë tregohet më qartë kjo situatë:



Figura 21 Gjendja fizike e kontenierëve në NJA Dajç

[Burimi: Punimi i autorit]



Figura 22 PGM në NJA Dajç

[Burimi: Punimi i autorit]

NJA Velipojë - NJA Velipojë shtrihet në pjesën jugore të Bashkisë. Nën administrimin e NJA Velipojë janë 10 fshatra: Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks – Rrjoll, Gomsiqe, Baks i ri, Reç i ri, Reç i vjetër, Ças, Mali Kolaj. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ofrohet në të gjitha fshatrat e NJA, 3 herë në javë gjatë stinës së dimrit me një mjet 7ton dhe 2 herë në ditë gjatë stinës së verës me 2 mjete të tjera 5ton, të cilat vijnë të gjitha nga Bashkia Shkodër. Ashtu siç tregohet edhe në hartën më poshtë, shërbimi i mbetjeve kryhet pothuajse në të gjitha rrugët kryesore të fshatrave të njësisë, ku dendësia më e madhe është në zonën e plazhit në fshatin Velipojë. Në këtë njësi, gjatë vizitës në terren u evidentuan 203 PGM, prej të cilave 53 prej tyre janë pika sezonale (vetëm gjatë stinës së verës).



Figura 23 Shpërndarja e PGM në NJA Velipojë

[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Në 203 PGM të evidentuara në NJA Velipojë, u identifikuan 402 kontenierë metalik dhe plastik me kapacitet $1.1m^3$ dhe $0.75m^3$. Në grafikët dhe figurat më poshtë jepet më qartë kjo situatë për kontenierët në NJA Velipojë:




Figura 24 Lloji i kontenierëve në NJA Velipojë

[Burimi: Punimi i autorit]



Figura 25 Gjendja fizike e kontenierëve në NJA Velipojë

[Burimi: Punimi i autorit]



Figura 26 PGM në NJA Velipojë

[Burimi: Punimi i autorit]

3.3.4 Skema e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Shkodër pas Qershorit 2017

Në Qershor të 2017 Bashkia Shkodër nënshkroi kontratat e reja për shërbimin e mbetjeve për njësitë administrative nën juridiksionin e saj. Këto kontrata do të jenë të vlefshme për periudhën 18 mujore Korrik 2017 – Dhjetor 2018. Pas kësaj periudhe bashkia do të hartojë termat e tenderit për kontratën e madhe për të gjithë bashkinë. Konkretisht në tabelat më poshtë tregohen tre kontratat që Bashkia Shkodër ka nënshkruar për ofrimin e shërbimit të mbetjeve në NJA (në NJA Shkodër Bashkia vazhdon ta ofrojë shërbimin si më parë):

Kontrata:	NJA Rrethinat - Postribe - Shalë
Mjetet:	2 mjete - 10ton secila (për Rrethinat dhe Postribën) 1 mjet 5 ton (për NJA Shalë)
Frekuenca:	3 herë në javë në Rrethinat 2 herë në javë në Postribë 1 herë në javë në Shalë
Parku i mjeteve:	Parku 1 - në fshatin Mes në Postribë

Tabela 8 Kontrata Rrethinat – Postribë – Shalë për ofrimin e shërbimit të mbetjeve

[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Kontrata e parë përfshin tre NJA në pjesën veriore të bashkisë, ku për herë të parë shërbimi fillon të ofrohet në NJA Shalë. Për këtë kontratë, me kërkesë të bashkisë në termat e tenderit, kompania private ka vënë në dispozicion 2 mjete teknologjike me kapacitet 10ton për grumbullimin e mbetjeve në NJA Rrethinat dhe Postribë (ku njëra do të jetë rezervë) dhe 1 mjet të hapur 5ton për grumbullimin e mbetjeve në NJA Shalë. Parku i mjeteve është në fshatin Mes të NJA Postribë. Bazuar në frekuencat e mëparshme të ofrimit të shërbimit parashikohet që shërbimi të ofrohet 3 herë në javë në NJA Rrethinat, 2 herë në NJA Postribë dhe 1 herë në javë në NJA Shalë.

Sipas parashikimeve të bashkisë, mjeti 10ton do të kryejë shërbimin në ditë të ndryshme në secilën nga njësitë Rrethinat dhe Postribë dhe më pas do të dërgojë mbetjet në landfillin e Bushatit. Në lidhje me njësinë Shalë, parashikohet që mbetjet të grumbullohen në ditën që shërbimi kryhet në NJA Postribë, ku mjeti 10ton do të mbledhë mbetjet e NJA Shalë dhe do t'i dërgojë në landfillin e Bushatit. Në tabelën më poshtë tregohet më qartë grafiku i parashikura për ofrimin e shërbimit sipas kësaj kontrate:

Dimër/Verë	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë
Rrethinat	Niset nga Mes		Niset nga Mes		Niset nga Mes	
Postribë		Niset nga Mes		Niset nga Mes		
Shalë				Niset nga Mes		
Landfill						

Tabela 9 Frekuenca e ofrimit të shërbimit për kontratën Rrethinat – Postribë – Shalë
[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Kontrata:	NJA Ana Malit - Bërdicë - Guri i Zi
Mjetet:	2 mjete - 10 ton secila
Frekuenca:	2 herë në javë në Ana Malit
	2 herë në javë në Bërdicë
	2 herë në javë në Guri i Zi
Parku i mjeteve:	Parku 1 - në Gurin e Zi - kryqëzimi (Gajtan - Rrenc)

Tabela 10 Kontrata Ana Malit – Bërdicë – Guri i Zi për ofrimin e shërbimit të mbetjeve
[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Kontrata e dytë përfshin tre NJA në pjesën jugore të bashkisë. Për këtë kontratë, me kërkesë të bashkisë në termat e tenderit, kompania private ka vënë në dispozicion 2 mjete teknologjike me kapacitet 10ton për grumbullimin e mbetjeve në të tre NJA (Ana Malit, Bërdicë dhe Guri i Zi). Parku i mjeteve është në NJA Guri i Zi në kryqëzimin midis dy fshatrave Gajtan- Rrenc. Bazuar në frekuencat e mëparshme të ofrimit të shërbimit parashikohet që shërbimi të ofrohet 2 herë në javë në të tre njësitë.

Sipas parashikimeve të bashkisë, mjeti 10ton do të kryejë shërbimin në ditë të ndryshme në secilën nga njësitë dhe më pas do të dërgojë mbetjet në landfillin e Bushatit. Në tabelën më poshtë tregohet më qartë grafiku i parashikura për ofrimin e shërbimit sipas kësaj kontrate:

Dimër/Verë	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë
Ana Malit	Niset nga Guri i Zi				Niset nga Guri i Zi	
Bërdicë		Niset nga Guri i Zi		Niset nga Guri i Zi		
Guri i Zi			Niset nga Guri i Zi			Niset nga Guri i Zi
Landfill						

Tabela 11 Frekuenca e ofrimit të shërbimit për kontratën Rrethinat – Postribë – Shalë
[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Kontrata:	NJA Velipojë -Dajç
Mjetet:	2 mjete - 10 ton
	2 mjete 5 ton
	1 mjet 3ton i hapur
Frekuenca:	3 herë në javë në Velipoja (dimër/verë pa zonën e plazhit)
	2 herë në javë në Dajç
	2 herë në ditë (zona e plazhit në Verë)
Parku i mjeteve:	Parku - në fshatin Gomsiqe në Velipojë

Tabela 12 Kontrata Velipojë – Dajç për ofrimin e shërbimit të mbetjeve
[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Kontrata e tretë përfshin dy NJA në pjesën perëndimore të bashkisë (Velipojë dhe Dajç). Për këtë kontratë, me kërkesë të bashkisë në termat e tenderit, kompania private ka vënë në dispozicion 2 mjete teknologjike me kapacitet 10ton për grumbullimin e mbetjeve në NJA Dajç dhe Velipojë (pa zonën e plazhit), 2 mjete 5ton për grumbullimin e mbetjeve në zonën e plazhit vetëm gjatë periudhës së verës, dhe 1 mjet 3ton të hapur për grumbullimin e mbetjeve gjatë vijës bregdetare gjatë sezonit të verës. Parku i mjeteve është në fshatin Gomsiqe të NJA Velipojë. Bazuar në frekuencat e mëparshme të ofrimit të shërbimit parashikohet që shërbimi të ofrohet 3 herë në javë në NJA Velipojë (pa zonën e plazhit), 2 herë në javë në NJA Dajç dhe 2 herë në ditë gjatë 7 ditëve të javës në NJA Velipojë në zonën e plazhit.

Sipas parashikimeve të bashkisë, mjeti 10ton do të kryejë shërbimin në ditë të ndryshme në secilën nga njësitë Velipojë (pa zonën e plazhit) dhe Dajç dhe më pas do të dërgojë mbetjet në landfillin e Bushatit. Në lidhje me zonën e plazhit në NJA Velipojë, gjatë stinës së verës parashikohet ofrimi i shërbimit me dy mjetet 5ton, 2 herë në ditë gjatë 7 ditëve të javës për periudhën e verës, dhe më pas mbetjet do të dërgohen në stacionin e transferimit (ish zona e vend depozitimit të Velipojës). Më pas mbetjet me mjetin 10ton do të dërgohen në landfillin e Bushatit. Mjeti 3ton i hapur do të grumbullojë mbetjet në vijën bregdetare dhe do t'i transportojë për në stacionin e transferimit, ku më pas me mjetin 10ton do të dërgohen në landfillin e Bushatit. Në tabelën më poshtë tregohet më qartë grafiku i parashikura për ofrimin e shërbimit sipas kësaj kontrate:

Dimër/Verë	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Dielë
Velipojë	Niset nga Gomsiqe		Niset nga Gomsiqe		Niset nga Gomsiqe		
Velipojë (Zona e plazhit në verë)	Niset nga Gomsiqet (turni 1)	Niset nga Gomsiqet (turni 1)	Niset nga Gomsiqet (turni 1)	Niset nga Gomsiqet (turni 1)	Niset nga Gomsiqet (turni 1)	Niset nga Gomsiqet (turni 1)	Niset nga Gomsiqet (turni 1)
	Niset nga Gomsiqe (turini 2)	Niset nga Gomsiqe (turini 2) -në ST	Niset nga Gomsiqe (turini 2)	Niset nga Gomsiqe (turini 2)	Niset nga Gomsiqe (turini 2)	Niset nga Gomsiqe (turini 2)	Niset nga Gomsiqe (turini 2)
	Niset nga Gomsiqe per në plazh	Niset nga Gomsiqe per në plazh -në ST	Niset nga Gomsiqe per në plazh	Niset nga Gomsiqe per në plazh	Niset nga Gomsiqe per në plazh	Niset nga Gomsiqe per në plazh	Niset nga Gomsiqe per në plazh
Dajç		Niset nga Gomsiqe		Niset nga Gomsiqe			
Landfill	Fshatrat e tjerë pa zonën e plazhit (dimër/verë)	Merr mbetjet e plazhit nga pika e grumbullimit në ST (verë)	Fshatrat e tjerë pa zonën e plazhit (dimër/verë)	Merr mbetjet e plazhit nga pika e grumbullimit në ST (verë)	Fshatrat e tjerë pa zonën e plazhit (dimër/verë)	Merr mbetjet e plazhit nga pika e grumbullimit në ST (verë)	Merr mbetjet e plazhit nga pika e grumbullimit në ST (verë)
	Merr mbetjet e plazhit nga pika e grumbullimit në ST (verë)	Dajç - Bushat (dimër/verë)	Merr mbetjet e plazhit nga pika e grumbullimit në ST (verë)	Dajç - Bushat (dimër/verë)	Merr mbetjet e plazhit nga pika e grumbullimit në ST (verë)		

Tabela 13 Frekuenca e ofrimit të shërbimit për kontratën Velipojë - Dajç
[Burimi: Bashkia Shkodër, punimi i autorit]

Në tabelën më poshtë tregohet një pasqyrë e qartë e të gjitha mjeteve që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër për ofrimin e shërbimit të mbetjeve:

NJA/kontrata	Mjet teknologjik 10ton	Mjet teknologjik 7ton	Mjet teknologjik 5ton	Mjet i hapur 5 ton	Mjet i hapur 3 ton
	nr.		nr.	nr.	nr.
Shkodër	5	2			
Rrethinat - Postribë - Shalë	2			1	
Ana Malit - Bërdicë - Guri i Zi	2				
Velipojë - Dajç	2		2	2	1
Total	11	2	2	3	1

Tabela 14 Mjetet për shërbimin e mbetjeve në Bashkinë SHkodër
[Burimi: Bashkia Shkodër]



Figura 27 Mjete të ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve

[Burimi: Punimi i autorit]

Gjithsej Bashkia Shkodër ka në përdorim 15 mjete teknologjike dhe dy mjete të tjera rezervë në pronësi të Bashkisë Shkodër.

3.3.5 Riciklimi dhe kompostimi

Në territorin e Bashkisë Shkodër nuk regjistrohen aktivitete në lidhje me riciklimin dhe kompostimin në asnjë nga njësitë administrative. Qyteti i Shkodrës vite më parë ka testuar vendosjen e sistemit me tre kosha në rrugët kryesore të qytetit, por kjo skeme nuk funksionoi dhe bashkia përsëri ka aplikuar sistemin e grumbullimit të mbetjeve vetëm më një kosh.

Në të shkuarën për pjesën e qytetit ka patur përpjekje për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme nga sektori i biznesit, por përsëri këto përpjekje nuk kanë mundur të kenë sukses të mëtejshëm.

Forcimi i biznesit dhe industrisë së riciklimin në vend dhe në rajonin e Shkodrës do të jetë faktor i rëndësishëm së bashku me aktorët kryesorë për zhvillimin e skemave të riciklimin. Skema aktuale e grumbullimit të mbetjeve është klasike, ku mbetjet mblidhen dhe transportohen të përzier, pa ndjekur procesin e ndarjes, për në landfillin e Bushatit. Aktualisht, ndonëse në bashkinë Shkodër mund të ketë patur kërkesa nga aktorë të rajoneve të tjera për të mbledhur disa fraksione të caktuara të mbetjeve të riciklueshme, popullsia Rome është ajo që kryen një aktivitet të përditshëm informal në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme nga PGM apo në depozitimet ilegale në territor.

Detyra kryesore e Bashkisë Shkodër është të nxisë dhe krijojë një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit të riciklimit, duke ngritur një skemë efektive dhe efikase për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme si plastikë, letër&karton, metal, qelq apo produkte të tjera të cilat kanë interes të lartë në tregun shqiptar ashtu dhe në rajon. Afrimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit për të mbështetur skemat lokale të ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve në zonat urbane të bashkisë do të mundësojë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori dhe do të ulë barrën financiare të bashkisë.

Përfshirja e sektorit privat, me anë të konçesionit apo PPP do të inkurajohet si një mekanizëm për ofrimin e zgjidhjes më të mirë ekonomike që do të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore. Identifikimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit që është aktiv në rajon apo jashtë kufirit shtetëror do të jetë një nga detyrat kryesore të bashkisë për të mbështetur riciklimin në qytet. Skemat e partneritetit - publik-privat mbeten zgjidhjet më të mundshme për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori.

3.3.6 Landfilli i Bushatit

Të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër i transportojnë mbetjet për depozitim final për në landfillin e Bushatit. Kur mjetet teknologjike hynë në landfill ato peshohen rregullisht dhe më pas depozitohen në landfill. Ndonëse impianti i trajtimit të mbetjeve në Bushatit ka infrastrukturën që mbetjet të ndahen mbetjet e riciklueshme, në fakt në impiant ndodh vetëm procesi i depozitimit dhe ngjeshjes së mbetjeve. Bashkia Shkodër ka punësuar një punonjës të saj në landfill, i cili mban evidencat në lidhje me ngarkesat që vijnë nga njësitë administrative. Në këtë landfill, si në shumë vende të tjera depozitimi i mbetjeve në vend, sektori informal kryen aktivitetet pothuajse të përditshëm në grumbullimin e mbetjeve plastike, ku grumbujt e tyre janë shumë evidente.

Firma private e cila ushtron aktivitetin teknologjik në impiant bën ngjeshjen dhe mbulimin me dhe të mbetjeve pasi ato depozitohen. Në këtë impiant është instaluar në hyrje të tij një linjë për ndarjen e mbetjeve, por asnjëherë nuk është vendosur në punë. Sistemi i kullimit të ujrave të shiut mbledh ujrat sipërfaqësorë dhe i devijon ato nga venddepozitimi, por impianti i pastrimit të tyre nuk funksionon. Si pasojë shllami derdhet herë pas here në sistemin e gropave septike duke krijuar një rrezik potencial për mjedisin. Landfilli aktualisht ka hyrë në zonën e maturimit të sasisë të gazit të metanit (CH₄), i cili ka filluar të japet nga dy puse dhe më pas realizohet djegia në natyrë.



Figura 28 Landfilli i Bushatit
[Burimi: Autori]

IV. ASPEKTET FINANCIARE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE

4.1 Kosto e plotë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave

Sipas të dhënave të marra nga Bashkia Shkodër për vitin 2016 Bashkia ka parashikuar buxhetin për shërbimin e mbetjeve sipas NJA të ndara, ashtu siç ishin përpara reformës administrative territoriale. Ndërsa për vitin 2017, buxheti është parashikuar për të gjithë bashkinë e madhe. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve parashikohet si pjese e buxhetit për shërbimet publike që harton Bashkia. Në tabelën më poshtë tregohen më qartë zërat e buxhetit të parashikuar për Bashkinë Shkodër për vitin 2016 dhe 2017 për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve:

Programi Buxhetor i Bashkisë Shkodër - shërbimi i mbetjeve	2016			2017		
	Vlera e planifikuar (lek/vit)	Vlera e realizuar (lek/vit)	Përqindja e realizimit (%)	Vlera e planifikuar (lek/vit)	Vlera e realizuar (lek/vit)	Përqindja e realizimit (%)
Shërbimi i pastrimit Zona A	51,785,083	50,919,921	98%			
Shërbimi i pastrimit zona B	47,460,697	46,554,487	98%			
Shërbimi i Pastrimit të qytetit				99,246,000	74,487,912	75%
Depozitimi i mbetjeve në landfillin e Bushatit për të gjithë bashkinë	14,615,670	13,515,645	92%	18,903,000	22,535,430	119%
Modifikimi i mekanizmit të kapjes së kontenierëve për mjetin e NJA Guri i Zi				250,000	202,585	81%
Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane NJA Velipojë	18,889,518	17,788,128	94%			
Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane NJA Dajç	259,500	259,500	100%			
Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane NJA Guri i Zi	-	-				
Shërbimi i pastrimit NJA Velipojë- Dajç				10,656,000	8,416,649	79%
Shërbimi i pastrimit NJA Rrethinat - Postribë - Shalë	35,032,962	35,032,962	100%	13,322,000	7,885,953	59%
Shërbimi i pastrimit NJA Ana Malit - Bërdicë - Guri i Zi				5,871,000	569,772	10%
Blerje kontenier për shërbimin e pastrimit	16,692,000	16,692,000	100%			
Shpenzime për mjete transporti	-	455,584				
Blerje materiale për mirëmbajtje	-	2,008,000				
Transport mbetjeve ndërtimore				600,000	-	0%
Investime				10,079,000	-	0%
Karburant				1,020,000	1,020,000	100%
Pjesë këmbimi				400,000	-	0%
Mirëmbajtje				418,000	-	0%
Siguracion				60,000	37,500	63%
Taksë kolaudimi				14,000	-	0%
Totali	184,735,430	183,226,227	99%	160,839,000	115,155,801	72%

Tabela 15 Përmbledhje e buxhetit të Bashkisë Shkodër për menaxhimin e mbetjeve [Burimi: Bashkia Shkodër]³

Nga të dhënat e tabelës shohim se buxheti për shërbimin e mbetjeve i parashikuar për vitin 2017 është më i ulët se buxheti i parashikuar për vitin 2016, ku bashkia konceptohej si e ndarë dhe jo si një e tërë. Në tabelën më poshtë jepet një pasqyrë më e qartë në lidhje me përqindjen që zë buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt buxhetit total të bashkisë për dy vitet e fundit:

³ Burimi: Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër

	Buxheti i Bashkisë (lek/vit)	Buxheti i shërbimeve publike (lek/vit)	Buxheti për menaxhimin e mbetjeve (lek/vit)	% e buxhetit të mbetjeve kundrejt buxhetit të shërbimeve publike (lek/vit)	% e buxhetit të mbetjeve kundrejt buxhetit total të bashkisë (lek/vit)
Viti 2016	1,750,809,326	316,426,251	184,735,430	58%	11%
Viti 2017	2,584,945,002	330,429,000	160,839,000	49%	6%

Tabela 16 Buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt buxhetit total të bashkisë⁴
[Burimi: Bashkia Shkodër]

Siç mund ta shohim, buxheti për menaxhimin e mbetjeve përbënte 17% të buxhetit total të bashkisë dhe 58% të buxhetit për shërbimet publike për vitin 2016 (njësitë administrative kishin buxhete të ndara nga bashkia e madhe). Ndërkohë për vitin 2017, bashkia e madhe ka alokuar vetëm 5% të buxhetit të saj total për menaxhimin e mbetjeve, ose 45% të buxhetit për shërbimet publike. Ndonëse buxheti i parashikuar për mbetjet, në rastin e bashkisë së madhe përbën vetëm 5% të buxhetit total, ai përsëri përbën pothuajse 50% të buxhetit për shërbimet publike.

4.2 Sistemi i tarifave të menaxhimit të mbetjeve

Bashkia Shkodër aplikon tarifa të ndryshme për NJA. Në grafikun më poshtë tregohet më qartë niveli i tarifave për njësitë administrative të bashkisë:




Figura 29 Niveli i tarifave të pastrimit në NJA të Bashkisë Shkodër
[Burimi: zhvillimi nga autori]

NJA Shkodër ka nivelin më të lartë të tarifës për mbetjet (3,000 lek/vit për familje) e ndjekur nga NJA të cilat marrin shërbim aktualisht (Ana Malit, Bërdicë, Guri i Zi, Dajç, Vellipojë, Rrethinat, Postribë, Shalë), 1,500 lek/vit për familje, dhe 1,000 në vit për familje për njësitë të cilat ende nuk kanë shërbim të mirëfilltë (Pult dhe Shosh).

Në tabelën më poshtë tregohet se si kanë përfomuar njësitë administrative gjatë vitit 2016 dhe 2017 me mbledhjen e të ardhurave:

Të ardhurat nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve		
NJA	2016	2017

⁴ Burimi: Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër

	Planifikuara (lek/vit)	Realizuara (lek/vit)	Përqindja e realizimit (%)	Planifikuara (lek/vit)	Realizuara (lek/vit)	Përqindja e realizimit (%)
Shkodër	99,595,000	110,518,000	111%	105,675,000	86,762,570	82%
Ana Malit	1,516,000	493,750	33%	1,260,000	761,167	60%
Bërdicë	1,960,000	2,012,470	103%	3,907,000	1,564,426	40%
Dajç	1,870,000	1,077,600	58%	1,870,000	528,944	28%
Guri i Zi	2,182,000	1,191,190	55%	4,445,000	953,944	21%
Postribë	1,280,000	704,063	55%	3,315,000	1,246,973	38%
Pult	109,500	-	0%	109,500	-	0%
Rrethinat	6,016,000	2,815,440	47%	4,933,000	2,246,793	46%
Shalë	151,500	-	0%	151,500	34,584	23%
Shosh	64,000	-	0%	64,000	8,750	14%
Velipojë	9,265,000	4,599,190	50%	9,290,000	2,876,876	31%

Tabela 17 Të ardhurat nga tarifa e mbetjeve
[Burimi: Bashkia Shkodër]⁵

Siç tregohet në tabelë, NJA Shkodër dhe Bërdicë janë dy nga njësitë të cilat kanë performuar më mirë në lidhje me mbledhjen e të ardhurave gjatë vitit 2016. Njësitë e tjera kanë arritur të grumbullojnë rreth 50% të tarifave, ku përjashtim bën NJA Ana Malit me 33% dhe njësitë Shosh, Pult dhe Shalë, të cilat nuk kanë mbledhur tarifën për mbetjet. Në grafikun më poshtë tregohet se si kanë performuar njësitë administrative gjatë vitit 2016 në lidhje me mbledhjen e tarifave sipas kategorive të konsumatorëve, dhe sa ato kanë mbuluar buxhetin vjetor të tyre:




Figura 30 Performanca financiare e menaxhimit të mbetjeve në Bashkianë Shkodër 2016
[Burimi: Bashkia Shkodër, punuar nga autori]

Për NJA Guri i Zi, llogaritjet që kosto njësi për ton mbetje është 10,881⁶ lek/ton, ndërsa kosto për banorë është 457 lek/banorë. Mbulimi i koston së shërbimit nga tarifa llogaritjet të jetë në masën 25%, ku familjet zënë vetëm 8% të mbulimit të koston dhe bizneset 16%. Eficienca në mbledhjen e tarifës së mbetjeve në NJA Guri i Zi llogaritjet të jetë 55% (27% familjet dhe 113% bizneset).

⁵ Burimi: Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër

⁶ Kjo kosto ka dalë shumë e lartë pasi është llogaritur mbi bazën e familjeve, të cilat marrin aktualisht shërbim

Për NJA Bërdicë, llogaritet që kosto njësi për ton mbetje është 19,047⁷ lek/ton, ndërsa kosto për banorë është 434 lek/banorë. Mbulimi i koston së shërbimit nga tarifa llogaritet të jetë në masën 56%, ku familjet zënë vetëm 16% të mbulimit të koston dhe bizneset 40%. Eficienca në mbledhjen e tarifës së mbetjeve në NJA Bërdicë llogaritet të jetë 103% (41% familjet dhe 243% bizneset).

Për NJA Velipojë, llogaritet që kosto njësi për ton mbetje është 11,980⁸ lek/ton, ndërsa kosto për banorë është 2,058 lek/banorë. Mbulimi i koston së shërbimit nga tarifa llogaritet të jetë në masën 33%, ku familjet zënë vetëm 11% të mbulimit të koston dhe bizneset 23%. Eficienca në mbledhjen e tarifës së mbetjeve në NJA Veipojë llogaritet të jetë 50% (49% familjet dhe 50% bizneset).

Për NJA Ana Malit, llogaritet që kosto njësi për ton mbetje është 20,995⁹ lek/ton, ndërsa kosto për banorë është 781 lek/banorë. Mbulimi i koston së shërbimit nga tarifa llogaritet të jetë në masën 12%, ku familjet zënë vetëm 1% të mbulimit të koston dhe bizneset 11%. Eficienca në mbledhjen e tarifës së mbetjeve në NJA Ana Malit llogaritet të jetë 33% (4.7% familjet dhe 79.4% bizneset).

Për NJA Rrethinat, llogaritet që kosto njësi për ton mbetje është 26,115¹⁰ lek/ton, ndërsa kosto për banorë është 748 lek/banorë. Mbulimi i koston së shërbimit nga tarifa llogaritet të jetë në masën 17%, ku familjet zënë vetëm 4% të mbulimit të koston dhe bizneset 13%. Eficienca në mbledhjen e tarifës së mbetjeve në NJA Rrethinat llogaritet të jetë 47% (15% familjet dhe 167% bizneset).

Për NJA Postribë, llogaritet që kosto njësi për ton mbetje është 27,667¹¹ lek/ton, ndërsa kosto për banorë është 646 lek/banorë. Mbulimi i koston së shërbimit nga tarifa llogaritet të jetë në masën 12%, ku familjet zënë vetëm 2% të mbulimit të koston dhe bizneset 10%. Eficienca në mbledhjen e tarifës së mbetjeve në NJA Postribë llogaritet të jetë 55% (14% familjet dhe 138% bizneset).

Për NJA Dajç, llogaritet që kosto njësi për ton mbetje është 9,976¹² lek/ton, ndërsa kosto për banorë është 409 lek/banorë. Mbulimi i koston së shërbimit nga tarifa llogaritet të jetë në masën 38%, ku familjet zënë vetëm 23% të mbulimit të koston dhe bizneset 14%. Eficienca në mbledhjen e tarifës së mbetjeve në NJA Dajç llogaritet të jetë 58% (50% familjet dhe 76% bizneset).

Për NJA Shkodër, llogaritet që kosto njësi për ton mbetje është 4,733 lek/ton, ndërsa kosto për banorë është 1,456 lek/banorë. Mbulimi i koston së shërbimit nga tarifa llogaritet të jetë në masën 83%, ku familjet zënë vetëm 29% të mbulimit të koston dhe bizneset 54%. Eficienca në mbledhjen e tarifës së mbetjeve në NJA Shkodër llogaritet të jetë 111% (85% familjet dhe 133% bizneset).

4.2.1 Indikatorët e performancës

Në përfundim të procesit për evidentimin e gjendjes ekzistues të shërbimit në Bashkinë Shkodër, u bë vlerësimi i performancës bazuar në indikatorët: i) Cilësia e shërbimit; ii) Qendrueshmëria mjedisore; iii) Qendrueshmëria ekonomike dhe financiare. Secili nga tre indikatorët ka indikatorët e tij specifikë, të cilët u përdorën për llogaritjen e indikatorit kryesor, siç shpjegohet më poshtë:

Cilësia e shërbimit - Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë.

- a. **C1 Mbulimi i zonës më shërbim:** ky indikator tregon sasinë e mbetjeve të grumbulluara në NJA nga firma private e autorizuar ose nga njësia vetë (nëse e kryen ajo shërbimin) kundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në njësi. Për këtë indikator u përdor formula për zonat urabne dhe për zonat rurale të Bashkisë Shkodër:

⁷ Kjo kosto ka dalë shumë e lartë pasi është llogaritur mbi bazën e familjeve, të cilat marrin aktualisht shërbim

⁸ Kjo kosto ka dalë kaq shumë e lartë pasi është llogaritur mbi bazën e familjeve, të cilat marrin aktualisht shërbim

⁹ Kjo kosto ka dalë kaq shumë e lartë pasi është llogaritur mbi bazën e familjeve, të cilat marrin aktualisht shërbim

¹⁰ Kjo kosto ka dalë shumë e lartë pasi është llogaritur mbi bazën e familjeve, të cilat marrin aktualisht shërbim

¹¹ Kjo kosto ka dalë shumë e lartë pasi është llogaritur mbi bazën e familjeve, të cilat marrin aktualisht shërbim

¹² Kjo kosto ka dalë kaq shumë e lartë pasi është llogaritur mbi bazën e familjeve, të cilat marrin aktualisht shërbim

$$C1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që gjenerohen në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Në rastin e Bashkisë Shkodër për llogaritjen e këtij indikator, janë marrë vlerat e sasisë së mbetjeve që depozitohen në Landfillin e Bushatit dhe vlerat e llogaritura në sajë të normës së gjenerimit dhe numrit të popullsisë, për të llogaritur përqindjen e mbulimit të zonës me shërbim.

- b. **C2:** Pastërtia e bashkisë: ky është një indikator gjithëpërfshirës, i cili vlerësohet nga tre kriteret vlerësimi:
- i. Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve (prezenca e mbetjeve të akumuara rreth PGM);
 - j. Efektiviteti i pastrimit të rrugëve (prezenca e mbetjeve në rrugë);
 - k. Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve në zonat e largëta (prezenca e mbetjeve të akumuara/pika ilegale/ djegie të mbetjeve në rrugë).

Në përcaktimin e këtij indikator, situata është vlerësuar si nga vëzhgimet në terren në të gjitha NJA-ve të Bashkisë Shkodër, ashtu edhe në bashkëpunim me stafin e Bashkisë dhe të NJA-ve për të na diktuar fenomene të ndryshme në lidhje me pastërtinë e territorit dhe zonat ku duhet të ndërhyhet.

- c. **C3:** Shkalla e kënaqësisë publike: ky është një indikator cilësor për shërbimin që ofron bashkia, dhe vlerësohet në sajë të pyetësorëve të ndryshëm me komunitetin. Zakonisht ky indikator llogaritet në sajë të një pyetje të vetme: **A jeni të kënaqur me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve që ofrohet në njësinë tuaj?**

Për vlerësimin e këtij indikator kanë shërbyer fushatat e pyetësorëve dhe dëgjesta publike të zhvilluara nga bashkia

Qendrueshmëria mjedisore – Ky indikator përbëhet nga dy indikatorë specifikë.

- a. **D1:** Shkalla e grumbullimit të diferencuar: ky indikator prezanton shkallën e sasisë të mbetjeve që grumbullohen të ndara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara. Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet si më poshtë:

$$D1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen të ndara në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen total në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Në lidhje me llogaritjen e këtij indikator, për NJA-ve të bashkisë nuk është kryer ndonjë llogaritje pasi nuk ka iniciativa për grumbullimin e ndarë të mbetjeve.

- b. **D2:** Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave: ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve që trajtohen në impiante të autorizuara. Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet si më poshtë:

$$D2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që trajtohen në impiante } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen total } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Në lidhje me këtë indikator, të gjitha NJA tashmë i dërgojnë mbetjet në landfillin e Bushatit, ndonëse në territor ka përsëri pika ilegale ku hidhen mbetjet.

Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare: Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë.

- a. **E1** Mbulimi i Kostos: ky indikator mat sa kosto e plotë e shërbimit e mbuluar nga grumbullimi i tarifave. Formula më poshtë tregon se llogaritet ky indikator:

$$E1 = \frac{\text{Të ardhurat nga tarifa e mbetjeve} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Kosto totale e shërbimit} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Llogaritja e këtij indikator, ashtu siç tregohet edhe në analizën financiare të gjendjes ekzistuese, është kryer në sajë të konsultave me zyrën e financës dhe të taksave në bashki për të gjitha NJA-ve.

- b. **E2** Shkalla e mbledhjes së tarifës: ky indikator reflekton kapacitetin e popullsisë për të paguar tarifën. Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet në formulën më poshtë:

$$E2 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga tarifa e pastrimit} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Totali i të ardhurave të planifikuara} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Llogaritja e këtij indikator, ashtu siç tregohet edhe në analizën financiare të gjendjes ekzistuese, është kryer në sajë të konsultave me zyrën taksave në bashki për të gjitha NJA-ve.

- c. **E3** Transparenca në systemin e faturimit: ky është një indikator cilësor, i cili ka tre shkallë vlerësimi:
- i. I ulët: nuk ka një sistem faturimi për tarifën e pastrimit
 - ii. Mesatar: ka një sistem faturimi dhe konsumatori merr një faturë
 - iii. I lartë: ka një sistem faturimi dhe konsumatori ka informacion dhe kupton tarifën e llogaritur dhe mënyra e llogaritjes është e qartë dhe transparente për të gjithë komunitetin

Në vlerësimin e këtij indikator është punuar me zyrën e taksave për të kuptuar systemin e ngritur të faturimit në secilën NJA-ve.

Në tabelën më poshtë jepet më qartë kjo situatë për 8 NJA të Bashkisë Shkodër ku ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve:

	Indikatorët	Shkodër	Ana Malit	Bërdicë	Guri i Zi	Postrinë	Rrethinat	Dajç	Velipojë
Cilësia e shërbimit	C1 Mbulimi i zonës me shërbim	90%	73%	69%	53%	55%	68%	73%	70%
	C2 Pastërtia e qytetit/zonës	82%	32%	49%	32%	32%	32%	49%	49%
	C3 Shkalla e kënaqësisë publike	I panjohur	I panjohur	I panjohur	I panjohur	I panjohur	I panjohur	I panjohur	I panjohur
Qendrueshmëria mjedisore	D1 Shkalla e grumbullimit të diferencuar	0.2%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
	D2 Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave	100%	22%	90%	90%	80%	80%	60%	50%
Qendrueshmëria ekonomike dhe financiare	E1 Mbulimi i kostos	83%	12%	56%	25%	12%	17%	38%	33%
	E2 Shkalla e mbledhjes së tarifës	111%	33%	103%	55%	55%	47%	58%	50%
	E3 Transparenca në sistemin e faturimit	Mestar	I ulët	I ulët	I ulët	I ulët	I ulët	I ulët	I ulët

Tabela 18 Indikatorët e performancës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër [Burimi: Punuar nga autori]

Indikatori I: Cilësia e shërbimit

NJA Shkodër është ajo e cila performon më mirë, duke mbuluar 90% të zonës me shërbim me një nivel pastërtie 82%. Ndërsa njësitë e tjera kanë një mbulim mesatar të territorit me shërbim, por niveli i pastërtisë së zonës në pjesën më të madhe të tyre është nën 50%.

Indikatori II: Qendrueshmëria Mjedisore

Asnjëra nga njësitë nuk ka një performancë të mirë për grumbullimin e diferencuar, ku vetëm në NJA Shkodër është 0.2%. Pothuajse të gjitha njësitë i dërgojnë mbetjet në landfillin e Bushatit dhe kanë një performancë të kënaqshme në lidhje me mbetjet e trajtuara sipas normave.

Indikatori III: Qendrueshmëria ekonomike dhe financiare

Vetëm NJA Shkodër ka një performancë të mirë të mbulimit të kostos, të mbledhjes së tarifës dhe një nivel mesatar të transparencës në sistemin e faturimit. Në njësitë e tjera performanca është nga ulët deri në mesatare, ku ka njësi që nuk mbulojnë as 20% të kostos nga tarifa (Postrinë dhe Rrethinat), por ka nga ato që kanë një nivel të lartë të mbledhjes së tarifës (Bërdica).

V. PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

5.1 Vizioni

Vizioni i planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Shkodër u formëzua në sajë të një procesi të vazhdueshëm diskutimi dhe konsultimi midis palëve të interesuara të përfshira drejtpërdrejtë në përgatitjen e planit (Grupi i Punës dhe Kryetarja e Bashkisë Zj. Voltana ADEMI, grupi i ekspertëve konsulentë dhe Grupi i punës i dldp Helvetas Inter-Cooperation), në sajë të analizimit gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit dhe propozimeve për konsolidimin e shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë.



Figura 31 Diskutime me grupin e punës në Bashkinë Shkodër për vizionin dhe objektivat e planit [Burimi: dldp]

Referuar statusit aktual të menaxhimit të mbetjeve, prioritetëve të përgjithshme dhe konkrete në kuadrin e ndarjes së re administrative si dhe pritshmërive për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, nevojës për ndryshim, dhe ruajtjes së burimeve natyrore u ra dakord që vizioni i bashkisë të jetë:

“Bashkia Shkodër, një bashki e pastër, me një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor dhe turistik, ku ofrohen shërbimet e menaxhimit të mbetjeve sipas standardeve më të larta në çdo njësi administrative në territorin e saj dhe aplikohen skemat e reja 3R për mbetjet”.

5.2 Objektivat

Bashkia Shkodër gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit lokal për menaxhimin e mbetjeve kërkon mbi të gjitha të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim, duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve për në landfillin e Bushatit. Më tej ajo kërkon të fillojë të zbatojë skema për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane, duke synuar mbylljen e ciklit të plotë të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Ky plan ka parashikuar hartimin e objektivave emergjente dhe objektiva afat gjatë:

Objektivat emergjente:

1. Plotësim i kuadrit ligjor dhe rregullator lokal për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane

- Miratimi i planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve;
- Hartimi i rregulloreve për shërbime të caktuara të mbetjeve, duke përcaktuara standardet minimale që duhen plotësuar;
- Adoptimi i modelit të dldp-së për llogaritjen e kostos dhe tarifave
- Përmirësimi i i sistemit të klientëve dhe rifreskimi databaës

2. Konsolidimi i shërbimit në njësitë administrative (Shkodër, Ana Malit, Dajç, Velipojë, Guri i Zi, Bërdicë, Rrethinat, Postrinë dhe Shalë) ku ofrohet shërbimi dhe zgjerimi i shërbimit në njësitë administrative (Pult dhe Shosh) ku aktualisht nuk ofrohet shërbim (në masën 60%) gjatë periudhës 2017 – 2020.

- Në NJA-ve ku aktualisht ofrohet shërbimi, bashkia do të rrisë standardin e shërbimit duke përmirësuar infrastrukturën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve;
- Në NJA-ve të reja që fillojnë për herë të parë këtë shërbimin, do të mundosohen me infrastrukturë për grumbullimi dhe transportin e mbetjeve.

3. Reduktimi depozitimeve ilegale të mbetjeve urbane dhe sidomos të mbetjeve voluminoze.

Objektiva afatgjatë:

4. Nxitja e iniciativave për minimizimin e mbetjeve përmes stimulimit të grumbullimit të ndarë dhe kompostimit. Minimizimi i mbetjeve urbane që shkojnë në landfill me 30% gjatë periudhës 2017 – 2022.

- Promovimi i ndarjes në dy rryma të mbetjeve urbane (të thata dhe të njoma) në lagjet kryesore të qytetit të Shkodrës;
- Shtrirja e e skemës në dy rryma në lagje të tjera të qytetit, deri në mbulimin e plotë e tij;
- Promovimi i skemave të kompostimit të mbetjeve në NJA Rrethinat dhe në NJA Dajç;
- Shtrirja e skemave të kompostimit edhe në njëstë e tjera administrative me karakter rural.

5. Rritja e nivelit të të ardhurave nga tarifat nga njësitë, të cilat marrin shërbim me 40% gjatë periudhës 2017 – 2022

- Informimi i qytetarëve në lidhje me shërbimet e pastrimit që do të mbulojnë nga tarifa;
- Aplikimi i fushatave ndërgjegjësuese në lidhje me pagesën e tarifës së pastrimit dhe rritjet progresive në sajë të përmirësimit dhe shtimit të shërbimeve për mbetjet: dëgjesa publike në të gjithë territorin e bashkisë me grupe të ndryshme interesi.

6. Forcimi i kuadrit financiar të manaxhimit të mbetjeve, duke konsoliduar mekanizimin e hartimit të buxhetit për shërbimet e mbetjeve dhe hartimin e marrëveshjeve dhe kontratave bazuar në standardet e paracaktuara në rregulloret përkatëse të shërbimit.

7. Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të territorit si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve.

5.3.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit

Sipas legjisllacionit në fuqi¹³, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake (urbane) për të cilën Bashkia Shkodër është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse:

Sipas përbërjes dhe mënyrës së manaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- Mbetje urbane (mbetje shtëpiake, ushqime, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj.), dhe
- Mbetje të veçanta urbane (mbetje ndërtimet dhe prishjet, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- Mbetje të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Sipas burimit të gjenerimit mbetjet urbane (bashkiake) klasifikohen në dy rryma:

¹³ Ligji nr.10463, datë 22.09.2011, amenduar me ligjin nr.156, datë 10.10.2013

- Mbetjet e gjeneruara nga familjet (MF)
- Mbetjet e gjeneruara nga bizneset dhe industritë (MB), ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane

Ndërkohë, rryma të tjera të mbetjeve klasifikohen si mbetje masive, mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen 'mbetje të veçanta' për të cilat njësia vendore duhet t'i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

5.3.2 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit

Në funksion të organizimit më të mirë të shërbimeve dhe efikasitetit të sistemit që do të propozohet, zonat e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrative të bashkisë do ndahet në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë urbane, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Kjo është e rëndësishme që sistemet dhe metodat që do të identifikohen dhe analizohen në vijim të këtij plani të përshaten më mirë me qëllim e rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme apo organizimin e programeve për minimizimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

1. **Nën-zona e parë:** Në këtë nën-zonë do të kategorizojmë zonat me dendësi të lartë popullore si dhe zonat me tipare të ngjashme me zonat urbane. Referuar metodologjisë së dldp-së, për këtë zonë do të konsiderojmë kryerjen e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve çdo ditë (7 ditë/javë). PGM do të jenë të shpërndara në mënyrë uniforme kryesisht çdo 50-100m nga njëri-tjetri. Konkretisht në nën-zonën e parë të mbetjeve do të jetë NJA Shkodër dhe zona e Plazhit në NJA Velipojë (kryesisht gjatë stinës së verës ku ka një popullsi mjaft të dendur).
2. **Nën-zona e dytë:** kjo nën-zonë do të kategorizohen nga pjesë të territorit me tipare rurale fushore me numër jo të lartë banorësh, ku shërbimi parashikohet të kryhet mesatarisht 2-3 herë në javë dhe distanca midis PGM do të jetë 150-200m larg njëri-tjetrit. Në këtë nën zonë parashikohen të jenë këto NJA: Rrethinat, Postrinë, Ana Malit, Guri i Zi, Dajç, dhe Bërdicë.
3. **Nën-zona e tretë:** do të kategorizohen zonat malore apo ato të thella dhe me dendësi të ulët popullore. Në këto zona shërbimi do të jetë i rrallë (1 herë në javë ose 2-3 herë në muaj në varësi të sasisë dhe distancave) dhe distanca e PGM do të jetë mbi 300 m, pasi do të jenë pika grumbullimi në distancë të madhe nga njëra tjetra (një për çdo fshat). Në këtë nën zonë do të jenë këto NJA: Shalë, Pult dhe Shosh.

5.3 Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve

Në këtë plan 5 vjeçar, Bashkia Shkodër parashikon tre shërbime kryesore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat konsistojnë në:

- i) Shërbimi i pastrimit të rrugëve;
- ii) Shërbimi i grumbullimit, transportit i mbetjeve;
- iii) Depozitimi i mbetjeve në landfillin e Bushatit;
- iv) Shërbimi i minimizimit të mbetjeve.

Të katër këto shërbime pasi do të shpjegohen shkurtimisht më poshtë, do të përfshihen në dy skenarët e propozuar nga bashkia për organizimin e shërbimit në territorin e saj gjatë viteve 2017-2022.

5.3.1 Shërbimet e pastrimit të rrugëve

Organizimi i shërbimeve të pastrimit duhet të marrë në konsideratë nevojat për pastrimin e rrugëve dhe shkallën e ndotjes ditore nga mbetjet dhe hedhurinat, apo brenda një periudhe të caktuar ditësh. Për këtë qëllim propozimi i frekuencave për secilën kategori rrugësh duhet të jetë objekt i një vlerësimi apo testi deri në përcaktimin përfundimtar në specifikime teknike të mundshme në rast se ky shërbim do të kontraktohet në të ardhmen.

Një element shumë i rëndësishëm në organizimin e shërbimeve të pastrimit të rrugëve është edhe kategorizimi i rrugëve në funksion të rëndësisë si më poshtë:

1. **Kategoria e Parë:** (përfshin rrugët kryesore dhe rrugët tregtare) nevojitet shërbimi ditor i fshirjes; është më i parapëlqyer pastrimi me makinë teknologjike i akseve kryesore (kur është e mundshme dhe ka efektivitet), por dhe mirëmbajtja e tyre gjatë ditës, vendosja dhe pastrimi ditor i koshave rrugore, si dhe shërbim i larjes gjatë verës, i cili mund të kombinohet me makinën teknologjike që kryen edhe fshirjen edhe larjen;
2. **Kategoria e dytë:** (rrugët kryesore me aktivitet të ulët komercial dhe me densitet të ulët kalimtar) fshirja manuale e rrugëve është e nevojshme të kryhet çdo ditë të javës.
3. **Kategoria e tretë:** (sistem rrugor periferik në zona me dendësi të ulët urbane, apo në zona me infrastrukturë jo të rregullt dhe rrugë të paasfaltuara) është i nevojshëm një shërbim mujor pastrimi (fshirje ose thjesht mbledhje mbetjesh dhe hedhurinash).

Bashkia Shkodër, aktualisht ofron shërbimin e fshirjes së rrugëve kryesore në qytetin e Shkodrës, ku gjatë turnit të natës punëtorët fshijnë rrugët dhe gjatë paradites bëhet mirëmbajtja e pikave të grumbullimit të mbetjeve apo fshirja e ndonjë hedhurine në rrugë. Mesatarisht janë të anagzhuar 10 punëtorë, të cilët kanë një normë ditore pastrimi prej 8,000 metra linear/ditë/punëtorë, ku në total në të gjithë qytetin e Shkodrës fshihen 157,465m² rrugë kryesore dhe dytësore. Ky shërbim ofrohet çdo ditë me dy turne, dhe bashkia kërkon ta mbajë këtë standard edhe gjatë 5 viteve të ardhshme.

Bashkia synon të rrisë cilësinë e këtij shërbimi, duke filluar shërbimin e fshirjes dhe larjes mekanike në rrugët kryesore të qytetit me një mjet specifik për fshirjen mekanike, i cili do të ketë të angazhuar vetëm 1 shofer. Ky shërbim do të ofrohet dy herë në javë dhe gjatë një turni ditor mjeti do të fshijë 343,077m²/ditë.

Në hartën më poshtë tregohet skematikisht ndarja e rrugëve që do të marrin shërbimin e fshirjes manuale dhe mekanike në qytetin e Shkodrës:




Figura 32 Harta e rrugëve të fshirjes manuale dhe mekanike në qytetin e Shkodrës

[Burimi: Bashkia Shkodër]

5.3.2 Grumbullimi, transporti i mbetjeve

Në parashikimin e shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve Bashkia duhet të marrë në konsideratë parimin për parandalimin e ndotjes. Cilësia dhe kostot e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane lidhen drejtpërdrejtë me mënyrën se si konsumatorët hedhin mbetjet, përdorin PGM, respektojnë oraret e përcaktuara dhe zbatojnë rregullat lokale për manaxhimin e mbetjeve. Në këtë aspekt, bashkia duhet të plotësojë kuadrin e saj rregullaror në sajë të:

- Hartimit të një rregulloreje vendore për manaxhimin e mbetjeve, ku do të përcaktohen procedurat, protokollat e punës, parashikimet se çfarë do të ndodh në rast avarish apo aksidentesh në punë, të drejtat dhe detyrimet e të gjitha grupeve të interesit të përfshira në menaxhimin e mbetjeve si dhe gjohat përkatëse në rast të shkeljeve të evidentuara. Si parakusht, bashkia duhet të caktojë një grup pune për monitorimin dhe për të vënë në zbatim këto rregulla;
- Parandalimin e hedhjes së paligjshme dhe derdhjen e mbetjeve jashtë kontenierëve gjë që duhet të sjellë në vëmendje rëndësinë kryesore që kanë fushatat e ndërgjegjësimit dhe programet e edukimit;
- Marrëveshje me konsumatorët e mëdhenj, për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë, ku rekomandohet vendosja e orareve në ditë dhe orë të caktuara për dorëzimin e mbetjeve nga konsumatori në pikat e caktuara nga bashkia, ose grumbullimi i tyre nga bashkia, në sajë të një kontrate të veçantë, në pikat e gjenerimit të tyre.

Ndërkohë elemente të tjerë që kanë të bëjnë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, që bashkia duhet të marrë në konsideratë gjatë planifikimit të shërbimit në territorin e saj, janë si më poshtë:

- Orare pune efektive dhe të përshtatshme:** Për të operuar sipas nevojave të pastërtisë dhe në mënyrë të efektshme dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të hartojë një program efektiv dhe të përshtatshëm pune. Ky program duhet të marrë parasysh ndryshimet ditore, javore dhe mujore në lidhje me numrin e banorëve dhe veprimtarive tregtare.
- Numri i duhur i kontenierëve:** Për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të sigurojë numrin e duhur të kontenierëve apo koshave dhe rregullsinë e mbledhjes së mbetjeve.
- Itenerar efektiv për mbledhjen e mbetjeve:** Përcaktimi i saktë i itenerarit për makinat e mbetjeve do të ulë koston duke pakësuar forcat që shpenzohen për mbledhjen e mbetjeve. Rekomandohet verifikimi i përputhshmërisë me parimet e efektshmërisë së itenerarit të grumbullimit të mbetjeve si dhe të kohës efektive me metodën (MTM – Metodës të Matjes së Kohës).
- Rritja e rendimentit në punë:** Bashkia apo kompanitë private duhet të gjejnë mekanizma për të përmirësuar punën duke rritur rendimentin. Masat që mund të ndërmerren për të rritur moralin, përfshijnë përmirësimin e kushteve të përgjithshme të punës, pajisja me uniformë, stimujt për punë të mirë, trajnimi dhe forcimi i punës në grup.
- Mirëmbajtja e përshtatshme e kontenierëve dhe makinave të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve:** Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinave dhe pajisjeve janë çështje të rëndësishme për shërbimin e mbledhjes së mbetjeve. Pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nga bashkia apo kontraktohet një kompani private, bashkia duhet të përcaktojë ose parashikojë në kontratë mirëmbajtjen e duhur dhe standardet e riparimit që duhet të vihen në zbatim.

Referuar gjëndjes aktuale të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve si dhe eksperiencës, arritjeve dhe problematikës të identifikuar në kapitujt e mëparshëm të këtij plani, nënvizojmë se shërbimi i ofruar në qytetin e Shkodrës është më mirë se në zonat rurale. Megjithatë Bashkia Shkodër është e motivuar dhe e angazhuar të përmirësojë këtë situatë duke synuar si përmirësimin e nivelit aktual të ofrimi të shërbimit në lidhje me cilësinë, efikasitetin dhe efektshmërinë, por gjithashtu të krijojë një bazë të qëndrueshme mbi të cilën do të mbështeten iniciativat lokale dhe rajonale për minimizimin e mbetjeve. Për bashkinë është shumë e rëndësishme, jo vetëm konsolidimi i shërbimit dhe diversifikimi i tyre në NJA Shkodër apo në qendrat urbane të njësisve të tjera administrative, por edhe në rritjen e cilësisë në zonat rurale të njësisve të tjera administrative.

Duke kaluar në një përjasje teknike, ekzistojnë mënyra të ndryshme për grumbullimin, ruajtjen dhe transportin e mbetjeve në funksion të kategorive të konsumatorëve dhe tipologjisë urbane të zonave të banuara. Sipas legjislacionit aktual dhe tipologjisë së zbatuar më së shumti për mbledhjen e mbetjeve, bashkia është përgjegjëse për të mbledhur vetëm “mbetjet urbane”, sipas përcaktimeve të dokumentave ligjorë dhe të këtij plani. Mbetje të tjera që ndryshojnë në përmbajtje (përbërje) nga mbetjet urbane nuk pranohen nga sistemi i bashkiak për grumbullimin e mbetjeve.

Për disa mbetje të ashtuquajtura “të veçanta” që prodhohen nga banorët mund të organizohen metoda për grumbullimin e tyre në mënyrë të diferencuar nga sistemi publik (bazë) bashkiak. Ekzistojnë kufizime të tjera për përdorimin e sistemit bazë bashkiak të grumbullimit të mbetjeve që lidhet me madhësinë dhe sasinë e mbetjeve veçanërisht nga konsumatorët jo-banorë. Duke iu referuar përcaktimeve ligjore (Neni 12 i Ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996), konsumatorët jo-banorë që prodhojnë mbi $\frac{1}{4}$ e sasisë që mund të hidhet në një kontener mbetjesh (zakonisht $1.1m^3$) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të grumbullimit të mbetjeve. Autoritetet vendore apo personat përgjegjës për grumbullimin e mbetjeve duhet të ofrojnë mundësi dhe metoda të tjera për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve, shoqëruar me një sistem të ndryshëm tarifash.

Në lidhje me përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e skemës së përbashkët për grumbullimin e mbetjeve, duke marrë në konsideratë numrin e popullsisë sipas formulës të llogaritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe qëllimit për mbulimin e të gjithë territorit të bashkisë më shërbim, u realizua analiza për llogaritjen e infrastrukturës së nevojshme: kontenerë dhe makina teknologjike. Si fillim u përcaktua kapaciteti i përshtatshëm i kontenerëve si dhe frekuenca e dëshirueshme e shërbimit. Kontenerët me volum $1.1m^3$, plastik¹⁴ për qytetin e Shkodrës dhe metalik për njësitë e tjera administrative, rekomandohen si më të përshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve në këtë bashki. Gjithashtu rekomandohet që kontenerët plastikë apo metalik të jenë me vaskë (trashësi 1.5-2 mm) dhe me sistem rrotash të qëndrueshëm, me kapakë për të mundësuar qëndrueshmërinë e tyre nga impakti i faktorëve të jashtëm. Ndërkohë bazuar në sasinë e mbetjeve të gjeneruara, frekuencës të ofrimit të shërbimit, dhe eksperiencës të ofrimit të shërbimit në Bashkinë Shkodër, për territorin e saj Bashkia preferon mjete teknologjike 10ton dhe 5ton, dhe vetëm në rastin e zonës së plazhit në Velipojë apo rrugicave të ngushta në qytet dhe në rrugët e ngushta të zonave rurale, përdorimin e mjeteve teknologjike 5ton. Në figurën më poshtë tregohet skematikisht skema e përgjithshme e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në territorin Bashkisë Shkodër:




Figura 33 Skema e përgjithshme e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër [Burimi: Punuar nga autori]

5.3.3 Trajtimi dhe depozitimi përfundimtar i mbetjeve

¹⁴ Bashkia ka kërkuar që qyteti të pajiset me kontenerë plastikë, ndërsa në NJA-ve kontenerët të jenë metalik, pasi janë edhe më të fortë dhe mund t'i rezistojnë dëmtimeve të mundshme në zonët rurale

Sipas ligjit për vetqeverisjen vendore kanë si funksion shërbimet e menaxhimit të mbetjeve (grumbullim, transport dhe trajtim final të tyre). Në këtë llogjikë, rekomandohet që autoritetet vendore të rehabilitojnë vend-depozitimet e pakontrolluara dhe të parashikojnë depozitimimin e mbetjeve në landfillet rajonale të ardhshme apo ato ekzistuese në qarqet përkatëse.

Prej disa viteve NJA Shkodër dhe njësitë e tjera në zonën e nën Shkodrës (Velipojë, Dajç, Bërdicë, Ana Malit dhe Guri i Zi) i depozitojnë mbetjet urbane në landfillin e Bushatit, kundrejt një tarife, e cila muajt e fundit ka kapur vlerën 1,035 lek/ton mbetje (me TVSH). Fusha e vjetër e mbetjeve të qytetit të Shkodrës në zonë e varrezave të dëshmorëve, ka disa vite që nuk përdoret më nga firmat private, të kontraktuara nga bashkia, për depozitimimin e mbetjeve urbane, por kushtet e saja mjedisore nuk janë aspakt të mira. Megjithatë nuk përjashtohet rasti që në shumë zona periferike të qytetit apo edhe të njësisë të tjera administrative ka raste të venddepozitimeve ilegale të mbetjeve urbane, por jo vetëm.

Njësitë e zonës të mbi Shkodrës, Postrinë, Rrethinat, Shalë, Pult dhe Shosh, përpara reformës territoriale i depozitonin mbetjet në vend depozitimet e njësisë, ose në vende të paligjshme. Gjatë vitit të fundit Bashkia Shkodër pati një fushatë pastrimi të të gjitha pikave ilegale në këto njësi, por jo vetëm, e cila vazhdon edhe aktualisht në sajë të nevojave të bashkisë për të pastruar territorin nga hedhjet e paligjshme të mbetjeve urbane. Aktualisht në të gjitha njësitë, në të cilat ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, ku përjashtim bën NJA Pult dhe Shosh, mbetjet transportohen për në landfillin e Bushatit dhe jo më në venddepozitimet ilegale të njësisë.

5.3.4 Minimizimi i mbetjeve

Sipas VKM nr. 48, datë 25.06.2017 “Për grumbullimin e ndarë të mbetjeve në burim”, janë përcaktuara disa objektiva, të cilat duhet të plotësohen nga NJQV-të deri në vitin 2020, ku konkretisht:

- NJQV-të deri në fund të vitit 2018, NJQV-të duhe të grumbullojnë në mënyrë të diferencuar, të paktën mbetje të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit;
- Brenda vitit 2020, ato duhet të arrijnë normën e riciklimit me 50% të sasisë të mbetjeve të vitit 2014;
- Brenda vitit 2020, sasia e mbetjeve që shkojnë në landfill do të jetë 45% e sasisë së të mbetjeve që prodhohet, dhe pjesa tjetër duhet të shkojë për riciklim, kompostim apo për rekuperim me energji.

Pavarësisht mungesës së eksperiencës së autoriteteve lokale dhe operatorëve të mbetjeve si dhe vetë komunitetit për të ndarë mbetjet, Bashkia ka shprehur vullnetin e saj për fillimin e skemave të ndarjes së mbetjeve në burim në dy zona pilot në qytetin e Shkodrës (dy rryma të njoma dhe të thata) dhe në të gjitha shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit (me katër rryma për mbetjet e riciklueshme: letër, qelq, plastikë, metal), si dhe kompostimin e mbetjeve në dy nga NJA, konkretisht në Rrethinat dhe në Dajç përsëri me dy rryma (të njoma dhe të thata).

I gjithë sistemi i ndarjes përbëhet nga dy komponentë: sistemi parësor i ndarjes dhe sistemi dytësor i ndarjes. **Sistemi parësor i ndarjes:** Njihet gjerësisht si ndarja në burim dhe jep rezultatin më të mirë të ndarjes. Ndarja në burim i referohet ndarjes së materialeve të riciklueshme dhe të ripërdorshme në pikën e prodhimit të tyre. **Sistemi dytësor i ndarjes,** nënkupton ndarjen e tyre në PGM publike të grumbullimit të tyre. Bashkia Shkodër do të fillojë me sistemin dytësor të ndarjes në dy lagje kryesore të saj, dhe në dy NJA Rrethinat dhe Dajç, ndërsa me sistemin parësor në shkollat e qytetit. Më poshtë jepet një përshkrim se si funksionojnë këto sisteme:

Sistemi parësor – skemat individuale të ndarjes së mbetjeve: Sistemi i mbledhjes individuale nga familjet dhe bizneset përbën bazën për ngritjen e sistemit të ndarjes së mbetjeve. Duhet thesuar se sistemi i ndarjes në burim duket më i preferueshëm sesa sistemi i ndarjes së mbetjeve në rrugë. Nga këndvështrimi i angazhimit të drejtpërdrejtë të pronarëve apo personave të kontaktit të bizneseve apo familjeve, ky sistem siguron më shumë ndërgjegjshmëri, efektivitet dhe mundësi financimi sesa sistemi i hapur mbi të cilin mbështetet skema e përbashkët.

Ndarja në burim mund të jetë më praktike dhe e efektshme për biznesin dhe industrinë, ku duhet të mundësohet shërbimi individual i grumbullimit të mbetjeve. Koshat për ndarjen e mbetjeve në burim

mund të vendosen në çdo njësi të madhe biznesi apo institucion shtetëror duke ndjekur të njëjtën teknologji si sistemi i mbledhjes individuale. Sistemi duhet të jetë sa më i thjeshtë duke synuar vetëm ato mbetje apo komponentë që mund të riciklohen. Për këtë arsye, sistemi me katër kontenierë të vegjël duket më i favorshëm se të tjerët. Kjo nënkupton caktimin e një kodi me ngjyra për alternativën me katër kontenierë që konsumatorët ta kenë parasysh, kur vendosin të depozitojnë mbetjet aty.

Sistemi dytësor – skemat e përbashkëta për ndarjen e mbetjeve: Përdorimi i sistemit aktual të grumbullimit të mbetjeve urbane shërben si një bazë për të vënë në funksionim dhe prezantuar sistemin e mbledhjes së diferencuar të tyre. Kjo mënyrë mund të jetë praktike vetëm kur qytetarët dhe bizneset janë mësuar me këtë lloj sistemi dhe do të mund të përshtaten më mirë. Kjo metodë është e preferueshme kryesisht në qytete të mëdha ku është i pamundur krijimi i sistemeve individuale për ndarjen e mbetjeve dhe blloqet e banimit janë kolektive.

Sektori informal, i cili është krahu kryesor i punës në sektorin e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme nuk është plotësisht në vëmendje nga strukturat shtetërore. Ky sektor sjell mjaft dobi në sektorin e manaxhimit të mbetjeve, si: i) ul mesatarisht deri 15-30% sasinë e mbetjeve që depozitohen në landfill/fushë depozitimi; ii) Ul koston e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve; iii) Është burim të ardhurash për rreth 2% të popullsisë së zonave të varfra; iv) Sipas shifrave nga literatura e huaj llogaritet që çdo ton mbetje e riciklueshme e grumbulluar është e barabartë me një vend pune.

Ashtu si hierarkia e përgjithshme e menaxhimit të mbetjeve, edhe menaxhimi i mbetjeve të riciklueshme duhet të mbështetet në një hierarki të ngjashme, ku objektivi kryesor është parandalimi sa më shumë i gjenerimit të mbetjeve:

- i. Riprodhimi i mbetjeve të riciklueshme (prioritarizohet më shumë)
- ii. Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme nga tregtarët
- iii. Mbledhësit formalë të mbetjeve të riciklueshme
- iv. Grumbulluesit fillestarë të mbetjeve të riciklueshme
- v. Mbledhësit informalë të mbetjeve të riciklueshme (prioritarizohet më pak)

Kompostimi i mbetjeve: Një argument i rëndësishëm në favor të kompostimit është fakti se pothuajse të 10 NJA të Bashkisë Shkodër, duke përfshirë qytetin e Shkodrës, i cili ka karakter urban, pjesa tjetër ka karakter suburban dhe kryesisht rural, dhe sasia e mbetjeve organike, kryesisht nga kopshtet, bujqësia apo blegtoria në zonë, përbëjnë një sasi të konsiderueshme për zhvillimin e kompostimit familjar (individual) dhe kolektiv. Bashkia mund ta përdorë produktin e kompostit në bujqësinë e zonës, apo për lulishtet e qytetit.

Kompostimi në nivel individual (në shtëpi) paraqet një nga metodat më të parapëlqyera të kompostimit që rekomandohet për t'u përdorur në familjet në zonat suburbane apo rurale. Kjo metodë është më pak e kushtueshme dhe më e efektshme sesa transferimi i mbetjeve organike në pikën e mbledhjes dhe më pas transportimi i tyre në landfill, ku përfshihen edhe depozitimi si dhe të gjitha kostot e tjera që shoqërojnë këto procese. Ky proces është mjaft i rëndësishëm nga ana mjedisore, pasi ul ndjeshëm sasinë e mbetjeve që hedhin familjet për trajtim final, duke ulur në këtë mënyrë edhe koston transportit dhe të trajtimit final të mbetjeve. Në rastin e mbetjeve drusore, të cilat në zonat sub-urbane/rurale janë të shumta, bashkia mund të ofrojë shërbimin e copëtimit (grirjes) për familjet që ndërmarrin një nismë të tillë, duke copëtuar mbetjet drusore, disa herë në vit.



Figura 34 Modeli i kompostimit individual
[Burimi: Foto ilustruese nga kërkimi në internet]

Përveç kompostimit në nivel individual, një ndër metodat më të përshtatshme për kushtet dhe koston relativisht të ulët që ka, mund të jetë **kompostimi në mjedis të hapur (kolektiv)**. Kjo metodë nuk ka një kosto të lartë për investimin fillestar dhe mund të japë rezultate mjaft të favorshme, jo vetëm për uljen e sasisë së mbetjeve që shkojnë për trajtimin final, por edhe në prodhimin e një sasive të konsiderueshme komposti si pleh organik, që mund të përdoret nga bashkia për qëllime publike.



Figura 35 Skemat e kompostimit në mjedis të hapur
[Burimi: Foto ilustruese nga kërkimi në internet]

5.4 Manaxhimi i mbetjeve voluminoze dhe ndërtimore

Sipas kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e mbetjeve (VKM nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”) është përgjegjësia e prodhuesit (familje, biznes apo industri) që të largojë dhe transportojë mbetjet inerte (mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet), ndërtimore apo voluminoze që mund të gjenerojë nga aktiviteti që kryen për në vendet e përcaktuara nga pushteti vendor për këtë qëllim. Ndonëse ekziston ky kuadër ligjor, i cili përcakton mjaft mirë detyrat për secilin aktor të përfshirë në këtë fushatë, asnjë nga bashkitë e vendit nuk ka përcaktuar një vend për depozitimin e mbetjeve inerte.

Në kuadrin ligjor theksohet se këto vende të përcaktuara për depozitimin e mbetjeve inerte/ndërtimore/voluminoze duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të posaçme dhe duhet të pranojnë vetëm këto lloj mbetjesh, dhe jo përzjerje apo përpunime të këtyre mbetjeve me elemente të tjerë, pasi ato mund të jenë të rrezikshme.

Të gjitha venddepozitimet e mbetjeve inerte kanë të njëjtën mënyrë operimi si landfillet për mbetjet urbane, ku gjeneruesi i mbetjeve duhet të paguajë një tarifë kundrejt sasisë së mbetjeve inerte që transportohet, e cila mbulon koston e operimit të fushës, trajtimit të tyre dhe mbylljen përfundimtare të

saj. Ndërkohë ndalohet ndërtimi i venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte nga njësitë e qeverisjes vendore në zonat e mëposhtme:

- Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;
- Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujor;
- Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor;
- Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me pikën e parë.

Landfilllet e mbetjeve inerte mund të jenë landfillle vendore, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të prodhuara brenda territorit të një NJQV-je ose landfillle rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të shumë NJQV-ve. Njësitë e qeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit, ku do të ndërtohet landfillli rajonal dhe të mënyrës së funksionimit të tij. Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbetjeve në landfillle dhe venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte, janë të detyruar të raportojnë pranë NJQV-ve dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e mbetjeve që trajtojnë.

Në mënyrë të veçantë, ka një treg ripërdorimi për agregatet që rrjedhin nga mbetjet e ndërtimeve në rrugë, kanalizime dhe projekte të tjera ndërtimi. Nëse nuk ndahen që në burim apo nuk transportohen veçmas, ato mund të përmbajnë sasi të vogla të mbetjeve të rrezikshme, përzierja e të cilave mund të paraqesë rrezik të veçantë për mjedisin dhe mund të pengojë riciklimin.

Shpesh herë mbetjet inerte përzihen me mbetjet urbane dhe më pas depozitohen në landfilllin e Bushatit, i cili nuk është parashikuar të përdoret vetëm për depozitim të mbetjeve urbane. Nga ana tjetër gjeneruesit e mbetjeve inerte shpesh herë i shkarkojnë ato në vende ilegale, atje ku të mundën. Bashkia duhet të përcaktojë një zonë të caktuar në territorin e saj, ku të gjithë gjeneruesit e mbetjeve inerte të mund të dërgojnë mbetjet e tyre në këtë pikë dhe jo t'i hedhin ato në PGM të mbetjeve urbane apo në depozitime ilegale.

5.5 Skenarët e propozuar për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Hyrja në fuqi e reformës territoriale u shoqërua edhe me një riorganizim të shërbimeve publike, ku njëri prej tyre është edhe ai i menaxhimit të mbetjeve. Aktualisht Bashkia Shkodër ka nënshkruar katër kontrata me kompanitë private (të shpjeguara më lart), për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, për një periudhë 18 mujore deri në Shtator të vitit 2018. Pas përfundimit të këtyre kontratave bashkia do të bëjë një riorganizim të zonave të shërbimit, duke kaluar nga katër kontrata në vetëm 3 kontrata për të gjithë territorin e saj, si hartën më poshtë:




Figura 36 Zonat e reja të shërbimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër
[Burimi: Bashkia Shkodër, autori]

Bazuar në këtë ndarje të zonave të shërbimit, Bashkia në fund të vitit 2018 do të hapë tenderin ndërkombëtarë për kontraktimin e shërbimit të pastrimit (menaxhim i mbetjeve dhe fshirje manuale dhe mekanike e rrugëve kryesore). Për ofrimin e një shërbimi me standarde sa më të larta, me kosto optimale dhe të përballueshëm nga taksa paguesit, për të synuar mbulimin e plotë të koston së shërbimit, bashkia propozon dy skenarë të mundshëm për ofrimin e shërbimit të pastrimit. Skenarët janë në vazhdimësi të skenarit ekzistues, ku qëllimi i bashkisë është të rrisë cilësinë e shërbimit në sajë të përmirësimit të infrastrukturës dhe diversifikimin e shërbimeve që ajo ofron. Për secilin nga skenarët është bërë llogaritja e koston sipas modelit të dldp-së për llogaritjen e koston dhe është llogaritur rritja e tarifës aktuale për të dy skenarët e propozuar për secilin nga kategoritë e konsumatorëve.

Skenari I

Ky Skenar do të fillojë të zbatohet pas shatorit të vitit 2018, kur bashkia do të këtë firmosur marrëveshjet me tre kompanitë fituese për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e saj për tre zonat e ndara si më lart.

A. Shërbimet që do të përfshihen në këtë Skenar

Në zonën lindore dhe perëndimore do të ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve nga pikat e grumbullimit (të pajisur me kontenierë) për në landfillin e Bushatit.

Në zonën qendrore (qyteti i Shkodrës) përveç shërbimit të grumbullimit të mbetjeve dhe transportit të tyre për në landfillin e Bushatit, dhe fshirjes manuale në qytet, bashkia do të parashikojë edhe dy shërbime të tjera shtesë: i) Fshirja dhe larja mekanike në rrugët kryesore të qytetit, sipas hartës të përmendur më lart (**faqe 42**), dhe; ii) Fshirja me mjet 5ton në rrugicat e ngushta të qytetit, siç tregohet në hartën më poshtë:




Figura 37 Zonat me rrugica të ngushta në qytetin e Shkodrës për mjetin 5ton
[Burimi: Bashkia Shkodër]

B. Të dhënat teknike në lidhje me ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Riorganizimi i shërbimit, tashmë në 3 zona solli edhe ndryshime në lidhje me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit, investimet për kontenierë apo mjete dhe frekuencat e ofrimit të shërbimit. Në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje në lidhje me infrastrukturën e nevojshme dhe të dhënat teknike për të tre nga zonat e këtij skenari:

Përbërja	Infrastruktura		Të dhënat teknike	
	Mjetet	Kontenierë	Norma e gjenerimit	Frekuenca
Njësitë e Zonës Lindore				
Rrethinat, Postribë, Shalë, Pult, Shosh, Guri i Zi	3 mjet 10 ton/ 1 turne (mjete i trete mund të merret 5ton për rrugët e ngushta)	Shtohen 232 - (Total 497)	0.3 kg/banorë/ditë	2.5 herë/javë
Njësitë e Zonës Perëndimore				
Ana Malit, Bërdicë, Velipojë, Dajç	3 mjet 10 ton/ 1 turne (mjete i trete mund të merret 5ton për rrugët e ngushta)	Shtohen 100 (Total 243)	0.3 kg/banorë/ditë	2.5 herë/javë
Veipojë Plazh	2 mjete 5ton/2 turne	Shtohen 63 (Total 223)	0.75 kg/banorë/ditë	7ditë/javë/2 herë/ ditë
Njësitë e zonës së qendrës				
Shkodër	4 +1 mjete 10ton (mjete reserve mund të jetë 5ton për turnin e dytë në disa rrugë)	Shtohen 150 (Total 759)	0.9 kg/banorë/ditë	7ditë/javë
Fshirja manuale				
Fshirja dhe larja mekanike	1 mjet fshirje larje mekanike			2 herë/javë
Mjeti 5ton për rrugicat e ngushta (Shkodër)	1 mjet 5 ton	Shtohen 10 (Total 24)		7ditë/ditë

Tabela 19 Të dhënat teknike për Skenarin I të menaxhimit të mbetjeve

[Burimi: Punuar nga autori]

Zona Lindore: Për 6 NJA të zonës lindore, me një normë gjenerimi prej *0.3kg/banorë/ditë*, parashikohen të përdoren *2 mjete teknologjike 10ton dhe 1 mjet teknologjik 5ton*, të cilët do të ofrojnë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve *2.5 herë në javë/1 turn* në ditë për të gjithë zonën (*1 mjet teknologjik 10ton ofron shërbimin vetëm në NJA Rrethinat – Landfilli i Bushatit; 1 mjet teknologjik 10 ton ofron shërbimin në NJA Postribë – NJA Guri i Zi - Landfilli i Bushatit; mjete teknologjik 5ton ofron shërbimin në NJA Pult – NJA Shalë – NJA Shosh – Landfilli i Bushatit dhe në rrugicat e ngushta ku nuk mund të hyjë mjete 10ton*). Në tabelën më poshtë propozohet një kalendar i mundshëm në lidhje me ditët e ofrimit të shërbimit në secilën nga njësitë vendore:

Frekuenca	2 Mjete 10 ton + 1 mjet 5 ton						1 turn/ditë
	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	
Zona lindore	Rrethinat	pushim	pushim	Rrethinat	Shosh	pushim	pushim
	Postribë			Postribë	Pult		
	Guri i Zi			Guri i Zi	Shalë		

Tabela 20 Kalendar i lëvizje të mjeteve teknologjike në Zonën Lindore – Skenari 1

[Burimi: Punuar nga autori]

Bashkia parashikon që të investojë në kontenierë të rinj në këtë zonë për kontratën e re, ku konkretisht do të shtohen 232 kontenierë të rinj metalik, dhe në total kjo zonë do të këtë 497 kontenierë.

Zona Perëndimore: Për 4 NJA të zonës perëndimore, me një normë gjenerimi prej *0.3kg/banorë/ditë dhe 0.75kg/banorë/ditë për zonën e plazhit në Velipojë*, parashikohen të përdoren *2 mjete teknologjike 10ton, 1 mjet teknologjik 5ton për rrugët e ngushta rurale dhe 2 mjete teknologjike 5ton*

Në parashikimin e bërë për 5 vjeçarën e zbatimit të planit, është parashikuar një rritje 5-10% çdo vit për secilën njësi të nivelit të grumbullimit të tarifës nga familjet (vlera e saj nuk ka ndryshuar me propozim të bashkisë), duke marrë parasysh edhe nivelin e informimit të qytetarëve. NJA Rrethinat dhe NJA Postrinë, dhe NJA Guri i Zi në fund të 5 vjeçarit të planit do të mund të mbulojnë pjesën e kostos të shërbimit për familjet 100% (koston e kontratës që Bashkia do të nënshkruaj pas vitit 2018 për zonën lindore) nga të ardhurat që do të grumbullojnë vetëm nga familjet, edhe pse niveli i grumbullimit të tyre nuk do të jetë në nivelin 100%. Njësitë e tjera nuk do të mund të mbulojnë 100% pjesën e kostos së shërbimit për familjet nga të ardhurat e tarifës së pastrimit nga familjet, por të

paktën do të arrijnë të mbulojnë mbi 50% të saj, krahasuar me performancën shumë të dobët gjatë vitit 2017.

Skenari I – Zona Perëndimore – mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet

Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Velipojë)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	1,270	1,308	1,347	1,388	1,429	1,472
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	1,905,000	2,550,795	2,627,319	2,706,138	2,787,323	2,870,942
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	10%	30%	55%	65%	75%	85%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	190,500	765,239	1,445,025	1,758,990	2,090,492	2,440,301
1.6	Pjese e koston operative për familjet	3,529,498	3,529,498	3,529,498	3,529,498	3,529,498	3,529,498
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	5%	22%	41%	50%	59%	69%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Dajç)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	1,152	1,187	1,222	1,259	1,297	1,335
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	1,728,000	2,313,792	2,383,206	2,454,702	2,528,343	2,604,193
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	44%	54%	64%	74%	84%	94%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	760,320	1,249,448	1,525,252	1,816,479	2,123,808	2,447,942
1.6	Pjese e koston operative për familjet	3,201,561	3,201,561	3,201,561	3,201,561	3,201,561	3,201,561
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	24%	39%	48%	57%	66%	76%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Ana Malit)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	1,017	1,048	1,079	1,111	1,145	1,179
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	1,525,500	2,042,645	2,103,924	2,167,042	2,232,053	2,299,014
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	26%	40%	50%	60%	70%	80%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	396,630	817,058	1,051,962	1,300,225	1,562,437	1,839,212
1.6	Pjese e koston operative për familjet	2,826,378	2,826,378	2,826,378	2,826,378	2,826,378	2,826,378
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	14%	29%	37%	46%	55%	65%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Bërdicë)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	1,425	1,468	1,512	1,557	1,604	1,652
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	2,137,500	2,862,113	2,947,976	3,036,415	3,127,508	3,221,333
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	12%	25%	40%	50%	60%	70%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	256,500	715,528	1,179,190	1,518,208	1,876,505	2,254,933
1.6	Pjese e koston operative për familjet	3,960,264	3,960,264	3,960,264	3,960,264	3,960,264	3,960,264
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	6%	18%	30%	38%	47%	57%

Tabela 36 Mbulimi i koston nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin I – Zona Perëndimore
[Burimi: Punuar nga Autori]

Në grafikët më poshtë tregohet përqindja e nivelit të të ardhurave që grumbullohen kundrejt përqindjes të mbulimit të koston gjatë 5 viteve të zbatimit të planit, për secilën NJA të Zonës Perëndimore:




Figura 62 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Velipojë
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 63 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Dajç
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 64 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Ana Malit
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 65 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Ana Malit
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Siç mund ta shohim si nga tabela ashtu edhe nga grafikët, niveli i grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet, për njësitë e Zonës Perëndimore, ka qënë i ulët gjatë vitit 2017, ku vetëm NJA Dajç ka patur performancën më të mirë të grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet me 44%. Për sa i takon mbulimit të kostos së shërbimit nga të ardhurat e grumbulluara nga familjet gjatë vitit 2017, mbetet në nivele shumë të ulta, pothuajse të papërfillshme, ku përsëri NJA Dajç mbulon 24% të kostos së shërbimit vetëm nga familjet.

Në parashikimin e bërë për 5 vjeçarën e zbatimit të planit, është parashikuar një rritje 10-15% çdo vit për secilën njësi të nivelit të grumbullimit të tarifës nga familjet (*vlera e saj nuk ka ndryshuar me propozim të bashkisë*), duke marrë parasysh edhe nivelin e informimit të qytetarëve. Politika e bashkisë për të mos ndryshuar tarifën e pastrimit për kategorinë e konsumatorëve familjarë, në rastin e

Zonës Perëndimore, rezulton të sjellë jo përmirësime të ndjeshme¹⁹, për sa i takon nivelit të mbulimit të pjesës së kostos për familjet nga tarifat e familjeve, ndonëse parashikohet një rritje pothuajse 100% e nivelit të grumbullimit të tarifave.

Skenari I – Zona Qëndrore – mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet

Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Shkodër)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	21,253	21,891	22,547	23,224	23,920	24,638
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	3,000	3,450	3,450	3,450	3,450	3,450
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	63,759,000	75,522,536	77,788,212	80,121,858	82,525,514	85,001,279
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	65%	75%	80%	85%	95%	100%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	41,443,350	56,641,902	62,230,569	68,103,579	78,399,238	85,001,279
1.6	Pjese e kosto operative për familjet	84,276,498	84,276,498	84,276,498	84,276,498	84,276,498	84,276,498
1.7	Përqindja e mbulimit të kosto	49%	67%	74%	81%	93%	101%

Tabela 37 Mbulimi i kosto nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin I – Zona Qëndrore [Burimi: Punuar nga Autori]




Figura 66 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kosto – NJA Shkodër [Burimi: zhvilluar nga autori]

Siç mund ta shohim si nga tabela ashtu edhe nga grafikët, niveli i grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet, për njësitë e NJA Shkodër, ka qënë relativisht më i lartë se njësitë e tjera (65%) gjatë vitit 2017 nga familjet, të cilat kanë mbuluar 49% të kosto së shërbimit.

Në parashikimin e bërë për 5 vjeçarën e zbatimit të planit, është parashikuar një rritje 10% çdo vit për secilën njësi të nivelit të grumbullimit të tarifës nga familjet (vlera e saj nuk ka ndryshuar me propozim të bashkisë), duke marrë parasysh edhe nivelin e informimit të qytetarëve. Nëse niveli i grumbullimit të tarifës nga familjet do të jetë në nivelet e parashikuara, NJA Shkodër në fund të 5 vjeçarit do të mund të mbulojë të gjithë pjesën e kosto së shërbimit për familjet nga tarifa e pastrimit nga familjet.

¹⁹ Në rastin e NJA Velipojë për zonën e plazhit, NJA mbledh nga konsumatori familjar sezonal një tarifë pastrimi nga 3,000-5,000 lek

Skenari I – Bashkia – mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga BM & BV

Tarifa e biznesit të madh nga kosto operative e shërbimit		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i bizneseve të mëdha	1,210	1,246	1,284	1,322	1,362	1,403
a.	Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA Shkodër	750	773	796	820	844	869
b.	Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA të tjera	219	226	232	239	246	254
c.	Njësi tregtare për tregtim karburanti	43	44	46	47	48	50
d.	Njësi prodhimi në NJA Shkodër	80	82	85	87	90	93
e.	Njësi prodhimi në NJA e tjera	9	9	10	10	10	10
f.	Subjekte ndërtuese për Selinë administrative	39	40	41	43	44	45
g.	Ente shtetërore, OjF	70	72	74	76	79	81
1.2	Tarifa vjetore e bizneseve të mëdha						
a.	Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA Shkodër	30,000	33,000	33,000	33,000	33,000	33,000
b.	Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA të tjera	30,000	33,000	33,000	33,000	33,000	33,000
c.	Njësi tregtare për tregtim karburanti	45,000	48,000	48,000	48,000	48,000	48,000
d.	Njësi prodhimi në NJA Shkodër	60,000	63,000	63,000	63,000	63,000	63,000
e.	Njësi prodhimi në NJA e tjera	30,000	33,000	33,000	33,000	33,000	33,000
f.	Subjekte ndërtuese për Selinë administrative	70,000	73,000	73,000	73,000	73,000	73,000
g.	Ente shtetërore, OjF	5,000	8,000	8,000	8,000	8,000	8,000
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	39,155,000	44,068,550	45,390,607	46,752,325	48,154,894	49,599,541
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	100%	100%	100%	100%	100%	100%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	39,155,000	44,068,550	45,390,607	46,752,325	48,154,894	49,599,541
1.6	Pjese e kostos operative për bizneset e mëdha	48,960,892	48,960,892	48,960,892	48,960,892	48,960,892	48,960,892
1.7	Përqindja e grumbullimit të të ardhurave	80%	90%	93%	95%	98%	101%
Tarifa e biznesit të vogël nga kosto operative e shërbimit		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i bizneseve të vogla	4,299	4,428	4,561	4,698	4,839	4,984
a.	Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA Shkodër	3,000	3,090	3,183	3,278	3,377	3,478
b.	Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA të tjera	953	982	1,011	1,041	1,073	1,105
c.	Njësi prodhimi në NJA Shkodër	170	175	180	186	191	197
d.	Njësi prodhimi në NJA e tjera	56	58	59	61	63	65
e.	Ambulant	120	124	127	131	135	139
1.2	Tarifa vjetore e biznesit të vogël						
a.	Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA Shkodër	10,000	13,000	13,000	13,000	13,000	13,000
b.	Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA të tjera	5,000	8,000	8,000	8,000	8,000	8,000
c.	Njësi prodhimi në NJA Shkodër	10,000	13,000	13,000	13,000	13,000	13,000
d.	Njësi prodhimi në NJA e tjera	5,000	8,000	8,000	8,000	8,000	8,000

e.	Ambulant	2,500	5,500	5,500	5,500	5,500	5,500
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	36,747,620	50,766,084	52,288,901	53,857,403	55,472,960	57,136,984
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	97%	98%	99%	100%	100%	100%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	35,645,191	49,750,762	51,766,012	53,857,403	55,472,960	57,136,984
1.6	Pjese e koston operative për biznesin e vogël	39,168,714	39,168,714	39,168,714	39,168,714	39,168,714	39,168,714
1.7	Përqindja e grumbullimit të të ardhurave	91%	127%	132%	138%	142%	146%

Tabela 38 Mbulimi i koston nga tarifa e pastrimit nga BM & BV për Skenarin I
[Burimi: Punuar nga Autori]

Në ndryshim nga situata me tarifën nga konsumatorët familjarë, në rastin e bizneseve, si të mëdha dhe të vogla, bashkia ka aftësinë të grumbullojë 100% të tarifës, e cila siç tregohet edhe në parashikim 5 vjeçarë do të mbulojë pothuajse 100% pjesën e koston operative të shërbimit që i takon bizneseve.

Në Aneksin II paraqitet një tabelë përmbledhëse për të gjithë gjithë bashkinë në lidhje me parashikimin e rritjes të nivelit të grumbullimit të tarifës vit pas vitit për skenarin I.

5.6.3 Planifikimi i të ardhurava nga tarifa e pastrimit për skenarin II të menaxhimit të mbetjeve

Edhe në rastin nëse bashkia vendos të zbatojë skenarin e dytë parashikon që për kontratat e ardhshme tarifa e pastrimit mos të pësojë rritje të ndjeshme, por të mbetet në këto nivele.

Në tabelat më poshtë, për secilën nga tre zonat e shërbimit, kemi parashikuar se sa përqind e koston operative do të mbulohet nga familjet, në sajë të një rritje prej 3% çdo vit të numrit të familjeve, ku tarifa e pastrimit mbetet në ato nivele të përcaktuara së fundmi nga bashkia në dëgjuesat publike. Si fillim janë marrë si referencë nivelet e grumbullimit të të ardhurave të raportuara nga bashkia për vitin 2017, ku vit pas viti është propozuar një rritje me 10% e nivelit të grumbullimit të të ardhurave.

Në rastin e bizneseve ato janë marrë të përmbeldhura në dy tabela (biznesi i madh dhe biznesi i vogël) në ndryshim nga familjet, ku ato janë marrë më vetë për secilën njësi vendore.

Për sa i takon përqindjes të koston që zënë tre kategoritë e konsumatorëve, bashkia ka përcaktuar:

- iv) Familjet zënë **55%** të koston operative
- v) Bizneset e mëdha dhe institucionet zënë **25%** të koston operative
- vi) Bizneset e vogla zënë **20%** të koston operative

Skenari II – Zona Lindore – mbulimi i koston nga tarifa e pastrimit nga familjet

Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Rrethinat)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	4,901	5,048	5,199	5,355	5,516	5,682
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	7,351,500	9,843,659	10,138,968	10,443,137	10,756,431	11,079,124
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	7%	20%	35%	45%	55%	59%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	514,605	1,968,732	3,548,639	4,699,412	5,916,037	6,536,683
1.6	Pjese e koston operative për familjet	5,613,483	5,613,483	5,613,483	5,613,483	5,613,483	5,613,483
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	9%	35%	63%	84%	105%	116%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Postribë)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	1,609	1,657	1,707	1,758	1,811	1,865

1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	2,413,500	3,231,677	3,328,627	3,428,486	3,531,340	3,637,280
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	25%	35%	45%	50%	55%	59%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	603,375	1,131,087	1,497,882	1,714,243	1,942,237	2,145,995
1.6	Pjese e koston operative për familjet	1,842,908.5	1,842,908.5	1,842,908.5	1,842,908.5	1,842,908.5	1,842,908.5
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	33%	61%	81%	93%	105%	116%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Shalë)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	477	491	506	521	537	553
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,000	1,450	1,450	1,450	1,450	1,450
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	477,000	712,400	733,771	755,785	778,458	801,812
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	0%	10%	20%	30%	40%	50%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	-	71,240	146,754	226,735	311,383	400,906
1.6	Pjese e koston operative për familjet	546,343.9	546,343.9	546,343.9	546,343.9	546,343.9	546,343.9
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	0%	13%	27%	42%	57%	73%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Shosh)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	334	344	354	365	376	387
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,000	1,450	1,450	1,450	1,450	1,450
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	334,000	498,829	513,794	529,208	545,084	561,436
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	3%	15%	25%	35%	45%	55%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	10,020	74,824	128,448	185,223	245,288	308,790
1.6	Pjese e koston operative për familjet	382,555	382,555	382,555	382,555	382,555	382,555
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	3%	20%	34%	48%	64%	81%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Pult)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	80	82	85	87	90	93
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,000	1,450	1,450	1,450	1,450	1,450
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	80,000	119,480	123,064	126,756	130,559	134,476
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	0%	10%	20%	30%	40%	50%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	-	11,948	24,613	38,027	52,224	67,238
1.6	Pjese e koston operative për familjet	91,630	91,630	91,630	91,630	91,630	91,630
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	0%	13%	27%	42%	57%	73%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Guri i Zi)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	1,907	1,964	2,023	2,084	2,146	2,211
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	2,860,500	3,830,210	3,945,116	4,063,469	4,185,373	4,310,935
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	2%	20%	30%	40%	50%	55%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	57,210	766,042	1,183,535	1,625,388	2,092,687	2,371,014
1.6	Pjese e koston operative për familjet	2,184,230	2,184,230	2,184,230	2,184,230	2,184,230	2,184,230
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	3%	35%	54%	74%	96%	109%

Tabela 39 Mbulimi i koston nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin II – Zona Lindore
[Burimi: Punuar nga Autori]

Në grafikët më poshtë tregohet përqindja e nivelit të të ardhurave që grumbullohen kundrejt përqindjes të mbulimit të koston gjatë 5 viteve të zbatimit të planit, për secilën NJA të Zonës Lindore:




Figura 67 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Rrethinat [Burimi: zhvilluar nga autori]



Figura 68 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Postrribë [Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 69 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Shalë [Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 70 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Shosh
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 71 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Pult
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 72 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Guri i Zi
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Siç mund ta shohim si nga tabela ashtu edhe nga grafikët, niveli i grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet, për njësitë e Zonës Lindore, ka qënë shumë i ulët gjatë vitit 2017, ku vetëm NJA Postribë ka patur performancën më të mirë të grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet me 25%. Për sa i takon mbulimit të kostos së shërbimit nga të ardhurat e grumbulluara nga familjet gjatë vitit 2017, mbetet në nivele shumë të ulta, pothuajse të papërfillshme, ku përsëri NJA Postribë mbulon 33% të kostos së shërbimit vetëm nga familjet.

Në parashikimin e bërë për 5 vjeçarën e zbatimit të planit, është parashikuar një rritje 10-15% çdo vit për secilën njësi të nivelit të grumbullimit të tarifës nga familjet (vlera e saj nuk ka ndryshuar me propozim të bashkisë), duke marrë parasysh edhe nivelin e informimit të qytetarëve. NJA Rrethinat, NJA Postribë, NJA Guri i Zi në fund të 5 vjeçarit të planit do të mund të mbulojnë pjesën e kostos së shërbimit për familjet në 100%, edhe pse niveli i grumbullimit të tyre nuk do të jetë në nivelin 100%. Njësitë e tjera nuk do të mund të mbulojnë 100% pjesën e kostos të shërbimit për familjet nga të ardhurat e tarifës së pastrimit nga familjet, por të paktën do të arrijnë të mbulojnë mbi 60% të kësaj pjese të kostos nga tarifat e grumbulluar nga familjet.

Skenari II – Zona Perëndimore – mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet

Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Velipojë)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	1,270	1,308	1,347	1,388	1,429	1,472
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	1,905,000	2,550,795	2,627,319	2,706,138	2,787,323	2,870,942
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	10%	30%	45%	55%	65%	75%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	190,500	765,239	1,182,293	1,488,376	1,811,760	2,153,207
1.6	Pjese e kostos operative për familjet	3,723,076	3,723,076	3,723,076	3,723,076	3,723,076	3,723,076
1.7	Përqindja e mbulimit të kostos	5%	21%	32%	40%	49%	58%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Dajç)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	1,152	1,187	1,222	1,259	1,297	1,335
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	1,728,000	2,313,792	2,383,206	2,454,702	2,528,343	2,604,193
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	44%	54%	64%	74%	84%	94%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	760,320	1,249,448	1,525,252	1,816,479	2,123,808	2,447,942
1.6	Pjese e kostos operative për familjet	3,377,152	3,377,152	3,377,152	3,377,152	3,377,152	3,377,152
1.7	Përqindja e mbulimit të kostos	23%	37%	45%	54%	63%	72%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Ana Malit)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	1,017	1,048	1,079	1,111	1,145	1,179
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	1,525,500	2,042,645	2,103,924	2,167,042	2,232,053	2,299,014
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	26%	40%	50%	60%	70%	80%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	396,630	817,058	1,051,962	1,300,225	1,562,437	1,839,212
1.6	Pjese e kostos operative për familjet	2,981,392	2,981,392	2,981,392	2,981,392	2,981,392	2,981,392
1.7	Përqindja e mbulimit të kostos	13%	27%	35%	44%	52%	62%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Bërdicë)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	1,425	1,468	1,512	1,557	1,604	1,652
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,950	1,950	1,950	1,950	1,950

1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	2,137,500	2,862,113	2,947,976	3,036,415	3,127,508	3,221,333
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	12%	25%	35%	45%	55%	65%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	256,500	715,528	1,031,792	1,366,387	1,720,129	2,093,866
1.6	Pjese e koston operative për familjet	4,177,467	4,177,467	4,177,467	4,177,467	4,177,467	4,177,467
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	6%	17%	25%	33%	41%	50%

Tabela 40 Mbulimi i koston nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin II – Zona Perëndimore
[Burimi: Punuar nga Autori]

Në grafikët më poshtë tregohet përqindja e nivelit të të ardhurave që grumbullohen kundrejt përqindjes të mbulimit të koston gjatë 5 viteve të zbatimit të planit, për secilën NJA të Zonës Perëndimore:




Figura 73 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të koston – NJA Velipojë
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 74 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të koston – NJA Dajç
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 75 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Ana Malit
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 76 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Bërdicë
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Siç mund ta shohim si nga tabela ashtu edhe nga grafikët, niveli i grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet, për njësitë e Zonës Perëndimore, ka qënë i ulët gjatë vitit 2017, ku vetëm NJA Dajç ka patur performancën më të mirë të grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet me 44%. Për sa i takon mbulimit të kostos së shërbimit nga të ardhurat e grumbulluara nga familjet gjatë vitit 2017, mbetet në nivele shumë të ulta, pothuajse të papërfillshme, ku përsëri NJA Dajç mbulon 22% të kostos së shërbimit vetëm nga familjet.

Në parashikimin e bërë për 5 vjeçarën e zbatimit të planit, është parashikuar një rritje 10-20% çdo vit për secilën njësi të nivelit të grumbullimit të tarifës nga familjet (*vlera e saj nuk ka ndryshuar me propozim të bashkisë*), duke marrë parasysh edhe nivelin e informimit të qytetarëve. Politika e bashkisë për të mos ndryshuar tarifën e pastrimit për kategorinë e konsumatorëve familjarë, në rastin e Zonës Perëndimore, rezulton të sjellë jo përmirësime të ndjeshme, për sa i takon nivelit të mbulimit të kostos për familjet nga tarifat e familjeve. Kjo pjesë e kostos së shërbimit për familjet, e cila përbën më shumë se 40%, duhet të mbulohet nga grumbullimi i tarifave të bizneseve.

Skenari II – Zona Qëndrore – mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet

Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Shkodër)		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i familjeve	21,253	21,891	22,547	23,224	23,920	24,638
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	3,000	3,450	3,450	3,450	3,450	3,450
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	63,759,000	75,522,536	77,788,212	80,121,858	82,525,514	85,001,279
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	65%	75%	80%	85%	95%	100%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	41,443,350	56,641,902	62,230,569	68,103,579	78,399,238	85,001,279
1.6	Pjese e kostos operative për familjet	87,121,001	87,121,001	87,121,001	87,121,001	87,121,001	87,121,001
1.7	Përqindja e mbulimit të kostos	48%	65%	71%	78%	90%	98%

Tabela 41 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin II – Zona Qëndrore
[Burimi: Punuar nga Autori]




Figura 77 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Shkodër
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Siç mund ta shohim si nga tabela ashtu edhe nga grafikët, niveli i grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet, për NJA Shkodër, ka qënë relativisht më i lartë se njësitë e tjera (65%) gjatë vitit 2017 nga familjet, të cilat kanë mbuluar 48% të kostos së shërbimit.

Në parashikimin e bërë për 5 vjeçarën e zbatimit të planit, është parashikuar një rritje 10% çdo vit të nivelit të grumbullimit të tarifës nga familjet (vlera e saj nuk ka ndryshuar me propozim të bashkisë), duke marrë parasysh edhe nivelin e informimit të qytetarëve. Nëse niveli i grumbullimit të tarifës nga familjet do të jetë në nivelet e parashikuara, NJA Shkodër në fund të 5 vjeçarit do të mund të mbulojë 98% të pjesës së kostos së shërbimit për familjet nga tarifa e pastrimit nga familjet.

Skenari II – Bashkia – mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga BM & BV

Tarifa e biznesit të madh nga kosto operative e shërbimit		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i bizneseve të mëdha	1,210	1,246	1,284	1,322	1,362	1,403
a.	<i>Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA Shkodër</i>	750	773	796	820	844	869
b.	<i>Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA të tjera</i>	219	226	232	239	246	254
c.	<i>Njësi tregtare për tregtim karburanti</i>	43	44	46	47	48	50
d.	<i>Njësi prodhimi në NJA Shkodër</i>	80	82	85	87	90	93
e.	<i>Njësi prodhimi në NJA e tjera</i>	9	9	10	10	10	10
f.	<i>Subjekte ndërtuese për Selinë administrative</i>	39	40	41	43	44	45
g.	<i>Ente shtetërore, OjF</i>	70	72	74	76	79	81
1.2	Tarifa vjetore e bizneseve të mëdha						
a.	<i>Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA Shkodër</i>	30,000	33,000	33,000	33,000	33,000	33,000
b.	<i>Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA të tjera</i>	30,000	33,000	33,000	33,000	33,000	33,000
c.	<i>Njësi tregtare për tregtim karburanti</i>	45,000	48,000	48,000	48,000	48,000	48,000
d.	<i>Njësi prodhimi në NJA Shkodër</i>	60,000	63,000	63,000	63,000	63,000	63,000
e.	<i>Njësi prodhimi në NJA e tjera</i>	30,000	33,000	33,000	33,000	33,000	33,000
f.	<i>Subjekte ndërtuese për Selinë administrative</i>	70,000	73,000	73,000	73,000	73,000	73,000
g.	<i>Ente shtetërore, OjF</i>	5,000	8,000	8,000	8,000	8,000	8,000
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	39,155,000	44,068,550	45,390,607	46,752,325	48,154,894	49,599,541
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	100%	100%	100%	100%	100%	100%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	39,155,000	44,068,550	45,390,607	46,752,325	48,154,894	49,599,541
1.6	Pjese e kosto operative për bizneset e mëdha	50,927,836	50,927,836	50,927,836	50,927,836	50,927,836	50,927,836
1.7	Përqindja e grumbullimit të të ardhurave	77%	87%	89%	92%	95%	97%
Tarifa e biznesit të vogël nga kosto operative e shërbimit		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1.1	Nr. i bizneseve të vogla	4,299	4,428	4,561	4,698	4,839	4,984
a.	<i>Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA Shkodër</i>	3,000	3,090	3,183	3,278	3,377	3,478
b.	<i>Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA të tjera</i>	953	982	1,011	1,041	1,073	1,105
c.	<i>Njësi prodhimi në NJA Shkodër</i>	170	175	180	186	191	197
d.	<i>Njësi prodhimi në NJA e tjera</i>	56	58	59	61	63	65
e.	<i>Ambulant</i>	120	124	127	131	135	139
1.2	Tarifa vjetore e familjeve						
a.	<i>Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA Shkodër</i>	10,000	13,000	13,000	13,000	13,000	13,000
b.	<i>Njësi tregtare dhe Shërbimi në NJA të tjera</i>	5,000	8,000	8,000	8,000	8,000	8,000
c.	<i>Njësi prodhimi në NJA Shkodër</i>	10,000	13,000	13,000	13,000	13,000	13,000
d.	<i>Njësi prodhimi në NJA e tjera</i>	5,000	8,000	8,000	8,000	8,000	8,000
e.	<i>Ambulant</i>	2,500	5,500	5,500	5,500	5,500	5,500
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	36,747,620	50,766,084	52,288,901	53,857,403	55,472,960	57,136,984
1.4	Niveli i grumbullimit të të	97%	98%	99%	100%	100%	100%

	ardhurave						
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	35,645,191	49,750,762	51,766,012	53,857,403	55,472,960	57,136,984
1.6	Pjese e kostos operative për familjet	40,742,269	40,742,269	40,742,269	40,742,269	40,742,269	40,742,269
1.7	Përqindja e grumbullimit të të ardhurave	87%	122%	127%	132%	136%	140%

Tabela 42 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga BM & BV për Skenarin II
[Burimi: Punuar nga Autori]

Në ndryshim nga situata me tarifën nga konsumatorët familjarë, në rastin e bizneseve, si të mëdha dhe të vogla, bashkia ka aftësinë të grumbullojë 100% të tarifës, e cila siç tregohet edhe në parashikim 5 vjeçarë do të mbulojë pothuajse 100% pjesën e kostos operative të shërbimit që i takon bizneseve.

Në Aneksin III paraqitet një tabelë përmbledhëse për të gjithë gjithë bashkinë në lidhje me parashikimin e rritjes të nivelit të grumbullimit të tarifës vit pas vitit për skenarin I.

VI. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

6.1. Rregullorja vendore

Bashkia e Shkodër duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren lokale për administrimin e shërbimit të mbetjeve, ku të përcaktohet qartë rolin dhe përgjegjësia e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ. Kjo rregullore duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

- a. Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimin të mbetjeve;
- b. Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve;
- c. Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve;
- d. Marrjen e masave parandaluese për mosdjegjen e mbetjeve në kazanë, për moshedhjen e mbetjeve në rrymat ujore dhe kanalizimet, apo në vende të tjera nga ato të miratuara nga bashkia;
- e. Marrjen e masave parandaluese për moshedhjen e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, mosdepozitimin e kafshëve të ngordhura dhe mbetjeve të rrezikshme në PGM të mbetjeve urbane;
- f. Shmangien e parkimit të automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- g. Marrjen e masave për pastrimin nga ana e pronarëve të hapësirave rreth dyqaneve dhe pikave ambulate të shitjes;
- h. Marrjen e masave për sigurimin e një pastërtie të pranueshme duke dezinfektuar kontenierët dhe koshat rrugorë të depozitimit të mbetjeve;
- i. Mbajtja e uniformave gjatë proceseve të punës nga punonjësit e pastrimit;
- j. Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruarëve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve):
 - Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar;
 - Procedurat administrative për dhënie dhe heqjen e licencave;
 - Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
 - Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
 - Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;

- Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
- Mbajtja e të dhënave historike për mbetjet;
- Parandalimi i problemeve për shëndetin publik.

6.2 Zbatimi dhe sanksionet

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksionet që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin “ndotësi paguan”, ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysht kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijohet një sistem i drejtë për dekurajimin dhe parandalimin e ndotësve.

Gjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve.

6.4 Pjesëmarrja e sektorit privat

Ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e manaxhimit të mbetjeve:

- Sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare sesa sektori publik;
- Skemat e minimizimit të mbetjeve që kërkojnë financime në teknologji (makineri dhe kontenierë) mund të jenë shumë të përshatshme për një bashkpunim PPP;
- Administrata e sektorit privat është më efektive se ajo e sektorit publik;
- Aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve të bashkisë;
- Dukë qënë që është i orientuar drejt fitimit, sektori privat ofron kontroll më të mirë të standardeve operative dhe teknike, etj.

Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbetjeve voluminoze, mbetjeve të riciklueshme apo dhënia me koncension e impianteve apo aktiviteteve për trajtimin mbetjeve (përfshirë edhe Stacionin e Transferimit të Mbetjeve), duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbetjeve. Përfshirja e sektorit privat me anë të koncesionit apo partneritetit publik-privat duhet të nxitet si një mekanizëm për të ofruar një zgjidhje më të mirë ekonomike dhe që mund të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.

Sektori privat mund të marrë pjesë në secilën nga veprimtaritë e administrimit të mbetjeve të ngurta, siç jepet edhe më poshtë:

Ofrimi i mjeteve apo makinerive të rënda – me qira ose marrëveshje qiraje me pronarët e pajisjeve	Fshirja apo pastrimi i rrugëve dhe zonave të hapura – me kontratë shërbimi
Mbledhja e mbetjeve të përgjithshme urbane nga të gjitha lagjet – me kontratë shërbimi	Riparimi i mjeteve të bashkisë për mbetjet urbane – me kontratë shërbimi sipas nevojave apo me kontratë afatgjatë
Ofrimi i kontenierëve të posaçëm për skemat e minimizimit të mbetjeve	Operimi i ST – me kontratë shërbimi ose koncesion
Mbledhja e mbetjeve komerciale nga hotelet, zyrat, tregjet apo dyqanet	Vjelja e tarifave të përdoruesit apo taksave të mbetjeve – me të drejtë ekskluzive për mbledhjen e tarifave me agjentë, si ndërmarrja e ujësjellësit, apo elektriku.

Tabela 43 Pjesëmarrja e sektorit privat në administrimin e mbetjeve urbane
[Burimi: Punuar nga Autori]

VII. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të manaxhimit të mbetjeve, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve si dhe sigurimin e pastërtisë në nivele të kërkuara në territorin e bashkisë, është shumë i domosdoshëm përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Komuniteti jo vetëm duhet të kuptojë funksionimin e sistemit, por duhet ta mbështesë atë. Suksesi i çdo skeme menaxhimi mbetjesh bazohet plotësisht nga mbështetja e përdoruesve. Konsumatorët si familjet, bizneset apo institucionet, në sajë të një fushatë të fortë ndërgjegjësimi mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të grumbullimit, duke zbatuar kërkesat e hedhjes dhe ndarjes së mbetjeve dhe duke penguar materialet e padëshirueshme (psh. mbetjet e rrezikshme), të hyjnë në rrymën e mbetjeve të grumbulluara. Ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve dhe nivelit të pastërtisë, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbetjeve. Ka disa mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin publik për çështjet e mbetjeve dhe për të dhënë informacion se si mund të trajtohen ato, me një kosto relativisht të ulët, por mjaft efektive për arritjen e objektivit.

Hartimi i një plani ndërgjegjësimi do të mundësojë: i) ofrimin e një informacioni të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së territorit dhe koston së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve; ii) ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore; iii) nxitjen e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

Metoda për komunikimin dhe informimin: Metodën më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta, njoftimet, dhe reklamat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkolla. Një zhvillim të lartë sot në vend ka edhe teknologjia e informacionit si edhe aksesin në internet. Kjo teknologji si edhe tërheqja pas rrjeteve sociale të komunitetit (kryesisht atij në moshë të re) mund të jetë një mundësi e mirë për komunikimin dhe informimin e publikut për shkak edhe të koston së ulët si edhe shpejtësisë që ofron. Gjithashtu mund të shfrytëzohen dhe evente të karaktereve të ndryshme (festa, tubime, koncerte), ku ka grumbullime të mëdha njerëzish dhe ku informimi dhe komunikimi me publikun bëhet më i lehtë.

Në programet e riciklimit apo minimizimit të mbetjeve metoda më e mirë është ajo “derë më derë”. Kjo metodë fton konsumatorët në nismat e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve në burim, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret. Banorëve dhe bizneseve iu shpërndahen fletë informative për llojet e mbetjeve që mund të riciklohen, kompostohen dhe mënyrën se si ato duhet të veprojnë për t’u bërë pjesë e procesit.

Përdorimi i makinave teknologjike që shërbejnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve apo kontenierët për informim: Tek të gjithë makinat dhe nëse është e mundur tek kontenierët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme një slogane domethënëse për të mbajtur pastër zonën, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht.

Marrja e opinionëve të qytetarëve: Një tjetër çështje e rëndësishme është krijimi i mekanizmave për marrjen e mendimeve dhe reagimit të qytetarëve: si mund të ftohet publiku t’i japë bashkisë mendime apo opinionë ose komente për shërbimin e mbetjeve?

Dy metodat kryesore për të marrë mendimin e publikut janë:

- Mundësia e publikut për t’u ankuar: Bashkia apo operatori i shërbimit duhet të ketë zyrën e kontaktit/informacioni për të marrë ankesat. Numri i ankesave dhe zgjidhja e tyre është një nga parametrat e matjes së performancës së institucionit lidhur me menaxhimin e mbetjeve.
- Vlerësimi i kërkesës dhe sondazhi/studimi i “vullnetit për të paguar”: Për të vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë për të paguar, lind nevoja për të komunikuar me përfituesit e mundshëm të shërbimit lidhur me alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin dhe tarifën. Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t’u përfshirë në sondazh, kampionet që duhet të realizohen duhet të variojnë midis 100 dhe 200 të intervistuar. Kjo praktikë duhet të kryhet periodikisht nga bashkia, ose sa herë ajo e shikon të arsyeshme për të marrë opinionin e publikut në lidhje me vlerësimin e performancës të shërbimit.

7.1 Fushata e informimit në Bashkinë Shkodër gjatë hartimit të planit

Gjatë fazës të hartimit të planit Bashkia Shkodër ka zhvilluar dëgjesa publike me komunitetin e të gjitha njësive administrative dy faza të ndryshme:

- Faza e parë për prezantimin e tarifës së re të pastrimit në sajë të rritjes së tarifës të landfillit të Bushatit;
- Faza e dytë për prezantimin e skenarëve të planit të menaxhimit të mbetjeve.

Në të gjithë Bashkinë janë zhvilluar mbi 25 dëgjesa publike, me pjesëmarrjen e rreth 400 veta nga komuniteti. Ndërkohë në NJA Shkodër, stafi i bashkisë organizoi takime edhe me komunitetin e bizneseve për diskutimin e tarifës së re të pastrimit për kategoritë e ndryshme të bizneseve të mëdha dhe të vogla.





Figura 78 Dëgjesat publike në Bashkinë Shkodër
[Burimi: Bashkia Shkodër]

Gjatë diskutimeve që ka zhvilluar stafi i bashkisë me komunitetin ata kanë shprehur gadishmërinë e tyre për të paguar tarifën e re, duke vlerësuar faktin se shërbimi i pastrimit është një ndër shërbimet publike me cilësinë më lartë në zonën e tyre. Ndonëse një pjesë e tyre kanë shprehur rezerva në lidhje me rritjen e tarifës, stafi i bashkisë ka shpjeguar teknikisht nevojën për një menaxhim më cilësor të landfillit të Bushatit me një kosto më të lartë, duke sjellë edhe si pajojë rritjen e tarifës hyrëse të mbetjeve në landfill.

Në lidhje me dëgjesat publike për skenarët e planit, komuniteti është shprehur mjaft pozitiv me shërbimet e reja që bashkia kërkon të ofrojë në kontratat e reja dhe shpreh gadishmërinë e tij në pagesën e tarifës dhe në kontributin për zhvillimin shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në tre zonat e reja të mbetjeve që bashkia kë përcaktuar.

7.2 Model për hartimin e një fushatë informimi për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe skemave për minimizimin e tyre

Ky program, do t'iu vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit, i cili do të njihet me skemat e reja dhe iniciativat pilot të riciklimit dhe kompostimit, por edhe nxënësve të shkollave, të cilët do të marrin iniciativën për t'u njohur me skemat e menaxhimit të mbetjeve dhe do të jenë pjesë e procesit të riciklimit dhe kompostimit, në nivel komuniteti apo në ambjentet e shkollave.

Objektivat potencialë të një fushate ndërgjegjësimi dhe informimi mund të formulohen nga bashkia si më poshtë:

1. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me skemat e reja të menaxhimit të mbetjeve, si do të kryhen, si dhe angazhimin e tyre konkret në aplikimin e tyre;
2. Ndërgjegjësimin dhe rritja e numrit të qytetarëve që paguajnë tarifën për shërbimet e mbetjeve;
3. Mbështetje në aplikimin e skemave nxitëse për tarifa më të ulta të mbetjeve në sajë të angazhimit të komunitetit në aplikimin e skemave të riciklimit dhe kompostimit, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe shërbimin dhe cilësinë e mjedisit;
4. Rritja e numrit të qytetarëve dhe nr. nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e minimizimit të mbetjeve (riciklim apo kompostim) dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për riciklimin e mbetjeve, si plastika, alumini, letra apo fillimin e skemave të kompostimit në zonat rurale;
5. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me procesin se si do të kryhet riciklimi dhe kompostimi, si dhe angazhimi i tyre konkret në aplikimin e skemave;
6. Prezantimin e skemave të ndryshme të minimizimit të mbetjeve për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë iniciativë;

7. Prezantimin e modeleve/metodave që do të ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e aktorëve të interesuar në aplikimin konkret të riciklimit dhe kompostimit të mbetjeve;
8. Prezantimin e skemave nxitëse për rritjen e pjesëmarrjes të aktorëve që do të aplikojnë skemat e minimizimit të mbetjeve;
9. Promovimi i mbrojtjes së mjedisit urban dhe rural.

Fushata ndërgjegjësuere dhe komunikuese do të jetë pjesë e programit të bashkisë, ku ajo do të marrë përsipër zbatimin e saj në të gjithë territorin e saj. Me anë të këtij programi bashkia duhet të synojë që periodikisht (ashtu siç është përcaktuar edhe në hapat më poshtë) gjatë gjithë vitit, të zhvillojë fushata intensive ndërgjegjësimi dhe informimi për komunitetin dhe specifikesht për nxënësit e shkollave. Bashkia duhet të sigurojë burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të realizuar periodikisht gjatë vitit këtë program. Në lidhje me burimet financiare bashkia duhet të parashikojnë si fillim në buxhetin e saj një zë të veçantë për programin e ndërgjegjesimit dhe informimit, ku duhet të merret në konsideratë elementet si më poshtë:



Figura 79 Elementet e fushatës të ndërgjegjesimit dhe informimit
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Shembull i programit të ndërgjegjësimit dhe informimit

Tema e fushatës: Rritja e njohurive të komunitetit dhe nxënësve në lidhje me skemat e manaxhimit të mbetjeve



HAPI 1- VEPRIMTARITË PARAPRAKE TË NDËRGJEGJËSIMIT

Bashkia duhet të promovojë në komunitet apo në zonat pilot, ide dhe mënyra të reja për manaxhimin e mbetjeve, si prezantimi i skemave të reja për grumbullimin e mbetjeve (në burim), ndarjen e mbetjeve, ripërdorimi i mbetjeve, metodat alternative të dorëzimit të mbetjeve, etj., duke ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë, të fokusuar për disa konsumatorë apo në një zonë pilot.

Synimi për këtë fazë është t'i informojë komunitetin se është marrë një vendim për aplikimin e një skeme të re; apo se ekziston një mënyrë tjetër më e preferueshme për manaxhimin e mbetjeve në krahasim me mënyrën tradicionale; dhe se ekzistojnë arsye të mira për të ndërmarrë një ndryshim në praktikën aktuale të manaxhimit të mbetjeve. Shpërndarja e këtij informacioni në publik duhet të vijë jo vetëm si një vendim i marrë në nivel bashkie, por edhe në formën e një kërkesë (me anë të një pyetëso, i cili do të vlerësojë nevojat e komunitetit dhe mendimi që ka komuniteti për aplikimin e skemave të reja të manaxhimit të mbetjeve).

Nisur nga ky fakt, bashkia mund të fillojë fushatën e ndërgjegjësimit me anë të një pyetëso, i cili mund të përsëritet periodikisht (1-2 herë në vit), për të vlerësuar si fillim opinionin e tyre në lidhje me gjendjen ekzistuese të manaxhimit të mbetjeve dhe prezantimit të metodave të reja të manaxhimit të mbetjeve, si ndarja në burim, riciklimi, kompostimi i mbetjeve. Në këtë pyetësor do të parashikohet edhe një pjesë në lidhje me opinionin/sjelljen e banorëve kundrejt tarifës së mbetjeve, a janë ata të informuar në lidhje me shërbimet të cilat ata paguajnë, mendimi i tyre në lidhje me propozimin e tarifave të reja për mbetjet etj.

Metodat më të preferuara të ndërgjegjësimit publik, të cilat mund të përdoren nga bashkia si fazë fillestare e ndërgjegjësimit të komunitetit për manaxhimin e mbetjeve është metoda derë më derë duke përfshirë vullnetarë apo studentë të interesuar të bëhen pjesë e fushatave aktive.



HAPI 2- RITJA E INTERESIT

Një një fazë të dytë, komuniteti që tashmë është informuar dhe ndërgjegjësuar për çështjet e manaxhimit të mbetjeve, si dhe për idetë apo programet e reja, do të kërkojë informacione të tjera shtesë, ose do të jetë në pritje për të kërkuar informacione shtesë, përderisa bashkia do të vendosë që të zbatojë këto skema të manaxhimit të mbetjeve në territorin që ajo administron.

Qëllimi është që t'i bëjnë ata më shumë me dije psh. për praktikën e kompostimit dhe riciklimin të mbetjeve ose për praktikën e ndarjes së mbetjeve. Pas përcaktimit të zonave ku do të zbatohen skemat e ndarjes në burim (riciklim apo kompostim), bashkia duhet të fillojë të hartojë një program të

detajuar, i cili duhet të ketë si qëllim jo vetëm informimin e komunitetit në lidhje me iniciativat e reja që janë ndërmarrë për manaxhimin e mbetjeve, por edhe konkretisht ku do të konsistojnë, infrastruktura e nevojshme, cili do të jetë roli i tyre në këto iniciativa, përfitimet konkrete që ata do të kenë, niveli i tarifave dhe metodat nxitëse financiare etj.

Kjo fazë e rritjes së interesit do të propozojë konkretisht hapat që do të ndjekë bashkia për të realizuar këtë fushatë ndërgjegjësimi, ku do të parashikohet të organizohen takime, seminare, vizita në terren, në impiantet e mbetjeve apo të riciklimit, etj., me pjesëmarrjen e individëve dhe grupeve të interesit duke përfshirë profesionistë dhe manaxherë të mbetjeve.



HAPI 3- VLERËSIMI DHE PËRMIRËSIMI

Në këtë fazë, drejtuesit e programeve të bashkisë duhet të jenë në gjëndje të vlerësojnë programin dhe rezultatet e tij çdo 3 muaj, për të parë nëse programi është realizuar sipas parashikimeve, nëse ka rezultuar i suksesshëm, i përshtatshëm dhe financiarisht i përballueshëm për të përmbushur mjaftueshmërisht pritshmëritë dhe objektivat. Falë vlerësimit mund të përmirësohen aktivitetet, grafikët ose rrugët e operimit, të merren vendime nëse do të vazhdohet me programin, apo të merren vendime për përmirësimin dhe mbështetjen e tij etj. Nga ana tjetër, autoritetet vendore synojnë të përfshijnë njerëzit më pranë programit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre.

Ky vlerësim mund të zhvillohet në fund të çdo fushate aktive (1 herë në muaj ose 1 herë në 3 muaj), ku njësi vendore përcakton disa forma të kontrollit si më poshtë:

- **Vlerësim vizual** në zonat, të cilat kanë filluar të zbatojnë skemat e reja të manaxhimit të mbetjeve;
- **Vlerësim sasior**, në lidhje me sasinë e mbetjeve të cilat janë reduktuar nga rryma e përgjithshme e mbetjeve (pra kanë shkuar për riciklim apo kompostim);
- **Vlerësim cilësor** i zonave në të cilat janë vendosur infrastruktura të posaçme për trajtimin e mbetjeve, si kosha për riciklim apo për kompostimin e mbetjeve, nëse ato janë funksionale apo jo dhe nëse janë të mirëmbajtura apo jo;
- **Vlerësim i opinionit** të qytetarëve, kryesisht të atyre të cilët kanë filluar zbatimin e skemave të reja të manaxhimit të mbetjeve me anë të një pyetësi të shkurtër, i cili duhet të nxjerrë në pah:
 - A është e përshatshme skema për qytetarët;
 - A janë ata të ndërgjegjësuar dhe informuar mjaftueshëm për operimin e suksesshëm të skemës;
 - Sistemi i aplikuar i tarifave a justifikon mjaftueshëm skemën e re të manaxhimit të mbetjeve etj.

Gjatë kësaj faze, si bashkia ashtu edhe konsumatorët do të kërkojnë prova të qëndrueshmërisë nga partneriteti i tyre i deritanishëm, me qëllim që palët të sigurohen se kontributi i gjithësecilit ka vlerë dhe se pala tjetër tregon përkushtimin e duhur. Në këtë fazë rekomandohen intervistat, takimet publike dhe seminarat për të treguar rezultatet dhe për të prezantuar hapat për të ardhmen.

Informimi për Sistemin e ri të tarifave: Bashkia me fillimin e aplikimit të skemave të reja do të fillojnë të aplikojnë edhe një sistem të ri të tarifave të mbetjeve, për një shërbim i cili do të ofrohet në një territor më të madh, ku në disa raste nuk ekzistonte më parë. Si fillim bashkia duhet të përcaktojë tarifën e mbetjeve dhe procesi i vendosjes së tarifës së mbetjeve duhet të kalojë në 9 hapa kryesorë, të cilat duhet të jenë pjesë e fushatës ndërgjegjësuese për tarifën e mbetjeve:

1. **Njohja me konsumatorët** – bashkia duhet të identifikojë kategoritë dhe numrin e konsumatorëve që gjenerojnë mbetje në territorin e saj. Ky informacion duhet të paraqitet në broshurat informuese.
2. **Sasia e mbetjeve që gjenerohen në bashki** – Pasi janë përcaktuar kategoritë dhe numri i konsumatorëve, bashkia duhet të përcaktojë edhe sasinë e mbetjeve që gjenerohen në territorin e saj (sipas kategorive) dhe normat e gjenerimit të mbetjeve për kategoritë e konsumatorëve. Ky informacion që duhet të paraqitet në broshurat informuese do t'i japë mundësi konsumatorëve që të kuptojnë realisht sasinë e mbetjeve që gjenerohen në njësinë e tyre dhe sa e rëndësishme është pagesa e tarifës për të siguruar menaxhimin e tyre.
3. **Vlerësimi i opsioneve teknike** – Skema e re do të parashikojë edhe aspekte të reja teknike për mënyrën e ofrimit të shërbimit. Ky informacion, në lidhje me aspektet e reja teknike të shërbimit (nr. i kontenierëve, lloji i tyre për mbetjet miks apo të diferencuara, numri i makina për transport, stabilimentet për depozitim të mbetjeve etj) duhet t'i vihet në dispozicion komunitetit, që ai të kuptojë realisht teknologjinë e ofrimit të shërbimit të ri.
4. **Vendosja e marrëdhënies institucionale** – Komuniteti duhet të njihet me ndarjen e përgjegjësisë dhe detyrave në skemën e re të ofrimit të shërbimit të mbetjeve. Cila do të jetë përgjegjësia dhe roli i secilit territor administrativ në skemën e re të manxhimit të mbetjeve? Në këtë mënyrë ai do të kuptojë edhe dinamikën përkatëse në territorin ku ai ndodhet.
5. **Njohja me koston e ofrimit të shërbimit** – Për të vendosur tarifën sa më afër realitetit duhet të përcaktojmë koston e plotë të shërbimit të manxhimit të mbetjeve sipas shërbimeve që do të ofrohen: i) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve; ii) fshirjen dhe larjen e rrugëve; iii) trajtimin e ndërmjetëm të mbetjeve; iv) trajtimin final të mbetjeve; v) kostot operative; vi) kostot kapitale; vii) kostot indirekte etj. Në këtë mënyrë komuniteti e ka më të qartë koston e shërbimeve që ai do të marrë.
6. **Identifikimi i burimit të të ardhurave** – Komuniteti duhet të njihet edhe me burimet financiare të cilat do të sigurojnë ofrimin e shërbimit sipas standardeve.
7. **Përzgjedhja e niveleve të duhura për tarifën dhe llogaritja e tyre** – Pasi bashkia ka përcaktuar numrin dhe kategoritë e konsumatorëve, kostot e shërbimit dhe burimet e të ardhura, ajo ka mundësinë që të përcaktojë edhe nivelet e duhura të tarifave për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve. Ky informacion është mëse i rëndësishëm për t'u ndarë me konsumatorët, ku ata njihen specifikisht se për cilat shërbime, me një kosto të caktuar, ata do të paguajnë.
8. **Vendimmarrja strategjike** – Në sajë të karakteristikave të njësive vendore merren disa vendime strategjike për vendosjen e nivelit të tarifave për kategoritë e konsumatorëve, ku përcaktohet sa përqind e koston pritjet që të mbulohet nga mbledhja e tarifave.

Komunikimi i sistemit të ri të tarifave – bashkia mund të përcaktojë mënyrën më të mirë për informimin e publikut në lidhje me 8 hapat më lart, të cilat mund të realizohen me anë të takimeve periodike, standave në hyrje të bashkisë apo edhe me broshura informuese, ku japin rezultatet e 8 hapave më lart

Nisur nga ky fakt, bashkia do të duhet të fillojë një fushatë ndërgjegjësimi për sistemin e ri të tarifave për mbetjet, e cila do të prekë qytetarët në dy nivele: i) ata që e paguanin më parë tashmë tani do të

kenë një sistem të ri; ii) ata të cilët nuk kanë patur shërbim do t'u duhet së pari të njihen dhe të kuptojnë se si funksionon sistemi, ku ata do të bëhen pjesë dhe më pas të fillojnë të paguajnë.

Në fushatën ndërgjegjësuere dhe informuese për sistemin e tarifave, e cila do të jetë pjesë e fushatës për promovimin e skemës së re ndërvendore, bashkia duhet të marrë në konsideratë këto parime:

- Alokimin eficient të burimeve që ka në dispozicion bashkia;
- Ofrimi në mënyrë sa më eficiente të shërbimit - krijimi i incentivave për të ofruar shërbimin me kosto sa më të ulët;
- Përdorimi eficient i burimeve natyrore - përmbushja e objektivave mjedisore, si promovimi i skemave të riciklimit dhe kompostimit;
- Mbulimi i kostos – tarifat e vendosura duhet të reflektojnë të gjitha shërbimet që kryhen për shërbimin e manaxhimit të mbetjeve;
- Qëndrueshmëria financiare – tarifat e vendosura duhet të reflektojnë një qëndrueshmëri të sistemit të manaxhimit të mbetjeve;
- Barazi horizontale mes përdoruesve, të cilët duhet të paguajnë të njëjtën shumë për të njëjtin nivel shërbimi të ofruar;
- Zbatimi i parimit “Ndotësi Pague”;
- Parimi i “Proporcionalitetit” – sasia e tarifës duhet të reflektojë sasinë e shërbimit të ofruar;
- Parimi i “Transparencës” – vendosja e tarifës duhet të jetë e qartë dhe nëse ka incentiva ato duhet të qartësohen për komunitetin.

VIII. PLANI VEPRIMI

8.1 Komponenti: Kuadri ligjor dhe institucional					
1	Objektivi Strategjik		Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
1.1	Përgatitja e kuadrit ligjor dhe rregullator lokal të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kërkesat në nivel kombëtar	1.1.1	Miratimi i Planit Lokal të Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve Ngurta Bashkiake;	Bashkia Shkodër; Këshilli Bashkiak	2017-2018
		1.1.2	Përditësimi i Rregullores Lokale të Manaxhimit të Mbetjeve në kushtet e ndarjes së re administrative;	Bashkia Shkodër (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik) Konsulentë të jashtëm & Ekspertë; Këshilli Bashkiak	2017-2018
		1.1.3	Aprovimi i sanksioneve lokale dhe penaliteteve për çështjet e mbetjeve;	Bashkia Shkodër, (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik, Drejtoria e manaxhimit financiar) Këshilli i Bashkiak	2017-2018
		1.1.4	Aplikimi i instrumentave të komunikimit dhe informimit të komunitetit rreth rregullave dhe penaliteteve;	Bashkia Shkodër, (Përgjegjësi i Shërbimeve), Vullnetarët, OJQ, përfaqësues të komunitetit,	2018-2022
1.2	Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi dhe depozitimi pa kriter i mbetjeve të rrezikshme (si dhe spitalore) në zbatim të legjislationit shqiptar	1.2.1	Informimi i komunitetit për të diferencuar mbetjet e rrezikshme nga mbetjet urbane si dhe detyrimet e tjera të prodhuesit të mbetjeve;	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve), Shkollat, ARM, Donatorët dhe organizatat -joqeveritare	2018 - 2022
		1.2.2	Krijimi i skemave efektive për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të rrezikshme (të ngjashme me skemat e redukimit të mbetjeve);	Bashkia Shkodër, (Përgjegjësi i Shërbimeve); ARM, ISHMPU, ISHSH Donatorët dhe organizatat -joqeveritare	2018-2022
		1.2.3	Ruajtja e sigurtë në mënyrë të përkohshme e mbetjeve të rrezikshme (sipas rregullores për administrimin e tyre) derisa të sigurohet një zgjidhje rajonale apo kombëtare për trajtimin përfundimtar të tyre.	Bashkia Shkodër, (Drejt. Shërbimeve publike) ARM, Donatorët dhe organizatat -joqeveritare	2017-2018
1.3	Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi i mbetjeve spitalore apo mbetjeve inerte dhe ndërtimore	1.3.1	Inspektimi dhe kontrolli i ndotjes urbane nga materialet inerte dhe ndërtimore, skeletet e makinave, etj, që nga gjenerimi, transporti deri depozitimin e tyre;	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë), ISHMPU; Kompanitë e ndërtimit	2018-2022
		1.3.2	Projektim dhe ndërtim ose miratim të një venddepozitimi të përkohshëm për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëlimore brenda standarteve kombëtare;	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve); Këshilli i Bashkiak	2018
		1.3.3	Organizimi i tryezave lokale me industrinë e ndërtimit për të inkurajuar përdorimin dhe riciklimin e këtyre materialeve;	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve); Industria e ndërtimit	2018-2021

		1.3.4	Hartimi i një rregullore për operimin e venddepozitimit për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëllimore. Përcaktimi i sanksioneve kundrejt gjeneruesve të mbetjeve në rast të mos menaxhimit të duhur të këtyre mbetjeve që ata gjenerojnë;	Bashkia Shkodër , (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve); Këshilli i Bashkiak	2018
		1.3.5	Monitorimi i rregullt i operimit të venddepozitimit të mbetjeve ndërtimore dhe vëllimore, si dhe monitorimi i prodhuesve të tyre në lidhje procedurën që ata ndjekin kur gjenerojnë këto lloj mbetjesh.	Bashkia Shkodër , (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve, Përgjegjësi i venddepozitimit të mbetjeve ndërtimore dhe voluminoze)	2018-2022
1.4	Forcimi i kooperimit ndër-institucional dhe për monitorimin mjedisor dhe koordinimin e masave për përmirësimin e tij	1.4.1	Krijimi i dhe miratimi i një strukture lokale të inspektorëve bashkiak në lidhje me mjedisin dhe mbetjet;	Bashkia Shkodër ; Këshilli Bashkiak	2017-2018
		1.4.2	Zbatimi i sistemit të monitorimit në të gjitha NJA të Bashkisë dhe aplikimi i sanksioneve kundrejt shkelësve të rregullave apo dëmtuesve;	Bashkia Shkodër , (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë);	2018-2019
		1.4.3	Përmirësimi i procedurave të licencimit mjedisor të ST në kooperim të ngushtë me strukturat e Agjensisë Rajonale të Mjedisit (ARM) dhe ISHMPU;	Bashkia Shkodër ; ARM; ISHMPU	2018
		1.4.4	Koordinimi në nivel rajonal dhe me njësitë lokale fqinje për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes nga mbetjet, apo organizimin e shërbimit apo përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së mbetjeve;	Bashkia Shkodër ; Qarku i Shkodrës, si dhe njësitë e tjera lokale	2018-2022

8.2 Komponenti: Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve dhe Pastrimi i Rrugëve

2	Objektivi Strategjik		Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore	
2.1	Përmirësimi i shërbimeve mbetjeve Bashkinë Shkodër; Ofrimi i shërbimeve eficiente dhe cilësore;	i të në i dhe	2.1.1	Riorganizimi i zonave të shërbimit të mbetjeve (ndarje e Bashkisë në tre zona shërbimi: Zona Lindore (NJA Rrethinat, NJA Postrinë, NJA Shalë, NJA Pult, NJA Shosh, NJA Guri i Zi); Zona Perëndimore (NJA Velipojë, NJA Dajç, NJA Ana Malit, NJA Bërdicë), Zona Qëndrore (NJA Shkodër);	Bashkia Shkodër; (Kryetari, z. Kryetari Drejtori i shërbimeve, Përgjegjësi i shërbimit të mbetjeve)	2017-2018
			2.1.2	Hartimi i dokumentave të tenderit për tre kontrata e reja, sipas tre zonave në të cilat do të ofrohet shërbimi. Hapja e tenderit, përzgjedhja e kompanive që do të ofrojnë shërbimin;	Bashkia Shkodër; (Kryetari, z. Kryetari Drejtori i shërbimeve, Përgjegjësi i shërbimit të mbetjeve, Ekspertë të jashtëm, Zyra Jurike);	2017-2018
			2.1.3	Shtirja e shërbimit në NJA në të cilat nuk ofrohet shërbimi i mbetjeve (NJA Pult, NJA Shosh, NJA Shalë) dhe konsolidimi i shërbimit në NJA të cilat kanë patur shërbim. Investim në infrastrukturë duke e përmirësuar atë, në sajë të nevojës të reja që ka Bashkia e re (blerje kontenerë dhe mjete teknologjike);	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, zyra jurike dhe financave);	2018-2019
			2.1.4	Monitorimi i rregullt i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në të tre zonat e mbetjeve (tre kontrata e shërbimit). Raportime të rregullta nga të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e monitorimit në instancat vendimmarrëse të bashkisë. Përgatitja e raporteve ditore/javore dhe mujore të gjendjes së PGM për të gjitha NJA;	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private);	2018-2022
			2.1.5	Prezantimi i skemave të ndarjes në burim në rrugët kryesore të qytetit dhe në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit (mbetje të njoma dhe të thata);	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private);	2019-2022
			2.1.6	Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme. Investim në kontenerë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve;	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, zyra juridike dhe e financave, kompanitë private);	2019-2022
			2.1.7	Projektimi dhe ndërtimi i një pike grumbullimi për mbetjet e riciklueshme, e cila do të shërbejë për të pritur dhe paketuar mbetjet që vijnë nga zonat pilot të grumbullimit të ndarë të mbetjeve në qytetin e Shkodrës;	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private, Këshilli Bashkiak);	2019-2022
			2.1.8	Prezantimi i skemave të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme në NJA Rrethinat dhe NJA Dajç;	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private);	2019-2022
			2.1.9	Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të biodegradueshme. Investim në kontenerë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve;	Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, zyra juridike dhe e financave, kompanitë private);	2019-2022

	2.1.10	Projektimi dhe ndërtimi i dy pikave të hapura për kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme dhe kontrolli i vazhdueshmë i këtyre pikave;	Bashkia Shkodër , (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private, Këshilli Bashkiak);	2019-2022
	2.1.11	Me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit të bëhen transparent për publikun kostot e shërbimeve të pastrimit sipas kontratave si dhe detyrimet, ndalimet, rregullat si dhe një informacion specifik rreth shërbimeve, orareve, iniciativave, etj.	Bashkia Shkodër , (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private).	2019-2022

8.3 Komponenti: Depozitimi dhe Trajtimi i Mbetjeve

3	Objektivi Strategjik		Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
3.1	Rehabilitimi i të gjitha vend depozitimeve të vjetra në të gjitha NJA të Bashkisë Shkodër;	3.1.1	Kryerja e një studimi fizibiliteti për rehabilitimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve në NJA;	Bashkia Shkodër (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm	2018
		3.1.2	Sigurimi i financimit për zbatimin e projektit të rehabilitimit;	Bashkia Shkodër (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm	2018
		3.1.3	Rehabilitimi i venddepozitimeve në NJA (sipas projektit);	Bashkia Shkodër (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm	2018
		3.1.4	Hartimi dhe miratimi i një plani mjedisor të monitorimit dhe kujdesi pas mbylljes.	Bashkia Shkodër (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm	2018
3.2	Monitorimi i vazhdueshëm i Landfillit të Bushatit	3.2.1	Lobim institucional pranë qeverisë qendrore (MIE&MTM) për financimin e projektit të fazës së dytë për landfillin e Bushatit	Bashkia Shkodër	2018-2019
		3.2.2	Monitorimi i rregullt i të gjitha dërgesave të mbetjeve që hyjnë në landfill, kontrolli i ngarkesës në lidhje me kategorinë e mbetjeve që duhet të lejohet të hyjë në landfill, raportimi i rregullt i ngarkesave të mbetjeve që hyjnë në landfill.	Bashkia Shkodër (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike, Inspektori i landfillit të Bushatit	2018-2022

8.4 Komponenti: Ndarja dhe Riciklimi i mbetjeve

4	Objektivi Strategjik		Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
4.1	Promovimi i ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në burim si dhe në të gjitha stadet e gjenerimit të tyre duke aplikuar skema të përshtatshme pilot; Progresi drejt objektivave kombëtarë për minizimin e mbetjeve në nivel lokal.	4.1.1	Mobilizimi i përfshirjes së komunitetit në skemat pilot, bërja e anketimeve paraprake për vlerësimin e vullnetit për t'u përfshirë para se të përzgjidhen zonat e dëshiruara;	Bashkia Shkodër, OJF, Komuniteti, vullnetarë,	2019-2022
		4.1.2	Hartimi i një plani-pune specifik për zbatimin e skemave të ndarjes së mbetjeve, i cili duhet të koordinohet më sistemin ekzistues të grumbullimit të mbetjeve të tjera urbane;	Bashkia Shkodër, (Përgjegjësi i shërbimeve, ekspertë të jashtëm	2019-2022
		4.1.3	Krijimi dhe zbatimi i skemave pilot të riciklimit dhe kompostimit të shtëpi sipas skemave pilot të rekomanduara në këtë plan;	Bashkia Shkodër, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Komuniteti	2019-2022
		4.1.4	Organizimi i takimeve në komunitet dhe me biznese, para dhe gjatë fillimit të skemave pilot për të mbështetur përpjekjet/programet e ndërgjegjësimit dhe edukimit për rritur cilësinë dhe nivelin e përfshirjes së komunitetit;	Bashkia Shkodër, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Komuniteti	2019-2022
		4.1.5	Organizimi i takimeve me grupet e interesit në rajon dhe me gjerë. Reklamimi i faciliteteve ricikluese si dhe skemave të grumbullimit të diferencuar, skemave të kompostimit;	Bashkia Shkodër, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Shoqata e Bashkive	2019-2022
		4.1.6	Monitorimi i zbatimit të skemave të ndarjes së mbetjeve, riciklimit dhe kompostimit: efektivitetit dhe cilësisë së funksionimit ashtu dhe sasisë së mbetjeve që ndahet dhe përpunohet; Mbajtja e një regjistri javor për këto të dhëna dhe relatimi çdo muaj pranë grupit mbikqyrës në bashki;	Bashkia Shkodër, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit	2019-2022
		4.1.7	Lidhja e marrvëshjeve bashkëpunimi/pjesëmarrje me bizneset e mëdhenj ashtu dhe nëse është e mundur me komunitetin e skemave pilot për detyrimet dhe përfitimet e palëve;	Bashkia Shkodër, Ekspertë, bizneset e mëdhenj të qytetit, konsumatorët e skemave pilot	2019-2022
		4.1.8	Kryerja e studimeve të fizibilitetit dhe analiza ekonomike mbi zhvillimin lokal të kompostimit në nivel lokal ose ndër-lokal.	Bashkia Shkodër, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm;	2019-2022
4.2	Stimulimi dhe mbështetja e sektorit privat lidhur me aktivitetet e riciklimit dhe kompostimit	4.2.1	Inkurajimi i shtrirjes së skemave të riciklimit dhe kompostimit në shtëpi përmes bashkë-financimit me bizneset e riciklimit dhe komunitetin;	Bashkia Shkodër, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit në rajon	2019-2022
		4.2.2	Promovimi dhe zhvillimi i tregjeve lokale për materialet e riciklueshme.	Bashkia Shkodër, Ekspertë të jashtëm; biznese të riciklimit në rajon	2019-2022

8.5 Komponenti: Aspektet Financiare					
5	Objektivi Strategjik		Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
5.1	Forcimi i kuadrit financiar të manaxhimit të mbetjeve, marrvëshjeve dhe kontratave; Krijimi një sistemi financiar të përmirësuar (lidhur me buxhetin, investimet e nevojshme)	5.1.1	Aplikimi çdo vit i metodologjisë së "Llogaritjes së plotë të kostos sipas modelit të DLDAP " kur shpenzimet kapitale vlerësohen dhe llogaritet përgjatë gjithë jetës së dobishme të makinave dhe kontenerëve;	Bashkia Shkodër (Përgje. Shërbimesh, dhe Dep. për Manaxhimin dhe Hartimin e Programeve Financiare-DMHPF)	2018-2022
		5.1.2	Rritje progresive e buxhetit vjetor operacional+mirëmbajtjes drejt mbulimit total të kostove operacionale dhe kostos kapitale;	Bashkia Shkodër (Përgj Shërbimesh, dhe Dep. DMHPF), Këshilli Bashkiak	2018-2022
		5.1.3	Kompesime financiare për konsumatorët me pamundësi për të paguar (me asistencë sociale apo me të ardhurave të ulëta) dhe jo për grumbullim inefficent të tarifave;	Bashkia Shkodër (Përgj Shërbimesh, dhe Dep. DMHPF), Këshilli Bashkiak	2018
		5.1.4	Hartimi i projekteve konkrete dhe të kërkohet mbështetje financiare për investimet e mëdha nga fondet e qeverisë, donatorë, hua nga institucione financiare apo banka;	Bashkia Shkodër, Këshilli Bashkiak	2018-2021
		5.1.5	Rifreskimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve duke synuar rritjen e numrit të tarifë paguesve drejt mbulimit total;	Bashkia Shkodër (Policia Urbane, Përgj. Shërbimesh, dhe Dep. MHPF), Këshilli Bashkiak	2018-2019
		5.1.7	Aplikimi i penaliteve të qarta efektive, dhe procedurave detyruese për mos pagimin e tarifave të mbetjeve;	Bashkia Shkodër (Policia Urbane, Insp. Shërbimesh, dhe Dep. MHPF), Këshilli Bashkiak	2018-2022
		5.1.8	Vendos stimuj për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve: Aplikimi i uljeve në tarifat dhe heqja e tyre për konsumatorët e përfshirë në programet pilot të minimizimit;	Bashkia Shkodër (Përgjegj. Shërbimesh, dhe Dep. MHPF), Këshilli Bashkiak	2019-2020
		5.1.9	Rishikimi dhe përmirësimi i tarifimit të bizneseve, në përputhje të plotë me parimin "ndotësi paguan";	Bashkia Shkodër (Përgj. Shërbimesh, dhe Dep. MHPF), Këshilli Bashkiak	2018-2020
		5.1.10	Kryerja e studimeve periodike (vjetore) mbi "Dëshirën për të paguar" dhe "Mundësinë për të paguar" nga qytetarët;	Bashkia Shkodër (Dep.MHPF, Përgj. Shërbimeve), OJQ-të, Vullnetarë	2018-2021
		5.1.11	Rishikimi i strategjisë së mbulimit të kostove dhe nivelit të tarifave, bazuar në analizën e zhvilluar në plan dhe marrja në konsideratë e performancës së grumbullimit, studimin e dëshirës për të paguar, kostove dhe objektivave si dhe indikatorët financiar të përcaktuar në këtë plan;	Bashkia Shkodër (Dep.MHPF, Insp. Shërbimeve) Ekspertë të jashtëm	2018-2020
		5.1.12	Transparenca dhe komunikimi: Procesi i caktimit të tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet t'i komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira: duke përdorur metodat e komunikimit në masë si dhe atë "derë më derë".	Bashkia Shkodër (Dep.MHPF, Përgj Shërbimeve), OJQ-të, Vullnetarë, OJQ	2017-2022

8.6 Komponenti: Ndërgjegjësimi Publik dhe Edukimi

6	Objektivi Strategjik		Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
6.1	Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të territorit, pagimin e tarifës së pastrimit, si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve	6.1.1	Ofrimi i vazhdueshëm i informacioneve të përgjithshme për publikun dhe bizneset; broshura informative, buletinë, postera, rrjete sociale, etj;	Bashkia Shkodër; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2018-2022
		6.1.2	Ofrimi i informacioneve specifik për grupet e interesit (konsumatorët në zonat pilot);	Bashkia Shkodër; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2018-2022
		6.1.3	Laçimi i nismave të reja (grumbullimi individual i mbetjeve, riciklimi dhe kompostimi) duke përdorur promovimin në TV, radio lokale dhe gazeta;	Bashkia Shkodër; Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2018-2022
		6.1.4	Krijimi i grupeve në komunitet për promovimin e edukimit dhe ndërgjegjësimin në zonat pilot dhe konsumatorët pilot;	Bashkia Shkodër; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2018-2022
		6.1.5	Hartimi dhe shpërndarja e paketave të informacionit sipas grupeve të interesit (qytetarët, bizneset, shkollat, industria, etj);	Bashkia Shkodër; Komuniteti, Bizneset e riciklimit, OJQ-të, Donatorë	2018-2022
		6.1.6	Përdorimi i mjeteve teknologjike dhe kontenierët për të ofruar informacion të përgjithshëm (slogan, numrat e kontaktit, grafikët e shërbimit);	Bashkia Shkodër;	2018-2022
		6.1.7	Realizimi i fushatës "derë më derë" për të përfshirë popullatën dhe bizneset në mënyrë eficiente mbi aktivitetet e riciklimit dhe ndarjes në burim dhe pagesës së tarifës së pastrimit;	Bashkia Shkodër; Bizneset e riciklimit, Vullnetarë, OJQ-të,	2018-2022
		6.1.8	Hartimi i programeve dhe fushatave "vijuese" të riciklimit për të përmirësuar cilësinë e ndarjes në burim përmes programeve të riciklimit;	Bashkia Shkodër; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm, Bizneset e riciklimit, Vullnetarë, OJQ-të.	2018-2022
		6.1.9	Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve dhe ilustrimeve për riciklimin dhe kompostimin, për shkollat, bizneset, banorët.	Bashkia Shkodër; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit, OJQ-të.	2018-2022

IX. RISHIKIMI I PLANIT

Ndjekja e zbatimit të planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike (çdo 5 vjet) ose më shpesh nëse është e nevojshme për vlerësimin dhe rishikimin e objektivave dhe masave. Monitorimi dhe vlerësimi mund të funksionojë si një bazë për rishikimin e planit.

Çështje të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë kur të analizohet ky plan janë sigurisht vlerësimi nëse objektivat janë përmbushur, nëse masat e parashikuara kanë qenë efektive apo jo. Një plan duhet të rishikohet gjithashtu, kur politika kombëtare e mbetjeve rekomandon apo detyron ndryshime thelbësore në mënyrën e manaxhimit të mbetjeve apo vendos objektiva të ndryshëm në funksion të obligimeve ndërkombëtare. Në këto raste, plani duhet të përballet me ndryshime të thella ose mund të jetë i nevojshëm hartimi i një plani të ri. Përgjatë zbatimit të planit, duhen analizuar në mënyrë të vazhdueshme faktorët kryesorë që impaktojnë në parashikimet dhe objektivat e vëna në plan, si zhvillimi i popullsisë, ndryshimet lidhur me konsumin dhe llojin e mbetjeve të gjeneruara nga industritë apo ekonomitë shtëpiake. Gjithashtu analizimi i këtyre faktorëve shërben për të vlerësuar programet dhe projektet në proces apo që priten të fillojnë.

9.1 Monitorimi

Ky plan duhet të parashikojë hapat në vazhdim, indikatorët dhe mjetet për të vlerësuar punën e bërë, për të verifikuar nëse objektivat janë përmbushur dhe të raportimin tek vendimmarrësit. Qëllimi është që të sigurojë që autoritetet përgjegjëse u është dhënë mundësia për të ndjekur zhvillimin dhe zbatimin e planit dhe të vendosin mbi masat shtesë, nëse është e nevojshme. Studimi bazë, i kryer për qëllim të këtij plani, do të shërbejë si një status bazë mbi të cilën do të vlerësohen arritjet e objektivave dhe targeteve dhe mbi të cilat do të matet ndryshimi i indikatorëve të performancës së planit.

Monitorimi i planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike dhe, nëse është e nevojshme mund të kërkojë rishikimin e objektivave dhe masave të planit. Monitorimi i planit do të shërbejë për:

- Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit, mbi statusin e zbatimit të planit;
- Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara;
- Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo të efektshme;
- Për të mësuar, përditësuar dhe shpërndarë informacion dhe njohuri.

Si kryhet monitorimi dhe vlerësimi

Bashkia duhet të ndjekë këto hapa në kryerjen e procesit të monitorimit dhe të vlerësimit të planit, si më poshtë:

- 1) Rishikimi i situatës: Rishikimi i objektivave dhe synimeve, kontrolli nëse ato i përshtaten kontekstit real dhe vlerësimi i tyre me anë të indikatorëve;
- 2) Mbledhja e evidencave sasiore dhe cilësore që lidhen me mbetjet;
- 3) Analizimi i evidencave: Analizimi i të dhënave për të matur progresin, krahasimi i rezultateve me objektivat dhe synimet, kontrolli nëse objektivat janë arritur në një afat kohor të dëshiruar;
- 4) Dokumentimi i konkluzioneve
- 5) Ndarja dhe diskutimi i konkluzioneve: Gjetjet duhet të ndahen me palët e interesuara dhe domosdoshmërisht me vendimmarrësit.

Kryetari i bashkisë duhet të ngarkojë një grup pune përgjegjës apo zyrtarë të caktuar, brenda stafit të bashkisë, me përgjegjësinë e monitorimit dhe vlerësimit të planit. Grupi i punës duhet të përfshijë zyrtarë të administrimit të mbetjeve, administrimi financiar, struktura të mjedisit dhe kontrollit të territorit dhe konsulentëve të jashtëm.

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2016, ka ngritur sistemin e monitorimit në qytetin e Shkodrës për të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve të vendosura në qytet. Bashkia ka hedhur me koordinata të gjitha PGM në hartë dhe në sajë të formateve të raportimit që ajo ka gjeneruar për secilin nga aktorët e përfshirë në procesin e monitorimit, kryen kontrollin ditor, javor dhe mujor të situatës të PGM dhe raporton tek vendim-marrësit me shkrim, me foto dhe me hartat faktike të situatës si në shëmbullin më poshtë:




Figura 80 Hartë verifikimi për evadimin e PGM në NJA Shkodër
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Nisur nga kjo eksperiencë tashmë e konsoliduar në NJA Shkodër, gjatë fazës së hartimit të planit bashkia shprehu angazhimin për të filluar procesin e monitorimit edhe në njësitë e tjera të bashkisë. Si fillim gjatë fazës së evidentimit të gjendjes ekzistuese, grupi i punës evidentoi të gjitha PGM në të gjitha njësitë, ashtu siç tregohet në hartat e paraitur në kapitullin për gjendjen ekzistuese. Të gjithë kryetarët e njësive u trajnuan në lidhje me sistemin e monitorimit, i cili do të fillojë të zbatohet në territorin e tyre.



Figura 81 Sesione trajnimi për sistemin e monitorimit
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Gjatë trajnimit ata u njohën me qëllimin e zhvillimit të sistemit të monitorimit, pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nga bashkia apo nga privati, ku monitorimi shërben për:

- Të matur progresin e çdo operacioni më vete në menaxhimin e mbetjeve kundrejt objektivave dhe targeteve të dakortësuara. Kështu NJQV-të do ta dinë paraprakisht në qoftë se objektivat e shërbimit të MM kanë mundësi që të plotësohen ose jo;
- Të matur efektivitetin e paisjeve dhe stafit të përdorur në çdo operacion të menaxhimit të mbetjeve;
- Të hartuar dhe adresuar masa korrektuese dhe rregullatore për të përmirësuar shërbimin bazuar mbi informacionin e mbledhur përmes monitorimit;
- Të vlerësuar shpenzimet dhe për të kontrolluar kostot e çdo operacioni në menaxhimin e mbetjeve, për t'u siguruar që buxheti ekzistues është i shpërndarë në mënyrën e duhur dhe është i mjaftueshëm për të mbuluar kostot;
- Të vlerësuar sjelljen e përdoruesve si dhe për të matur kënaqësinë e konsumatorit për të parë dhe vlerësuar sesi këto parametra impaktojnë në performancën e shërbimit;
- Të planifikuar më mirë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të ardhmen dhe për të vlerësuar mundësinë dhe potencialet e zgjerimit dhe riplanifikimit të shërbimit.

Ata u njohën me aktorët që duhet të jenë të përfshirë në sistemin e monitorimit, duke filluar që nga kryetartë e rajoneve, dhe inspektorët, deri tek supervizorët e shërbimit, kompanitë private, inspektori i landfillit, drejtori i shërbimeve publike dhe deri tek instancat vendimarrëse (Kryetari apo zv. Kryetari i Bashkisë):



Figura 82 Aktorët e përfshirë në operacionet e monitoirimit – Shembull NJA Shkodër [Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 83 Skema e aktorëve të përfshirë në operacionet e monitoirimit [Burimi: zhvilluar nga autori]

Ndërkohë për të gjitha njësitë vendore, pas evidentimit të PGM në terren u hartuan edhe modele të raporteve ditore në lidhje me gjendjen e PGM në të gjithë territorin tyre. Këto raporte duhet të plotësohen nga supervzori i njësisë, përpara se të raportohen në Drejtorinë e Shërbimeve Publike në Bashki:

Grumbullimi i mbetjeve dhe transport						Koha e shërbimit				
Raport ditor	Zona	Rajoni	Emri i supervisorit		Data	Ora				
	Postribë									
	Emri i rrugës/fshati	Koha e monitorimit	PGM	Nr. i kontenerëve	Frekuenca e grumbullimit	Nr. i kontenerëve të grumbulluar	Data e largjes	Nr. i kontenerëve të larë apo jo	Nr. i kontenerëve të dëmtuar	Shënime
1	Mes		1	2	2 ditë/javë					
			2	1						
			3	5						
			4	1						
			5	4						
			6	2						
			7	2						
			8	1						
2	Boks		9	2	2 ditë/javë					
			10	1						
			11	1						
			12	2						
			13	2						
			14	3						
3	Dragoç		15	2	2 ditë/javë					
			16	1						
			17	2						
4	Kullaj		18	1	2 ditë/javë					
			19	1						
			20	2						
			21	1						
			22	1						
			23	1						
			24	1						
5	Myselim		25	1	2 ditë/javë					
			26	2						
			27	1						
			28	1						
			29	1						

Tabela 44 Model të raportimi ditor për gjendjen e PGM
[Burimi: Punuar nga Autori]

9.2 Monitorimi i Zbatimit të Planit

Monitorimi i planit do të bëhet sipas indikatorëve të performancës të përcaktuar në tabelën e mëposhtme që do të shërbejë: **i)** Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit mbi statusin e zbatimit të planit; **ii)** Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara; **iii)** Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo më të efektshme.

Indikatorët e performancës		Klasifikimi i koduar sipas ngjyrave			Cilësia e të dhënave
		I ulët	Mesëm	I lartë	
					I ulët Mesëm I lartë
Cilësia e shërbimit	C1: Sipërfaqja e mbuluar me shërbim				
	C1.1 Zonat urbane dhe periferike	0 – 40 %	41 – 80%	81 – 100%	
	C1.2 Zonat rurale	0 – 50 %	51 – 90%	91 – 100%	
	C2: Përdorimi i qytetit	0 – 32 %	33 – 66%	> 66%	
C3: Përdorimi i publikut të shërbimit kënaqësi së kundërt shërbimit	0 – 50%	51 – 80%	81 – 100%		
Qëndrueshmëri Mjedisore	D1: Rëmbordorimi shkalla e grumbullimit të diferencuar të moc-jeve	0 – 5%	5 – 20%	>20%	
	D2: Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e trajtimit të moc-jeve në impiante trajtimi.	0 – 30%	31 – 70%	71 – 100%	
Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare	E1: Mbulimi i kostos: Tarifat mbulojnë koston.	0 – 35%	36 – 70%	71 – 100%	
	E2: Sa banorët kontribuojnë në financimin e shërbimit : shkalla e mbledhjes së paritës	0 – 40%	41 – 75%	75 – 100%	
	E3: Transparenca e sistemit të faturimit	uUlët	mesme	artë	
Kosto e shërbimit	 Euro/ton Euro / banorë / vit			


Figura 84 Indikatorët e performancës
[Burimi: zhvilluar nga autori]

ANEKSI I – KOSTOT SIPAS SISTEMIT TË LLOGARITJES SË KOSTOS PËR SKENARIN I

Zona 1 – Zona Lindore

Zona e shërbimit | Zona 1

Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit] **22,505,313.02**



Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor

<i>Grumbullim</i>	51 Lek	0.37 €
<i>Transport</i>	119 Lek	0.86 €
<i>Mirëmbajtje</i>	8 Lek	0.06 €
<i>Personel</i>	71 Lek	0.51 €
<i>Amortizim</i>	124 Lek	0.89 €
<i>Depozitim</i>	209 Lek	1.50 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	582 Lek	4.19 €


Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit

<i>Grumbullim</i>	309 Lek	2.23 €
<i>Transport</i>	725 Lek	5.22 €
<i>Mirëmbajtje</i>	47 Lek	0.34 €
<i>Personel</i>	434 Lek	3.12 €
<i>Amortizim</i>	755 Lek	5.43 €
<i>Depozitim</i>	1,273 Lek	9.16 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	3,543 Lek	25.49 €

Zona 2 – Zona Perëndimore (pa zonën e plazhit)

Zona e shërbimit | Zona 2

Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit] **13,990,901.89**



Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor

Grumbullim	72 Lek	0.52 €
Transport	71 Lek	0.51 €
Mirëmbajtje	9 Lek	0.06 €
Personel	223 Lek	1.61 €
Amortizim	110 Lek	0.79 €
Depozitim	186 Lek	1.34 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	671 Lek	4.83 €


Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit

Grumbullim	496 Lek	3.57 €
Transport	487 Lek	3.50 €
Mirëmbajtje	62 Lek	0.44 €
Personel	1,530 Lek	11.01 €
Amortizim	752 Lek	5.41 €
Depozitim	1,273 Lek	9.16 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	4,599 Lek	33.08 €

Zona 2' – Zona Perëndimore (Vetëm zona e plazhit në Velipojë)

Zona e shërbimit | Zona 4

Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit] **12,338,262.88**



Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor

Grumbullim	34 Lek	0.24 €
Transport	96 Lek	0.69 €
Mirëmbajtje	47 Lek	0.34 €
Personel	128 Lek	0.92 €
Amortizim	101 Lek	0.73 €
Depozitim	87 Lek	0.63 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	494 Lek	3.55 €


Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit

Grumbullim	494 Lek	3.55 €
Transport	1,396 Lek	10.04 €
Mirëmbajtje	693 Lek	4.98 €
Personel	1,876 Lek	13.50 €
Amortizim	1,480 Lek	10.65 €
Depozitim	1,273 Lek	9.16 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	7,211 Lek	51.88 €

Zona 3 – Zona Qëndrore – NJA Shkodër

Zona e shërbimit | Zona 3

Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit] | 128,600,644.85



Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor

Grumbullim	167 Lek	1.20 €
Transport	112 Lek	0.80 €
Mirëmbajtje	28 Lek	0.20 €
Personel	609 Lek	4.38 €
Amortizim	120 Lek	0.86 €
Depozitim	427 Lek	3.08 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	1,464 Lek	10.53 €


Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit

Grumbullim	497 Lek	3.58 €
Transport	333 Lek	2.40 €
Mirëmbajtje	85 Lek	0.61 €
Personel	1,814 Lek	13.05 €
Amortizim	357 Lek	2.57 €
Depozitim	1,273 Lek	9.16 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	4,359 Lek	31.36 €

Zona 3' – Zona Qëndrore – NJA Shkodër – Rrugicat e ngushta të qytetit

Zona e shërbimit | Zona 5

Total cost for management [LEK/year] | 5,262,733.57



Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor

Grumbullim	481 Lek	3.46 €
Transport	621 Lek	4.47 €
Mirëmbajtje	410 Lek	2.95 €
Personel	592 Lek	4.26 €
Amortizim	464 Lek	3.34 €
Depozitim	427 Lek	3.08 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	2,995 Lek	21.55 €

Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit

Grumbullim	1,431 Lek	10.30 €
Transport	1,851 Lek	13.31 €
Mirëmbajtje	1,220 Lek	8.77 €
Personel	1,763 Lek	12.68 €
Amortizim	1,383 Lek	9.95 €
Depozitim	1,273 Lek	9.16 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative	8,920 Lek	64.17 €

ANEKSI II – PERFORMANCA E NIVELIT TË MBLEDHJES SË TARIFËS SIPAS SKENARIT I

Performanca e grumbullimit të tarifës - Skenari I							
I	Të ardhurat e grumbulluara në total nga familjet e bashkisë	43,629,135	63,081,960	71,957,039	80,750,109	93,594,455	102,671,176
II	Pjese e koston operative për familjet në total për Bashkinë	107,713,963	107,713,963	107,713,963	107,713,963	107,713,963	107,713,963
III	Përqindja e mbulimit të koston nga familjet për të gjithë Bashkinë	41%	59%	67%	75%	87%	95%
IV	Të ardhurat e grumbulluara në total nga BM	39,155,000	44,068,550	45,390,607	46,752,325	48,154,894	49,599,541
V	Pjese e koston operative për BM në total për Bashkinë	48,960,892	48,960,892	48,960,892	48,960,892	48,960,892	48,960,892
VI	Përqindja e mbulimit të koston nga BM për të gjithë Bashkinë	76%	85%	88%	90%	93%	96%
VII	Të ardhurat e grumbulluara në total nga BV	35,645,191	49,750,762	51,766,012	53,857,403	55,472,960	57,136,984
VII I	Pjese e koston operative për BV në total për Bashkinë	39,168,714	39,168,714	39,168,714	39,168,714	39,168,714	39,168,714
IX	Përqindja e mbulimit të koston nga BV për të gjithë Bashkinë	86%	120%	125%	130%	134%	138%
VII	Të ardhurat e grumbulluara në total Bashkia	118,429,326	156,901,272	169,113,658	181,359,837	197,222,310	209,407,702
VII I	Kosto Operative e Bashkisë	195,843,570	195,843,570	195,843,570	195,843,570	195,843,570	195,843,570
IX	Përqindja e mbulimit të koston për të gjithë Bashkinë	60%	80%	86%	93%	101%	107%

ANEKSI III – PERFORMANCA E NIVELIT TË MBLEDHJES SË TARIFËS SIPAS SKENARIT II

Performanca e grumbullimit të tarifës - Skenari II							
I	Të ardhurat e grumbulluara në total nga familjet e bashkisë	43,629,135	63,081,960	72,053,857	80,849,831	94,234,990	103,220,137
II	Pjese e koston operative për familjet në total për Bashkinë	112,041,240	112,041,240	112,041,240	112,041,240	112,041,240	112,041,240
III	Përqindja e mbulimit të koston nga familjet për të gjithë Bashkinë	39%	56%	64%	72%	84%	92%
IV	Të ardhurat e grumbulluara në total nga BM	39,155,000	44,068,550	45,390,607	46,752,325	48,154,894	49,599,541
V	Pjese e koston operative për BM në total për Bashkinë	50,927,836	50,927,836	50,927,836	50,927,836	50,927,836	50,927,836
VI	Përqindja e mbulimit të koston nga BM për të gjithë Bashkinë	76%	85%	88%	90%	93%	96%
VII	Të ardhurat e grumbulluara në total nga BV	35,645,191	49,750,762	51,766,012	53,857,403	55,472,960	57,136,984
VII I	Pjese e koston operative për BV në total për Bashkinë	40,742,269	40,742,269	40,742,269	40,742,269	40,742,269	40,742,269
IX	Përqindja e mbulimit të koston nga BV për të gjithë Bashkinë	86%	120%	125%	130%	134%	138%
VII	Të ardhurat e grumbulluara në total Bashkia	118,429,326	156,901,272	169,210,476	181,459,559	197,862,845	209,956,662
VII I	Kosto Operative e Bashkisë	203,711,346	203,711,346	203,711,346	203,711,346	203,711,346	203,711,346
IX	Përqindja e mbulimit të koston për të gjithë Bashkinë	58%	77%	83%	89%	97%	103%

